

QSUT (KLINKA E 2-TE E KARDIOLOGJISE)
MINISTRIA E SHENDETESISE, QKCSA-ISH, ISKSH

Udherrefyes per diagnostikimin dhe trajtimin e insuficiences kardiake akute dhe kronike

QSUT-KLINIKA E II-TE E KARDIOLOGJISE

Publikimi: Dhjetor 2010

Rishkimi: Sipas nevojave

Grupi i punes per hartimin e Udherrefyesit “ Udherrefyes per diagnostikimin dhe trajtimin e insuficencës kardiakë akute dhe kronike ”, ishte i përbërë nga perfaqesues te QSUT, Sherbimi i 2te i Kardiologjise .

Grupi i punes përbehej nga:

Spiro Qirko, Kryetar, QSUT

Diana Kristo , QSUT

Endrin Koni, QSUT

Gerhard Sulo, Sekretar, QSUT

Vladimir Gusmari, perfaqesues i Qendres Kombetare te Cilesise, Sigurise dhe Akreditimit te Institucioneve Shendetesore, QKCSA-ISH;

Maksim Bozo, perfaqesues i Ministrise se Shëndetësisë

Naun Sinani , perfaqesues i ISKSH-se

Perdoruesit e ketij udherrefyesi: Ky Udherrefyes eshte per përdorim nga kardiologe te QSUT, kardiologe te spitaleve te rretheve, specialiste kardiologe ne mbare vendin si dhe nga mjeke te kujdesit parësor.

Ky udherrefyes eshte perfunduar ne Dhjetor 2010.

Data e rishikimit: *Sipas nevojave*

Permbajtja e lendet

Acronime/Shkurttime.....	5
Pasqyra e tabelave dhe numri i faqeve perkatese:	8
Parathenie.....	9
Hyrje	12
Udherrefyesit e insuficences kardiake	12
Perkufizimi dhe diagnoza	12
Perkufizimi i insuficences kardiake	12
Format pershkruese ne insuficencen kardiake	14
Epidemiologjia.....	17
Etiologjia e insuficences kardiake	18
Diagnoza e insuficences kardiake.....	19
Teknikat diagnostikuese.....	23
Testet diagnostikuese ne insuficencen kardiake	23
Ekokardiografia.....	29
Teste te tjera imazherike jo invazive	33
Kateterizimi i zemres	34
Prognoza	35
Menaxhimi jo – farmakologjik	36
Vete – kujdesja.....	36
Evidencia.....	39
Terapia farmakologjike	43
Objektivat ne menazhimin e insuficences kardiake.....	43
Inhibitoret e enzimes se konvertimit te angiotenzines (ACEIs)	45
β-bllokuesit	48
Antagonistet e aldosteronit	50
Bllokuesit i receptoreve te angiotenzines (ARBt)	52
Hidralazina dhe isosorbid dinitrat (H-ISDN).....	54
Digoksina	56
Diuretiket (Tabela 21).....	58
Medikamente te tjera te perdorura per te trajtuar ko-morbiditetin kardiovaskular te pacientet me IK	60
Antikoagulante (antagonistet e vitamines K).....	60
Agjentet antitrombocitare	61
Inhibitoret e HMG CoA reduktazes (“statinat”)	61
Menaxhimi i pacienteve me insuficence kardiake dhe fraksion ejekzioni te ventrikulit te majte te ruajtur (HFPEF – IKEFR).....	62
Teknikat Invazive dhe Kirurgjia	62
Procedurat revaskularizuese, kirurgjia valvulare dhe ventrikulare.....	62
Revaskularizimi ne paciente me insuficence kardiake	62
Vleresimi per semundje te arterieve koronare ne paciente me IK me shrat koronar te paeksploruar	63
Zbulimi i miokardit viabel	63

Kirurgjia valvulare	63
Kirurgjia e valvules se aortes.....	64
Kirurgjia e valvules mitrale	65
Pejsmejkerat (pace-maker).....	67
Terapia e resinkronizimit (<i>Tabela 23</i>)	67
Defibrilatori implantuar kardiak (ICD) (<i>Tabela 23</i>)	68
Transplanti i zemres, pajisjet e asistences ventrikulare, dhe zemra artificiale	70
Transplanti i zemres.....	70
Pajisjet e asistences se ventrikulit te majte (LVAD) dhe zemra artificiale.....	70
Ultrafiltrimi	70
Aritmite ne insuficiencen kardiake	70
Fibrilacioni atrial (<i>Tabela 24</i>).....	71
Aritmite ventrikulare (AV)	73
Semundjet shoqeruese dhe popullatat e veçanta.....	74
Hipertensioni arterial (<i>Tabela 25</i>).....	75
Diabeti melitus (DM).....	75
Menaxhimi i DM ne paciente me IK.	76
Disfunksioni renal	76
Semundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK)	77
Anemja.....	77
Guta (podagra)	77
Insuficiencia kardiake akute.....	78
Perkufizim.....	78
Klasifikimi klinik	79
Prognoza	81
Diagnoza e insuficiences kardiake akute	82
Vleresimi fillestar.....	83
Organizimi i trajtimit te induficiencies kardiake akute.....	85
Menaxhimi	86
Implementimi dhe shperndarja e kujdesit shendetesor	100
Fjalor	102
Referencat	103

Acronime/Shkurttime

ACC – Kolegji Amerikan i Kardiologjise
AF – Fibrilacion atrial
AHA – Shoqata Amerikane e Kardiologjise
ARR – Ulja absolute e riskut
AVC – Aksidente vaskulare cerebrale
AV – Atrio ventrikular
AVP – arginine vazopresina
b.i.d – dy here ne dite
BNP – Tipi B i peptidit natriuretik
BUN – nitrogeni i urese ne gjak
CABG – Bypass aorto-koronar
CMR – Rezonanca magnetike e zemres
CPG – Komiteti per Udherrfyesit e Praktikes
CRP – Proteina C reaktive
CRT-D – Terapi resinkronizuese me defibrilator
CRT-P – Terapi resinkronizuese me Pace-maker
CT – tomografi e kompjuterizur (skaner)
CODP – Semundje pulmonare obstruktive kronike
EDV – Volumi telediastolik
EF – Fraksioni i ejeksionit
EMB – Biopsi endomiokardiale
ESC – Shoqata Evropiane e Kardiologjise (SHEK)
GFR – Shpejtesia e filtrimit glomerular
HFNEF – Insuficiencia kardiake me fraksion ejeksioni normal (IKEFN)
HFPEF – Insuficiencia kardiale me fraksion ejeksioni te ruajtur (IKEFR)
HFPSF – Insuficinca kardiake me funksion sistolik te ruajtur (IKFSR)
H-ISDN – Hidralazina dhe isosorbid dinitrati
ICD – defibrilator i implatuar
LVEF – Fraksioni i ejeksionit te ventrikulit te majte
NT-proBNP – Terminali N i tipit pro-B te peptidit natriuretik
NSAID – preparatet antiinflamatore jo steroide
NYHA – Shoqata e Kardiologjise se New York-ut
o.d – nje here ne dite
PAC – Kateter i arteries pulmonare
PCI – Nderhyrje perkutane koronare
PDA – Asistentet dixhital personal
PDEI – Inhibitoret e fosfodiesterazes
PCWP – Presioni kapilar wedge pulmonar
PVJ – Presioni venoz jugular
RRR – Ulje relative e riskut
RV – Ventrikuli i djathte
SV – Volumi hedhes
TDI- Imazhe te Dopplerit indor
t.i.d – tre here ne dite
VE/VCO₂ – Produkti per minute ventilim/dioksik karboni
VO₂ – Konsumi i oksigjenit

VTI – Integrali kohe-shpejtesi

Perkufizimi i termave te perdorur gjate perpilimit

AD – Atriumi i djathte

BDM – Bllok i deges se majte

FA – Fibrilacion atrial

IAM – Infarkti akut i miokardit

IM – Infarkt miokardi

IK – Insuficiencia kardiake

RCTs – Studime te kontrolluara te randomizuara

SAK – Semundje e arterive koronare (semundje koronare)

TA – Tension arterial

TAS – Tensioni arterial sistolik

TEE – Ekokardiografi transezofageale

VD – Ventrikuli i djathte

VM – Ventrikuli i majte

Pasqyra e tabelave dhe numri i faqeve perkatese:

Tabela nr. 1	10
Tabela nr. 2	10
Tabela nr. 3	13
Tabela nr. 4	13
Tabela nr. 5	14

Tabela nr. 6	16
Tabela nr. 7	18
Tabela nr. 8	19
Tabela nr. 9	20
Tabela nr. 10	21
Tabela nr. 11	23
Tabela nr. 12	24
Tabela nr. 13	25
Tabela nr. 14	26-27
Tabela nr. 15	29
Tabela nr. 16	30
Tabela nr. 17	35
Tabela nr. 18	36
Tabela nr. 19	42
Tabela nr. 20	46
Tabela nr. 21	57-58
Tabela nr. 22	59

Pasqyra e figurave dhe numri i faqeve perkatese

Figura nr. 1	22
Figura nr. 2	43

Parathenie

Ky Udhherrefyes eshte bazuar ne urdherrefyesin e shoqates europiane te kardiologjise 2008 ne bashkepunim me Shoqaten e Insuficencies Kardiake te ESC (HFA) dhe e miratuar nga Shoqata Evropiane e Terapise Intensive te Mjekesise (ESICM).

Udhherrefyesit dhe Dokumentet Eksperte te Konsensusit permbledhin dhe vleresojnë te gjitha evidencat aktuale te vlefshme ne nje botim perfundimtar me qellimin per te ndihmuar mjeket dhe punojesit e tjere te kujdesit shendetesor per te zgjedhur strategjite me te mira te mjekimit

per nje pacient tipik qe vuan nga nje gjendje e caktur, duke marre parasysh efektin e te dhenave, si dhe reportin e risk-benefitit te mjeteteve te vecanta diagnostike dhe terapeutike. Udherrefyesit nuk jane zevendesues te tekseve (traktateve). Implikimet legale te udherrefyesve legale jane diskutuar me pare.

Nje numer i madh Udherrefyesish dhe Dokumentesh Eksperte te Konsensusit jane botuar vitet e fundit nga Shoqata Evropiane e Kardiologjise (ESC) sikurse dhe nga shoqata dhe organizata te tjera. Si pasoje e ndikimit ne praktiken klinike, kriteret e cilesise per formulimin (hartimin) e udherrefyesve jane vendosur ne vend qe te bejne transparente ndaj perdoruesve te gjitha vendimet. Rekomandimet per formulimin dhe botimin e Udherrefyesve te Shoqates Evropiane te Kardiologjise (ESC) dhe Dokumenteve Eksperte te Konsensusit mund te gjenden ne websit-in e ESC ne sektionin e udherrefyesve (www.escardio.org).

Shkurtimisht, ekspertet e fushes jane zgjedhur dhe ndermarrin nje permblehdhe te pote te evidencave te publikuara per menaxhemin dhe/ose parandalimin e nje gjendje te caktuar. Nje vleresim kritik per procedurat diagnostikuese dhe terapeutike eshte kryer duke perfshire perllgaritjen e raportit risk-benefit. Vleresimet e rezultateve te pritshme te shendetit per shoqata me te medha jane perfshire aty ku ekzistojne te dhenat. Niveli i evidences dhe forca e rekomandimit per mundesi te vecanta trajtimi jane vleresuar dhe klasifikuar sipas shkalleve te paracaktuara, te paraqitura ne Tabelat 1 dhe 2.

Ekpertet e paneleve shkruese kane paraqitur dokumente per te gjitha lidhjet qe mund te kene pasur apo mund te perceptohen si burime te mundshme konflikti interesit.

Tabela 1. Klasat e rekomandimeve

Klasat e rekomandimeve	Perkuqizimi
Klasa I	Evidencia dhe/ose marreveshje te per gjithshme qe nje trajtim i dhene ose procedure eshte efikas, i dobishem, i nevojsphem
Klasa II	Konflikte evidencash dhe/ose divergenca opinion per efikasitetin/dobishmerine e trajtimit ose procedures se dhene
Klasa IIa	Pesha e evidences/ opinionit eshte ne favour te efikasitetit dhe dobishmerise Dobishmeria/efikasiteti eshte me pak e vertetuar nga evidence/opinion
Klasa IIb	
Klasa III	Evidence ose marreveshje e per gjithshme qe trajtimi ose procedura e dhene nuk eshte e dobishme/efikase, dhe ne disa raste mund te jete e demshme.

Tabela 2. Niveli i evidences

Niveli i evidences A	Te dhena te perftuara nga studime klinike te shumta te ramdomizuara ose meta-analiza
Niveli i evidences B	Te dhena te perftuara vetem nga nje studim klinik i ramdomizuar ose nga studime te medha jo te ramdomizuara
Niveli i evidences C	Konsensus i opinionit te eksperteve dhe/ose studime te vogla, retrospektrive, regjistra.

Keto dokumente mbahen ne dosje ne Shtepine Evropiane te Zemres, zyrat qendrore te Shoqates Evropiane te Kardiologjise. Cdo ndryshim ne konfliktet e interesit qe del gjate periudhes se shkrimit duhet te njoftohet te ESC. Raporti i Task Force eshte mbeshtetur i teri financiarisht nga ESC dhe eshte paraqitur pa perfshirjen e industrise.

Komiteti i ESC per udherrefyesit praktike mbikqyr dhe kordinon pergatitjen e Dokumentave te reja te Udherrefyesve dhe Eksperteve te Konsensusit te krijuara nga Task Forca, grupi i eksperteve ose paneli i konsensusit. Komiteti eshte gjithashtu pergjegjes per miratimin e formulimin ketyre udherrefyesve dhe te Dokumenteve te Konsensusit Ekspert. Pasi dokumenti ka perfunduar dhe eshte aprovuar nga te gjithe ekspertet e Task Forces, eshte paraqitur tek eksperte te jashtem per rishikim. Dokumenti eshte ripare dhe aprovuar perfundimisht nga CPG dhe me pas eshte publikuar.

Pas publikimit, i nje rendesie te madhe eshte propagandimi (perhapja) e mesazhit. Te rendesishme ne qendrat e kujdesit jane dhe versionet me permasa xhepi dhe ato te formes PDA – asistentet dixhital personal. Disa survejime kane treguar se perdoruesit ndonjehere nuk jane ne dijeni te ekzistence se udherrefyesve, ose nuk i perkthejne ato ne praktike, prandaj programet implementuese per udherrefyesit e rinj luajne nje rol te rendesishem ne perhapjen e njoburive. Organizohen takime nga SHEK (ESC), dhe drejtohen nga Shoqatat Kombetare qe jane anetare dhe nga drejtues qe japid ne Evrope opinionet kyce. Ne nivele kombetare mund te ndermerren edhe takime implementuese, nderkohe qe udherrefyesit jane vertetuar (nenshkuar) nga shoqatat anetare te SHEK (ESC), si dhe perkthyer ne gjuhen ametare. Programet implementuese jane te nevojshme, sepse eshte treguar qe te dhenat e semundjes mund te influencoohen nga aplikimi i plote i rekomandimeve klinike.

Keshtu, grupi i shkrimit te Udherrefyesve ose te dokumenteve te Konsensusit te Eksperteve mbulon jo vetem integrimin e shumices se studimeve te fundit, por edhe krijimin e mjeteve edukuese dhe implementimin e programeve per rekomandimet. Lidhja midis studimeve klinike, shkrimit te udherrefyesve dhe vendosjes e tyre ne praktiken klinike mund te plotesohet nese survejimet dhe regjistrat jane kryer per te verifikuar qe praktika ne jeten e perditshme kryhet sipas udherrefyesve te rekomanduar. Keto survejime dhe regjistra bejne gjithashtu te mundur vleresimin e udherrefyesve ne rezultatet e pacienteve. Udherrefyesit dhe rekomandimet duhet te ndihmojne mjeket dhe punonjes te tjere te kujdes shendetesor per te

marre vendime ne praktiken e tyre klinike. Megjithate vendimi i fundit per kujdesin e nje pacienti ne vecanti duhet bere nga mjeku qe e ka ne ngarkim.

Hyrje

Udherrefyesit e insuficencen kardiake

Qellimi i ketij dokumenti eshte per te perfituar udherrefyes praktike per diagnozen, vleresimin e trajtimin dhe IK akute dhe kronike. Keta udherrefyes jane nje perpunim dhe rishikim i udherrefyesve te botuara ne 1995¹, 1997², 2001³ dhe 2005^{4,5}. Jane gjetur shume informacione te reja ne lidhje me trajtimin e IK. Kjo ka cuar ne rishikimin e disa prej rekomandimeve te meparshme. Rekomandimet lidhen me praktiken klinike, analizat epidemiologjike, studimet klinike dhe observuese. Nje vemendje e vecante ne te kete rishikim i eshte dhene thjeshtesimit dhe qartesimit te rekomandimeve, si dhe problemeve te lidhuar me zbatimin e tyre. Qellimi ka qene qe te behet nje bashkim dhe modifikim i dokumenteve te mepershme te lidhura me IK. Udherrefyesit nenkuptojne nje mbeshtetje per mjeket dhe profesioniste te tjere te kujdesit shendetesor, duke dhene keshilla per menaxhimin e pacienteve me IK, si dhe rekomandime per referanca. Evidenca te dokumentuara e te publikuara per diagnozen, efikasitetin dhe sigurine e nderhyrjeve terapeutike jane baza kryesore e ketyre udherrefyesve. Nese evidenca mungon ose nuk i zgjidh problemet klinike, atehere prezantohet nje konsensur opinioni.

Udherrefyesit e SHEK (ESC) jane te pershtatshme me 51 shtete anetare me ekonomi te ndryshme, prandaj rekomandimet te bazuara ne kost-efektivitetin jane evituar. Politikat kombetare te shendetit sikurse eshte gjykimet klinike mund te diktojne rregullin e prioriteve ne zbatimin e ketyre rekomandimeve. Rekomandimet ne keta udherrefyes gjithmone duhet te marrin ne konsiderate politikat kombetare dhe udheheqjet rregullatore lokale per perdonimin e procedurave diagnostikuase, mjekimeve apo pajisjeve.

Ky raport u hartua nga nje Grup i Shkrimeve te Task Force (shih faqen me titull) te caktuar nga CPG e ESC. Brenda Task Force u mblohdhet raportimet e konflikteve te interesave, te cilat jane te disponueshme ne zyren e ESC. Drafti iu dergua CPG dhe rishikuesve te dokumentave (shih faqen me titull). Pas marrjes ne konsiderate te te dhenave te tyre, dokumentet u azhornuan (perditesuar), u rishikua dhe me pas u aprovar per botim nga i gjithe Task Force. Nje avitje e baze-evidences eshte perdonur per te nxjerre shkallen e rekomandimeve te udherrefyesve, me nje vleresim shtese te cilesise se evidences. Per diagnozen e IK, evidenca nuk eshte komplete. Nese eshte keshtu, rekomandimet dhe raportimet jane bazuar ne nje konsensus te opinioneve te ekspereteve.

Perkufizimi dhe diagnoza

Perkufizimi i insuficencen kardiake

Ne 50 vitet e fundit jane dhene shume perkufizime per insuficencen kardiake.⁶ Keto vene ne dukje nje ose disa vecori te kesaj sindrome komplekse sic jane vecorite hemodinamike, konsumimi i oksigjenit ose kapaciteti ne sforcime. Ne vitet e fundit, shume perkufizime kane

theksuar nevojen per te dyja, prezencen e simptomave te insuficiencies kardiake dhe shenjave fizike te mbajtjes se lengjeve.^{5,7-9}

Insuficiencia kardiake eshte nje sindrome ne te cilen pacientet duhet te kene karakteristikat e me poshtme: simptoma te insuficiencies kardiake, veshtiresi ne fryshtemarrje tipike ne qetesit ose gjate eforave, dhe/oze lodhje; shenja te mbajtjes se likideve sic eshte kongestionasi pulmonar ose enjtja e kyceve; dhe te dhena objektive te nje anomalie te struktura ose te funksionit te zemrave ne qetesit (tabela 3). Vetem nje per gjigje klinike ndaj mjekimit per insuficiencen kardiake nuk eshte e mjaftueshme per diagnozen, por na ndihmon kur diagnoza eshte e paqarte edhe pas ekzaminimeve te duhura diagnostike. Pacientet me insuficiencen kardiake, zakonisht pritet te tregojne njefare permisimi te simptomave si per gjigje ndaj ketyre trajtimeve, me te cilat mund te pershpjetohet nje permisim relativisht i shpejte i simptomave (p.sh. perdorimi i diuretikeve ose vazodilatatoreve). Manifestimet klinike me te medha e me te zakonshme te insuficiencies kardiake jane paraqitur ne Tabelen 4

Tabela 3 Perkufizimi i insuficiencies kardiake

IK eshte nje sindrom klinik ne te cilen pacientet kane karakteristikat e me poshtme:

- **Simptoma tipike per IK**
(dispneja ne qetesit e ne eforave, lodhje, enjtje e kyceve te kembes)
dhe
- **Shenja tipike te IK**
(takikardia, takipnea, rale pulmonare, likid pleural, rritje e presionit te v.jugulare, edema periferike, hepatomegali)
dhe
- **Evidencia objektive te nje anomalie strukturale ose funksionale te zemrave ne qetesit**
(kardiomegali, toni i trete kardiak, zhurma kardiake, anomali ne ekokardiogramme, rritje e perqendrimit te peptidit natriuretik)

Tabela 4 Manifestime klinike te zakonshme te insuficencës kardiakë

Karakteristikat dominante	klinike	Simptomat	Shenjat
Edema periferike kongestion		Dispne Lodhje Anoreksi	Edema periferike Rritje e presionit venoz jugular (PVJ) Edeme pulmonare Hepatomegali, ascit Mbingarkese likidesh (kongestion) Kaheksi
Edema pulmonare		Dispne e rende ne qetesë	Krepitacione ose rale ne pulmone, likid Takikardi, takipne
Shok kardiogjen (sindrom me debit te ulet)		Konfuzion Dobesi	Perfuzion periferik i varfer TAS <90 mmHg Anuri ose oliguri
Presion arterial i larte (IK hipertensive)	Dispne		Zakonisht TA i rritur, hipertrofi e VM, EF i ruajtur
IK e djathte	Dispne Lodhje		Evidence e disfunkzionit te ventrikulit te djathte (VR) Rritje e PVJ, edema periferike, hepatomegali, kongestion intestinal

Anomalite asimptomatike strukturelle dhe funksionale te zemres Jane konsideruar si prekusore te insuficencës kardiakë simptomatike dhe shoqerohen me një mortalitet te larte.^{10,11} Trajtimi eshte i vlefshem per ato gjendje qe diagnostikohen, dhe per kete arsyje Jane pershkruar dhe ne keta udherrefyes.

Nje avantazh i perkufizimit te insuficencës kardiakë te perdonur ketu, eshte qe eshte praktik dhe lejon nje trajtim me te sakte si ne praktiken klinike, ashtu edhe kur ndermerren survejanca observimi, studime epidemiologjike e klinike. Insuficiencia kardiakë nuk duhet te jete asnjeherë nje diagnoze me vete. Duhet gjithmone te gjendet shkaku.

Format pershkruese ne insuficencen kardiakë

Insuficiencia kardiakë akute dhe kronike

Jane perdonur shume fjalë apo shprehje shtese per te karakterizuar pacientet me IK. Keto shprehje mund te mbulojne njera-tjetren dhe mjeket ndonjehere perdonin terma me kuptime pak te ndryshme. Termi "akute" ne kontekstin e IK akute eshte bere konfuz sepse disa klinikiste e perdonin termin per te treguar rendesen (urgjencen mjekesore te edemes pulmonare me risk per jeten) dhe te tjere e bere termin per te treguar IK te dekompenzuar, te sapofilluar ose te filluar per here te pare. Pra, termi eshte me teper nje tregues i kohes sesa i rendesës.

Termat akute, e avancuar dhe e dekompesuar nuk duhen te perdoren ne menyra te ndryshueshme kur perdoren per IK. Nje klasifikim me vlera i IK qe bazohet ne llojin e prezantimit klinik eshte paraqitur ne Tabelen 5. Eshte bere nje dallim midis IK qe shfaqet per here te pare, tranzitore dhe asaj kronike. IK qe shfaqet per here te pare eshte vete-sqaruese dhe i referohet prezantimit te pare. IK tranzitore i referohet IK simptomatike mbi nje periudhe kohe te limituar, ndonese eshte sygjeruar trajtim per nje kohe te gjate. Ktu permenden raste me paciente me miokardit te lehte tek te cilet sherimi eshte pothuaj i plote, paciente me infarkt miokardi (IM) te cilet kane nevoje per diuretike ne njesine e terapise intensive (reanimacioni i kardiologjise) por tek te cilet trajtimi per nje kohe te gjate nuk eshte i nevojshem, ose IK tranzitore e shkaktuar nga ishemia dhe e zgjidhur me ane te revaskularizimit. Perkeqesimi i IK ne terren te nje IK kronike (te dekompesuar) eshte forma me e shpeshte e IK qe con ne shtrimin ne spital, dhe perllogarit afersisht 80% te rasteve. Trajtimi duhet te bazohet ne prezantimin klinik per te cilin eshte indikuar terapia specifike (p.sh. edema pulmonare, krize/urgjence hipertensive, IAM).

Tabela 5 Klasifikimi i insuficences kardiake

• Shfaqet per here te pare	Prezantimi i pare Fillim akut ose i ngadalte
• Tranzitore	Rekurrente ose episodike
• Kronike	Persistente E qendrueshme, e perkeqesuar ose e dekompesuar

Insuficiencia kardiake sistolike kundrejt/versus asaj diastolike

Shpesh behet nje dallim midis IK sistolike dhe asaj diastolike.^{12,13} Dallimi eshte disi arbitrar.¹⁴⁻¹⁶ Pacientet me IK diastolike kane simptoma dhe/ose shenja te IK dhe EF te VM te ruajtuar (LVEF) > 40 – 50%.¹⁷ Nuk ka asnje konsensus persa i perket kufirit te EF te ruajtur. EF eshte volum hedhes (SV) i pjesetuar me volumin telediastolik (EDV) per ventrikulin ne fjale te zemres dhe si pasoje percaktohen kryesisht nga volumi telediastolik i ventrikulit (p.sh. ne nje zemer te dilatuar). Nje EF nen ose mbi 40%, dallon volume telediastolike te VM te medha ose normale. Ky dallim eshte rritur shume pasi ne te kaluaren shumica e pacienteve qe shtroheshin ne spitale per investigim ose hynin ne studime klinike kane pasur zemer te dilatuar me EF te uluer < 35% ose 40%. Shumica e pacienteve me shenja te IK kane disfunkcion sistolik dhe diastolik ne qetesи dhe ne eforje. IK sistolike dhe diastolike nuk duhen te konsiderohen si entitete te ndara/te vecuara.¹⁸ Shprehje te tjera jane perdonur per te pershkruar IK diastolike, sic eshte IK me EF te ruajtur (HFPEF – IKEFR), IK me EF normal (HFNEF – IKEFN) ose IK me funksion sistolik te ruajtur (HFPSF – IKFSR). Kemi vendosur te perdonim ne kete dokument shkurtimin IKEFR (HFPEF).

Forma te tjera pershkruese ne IK

Per te pershkruar IK jane perdorur shprehje te tjera te shumta, te cilat nuk kane domethenie etiologjike. IK e avancuar dhe e perkeqesuar jane terma te vjeter te perdorura per te shprehur konceptin qe perfuzioni ne inde dhe nje rritje ne presionit e atriumit te majte, mundet ne situata te caktuar sic eshte IK akute dhe shoku kardiogjen, te kontribojne ne fizpatologji.^{19, 20} Parangarkese dhe pasngarkesa jane terma qe lidhen me presionet ne atriumin e majte dhe/ose te djathite (shpesh pasqyrojne mbingarkese volumore) dhe me punen e miokardit (shpesh pasqyron mbingarkese presioni ose impedance te larte). Megjithate, matjet e ketyre parametrave shpesh nuk jane te cakte. IK e majte dhe e djathite i referohet sindromave qe paraqiten kryesisht me kongestion te venave sistemike dhe pulmonare, qe cojne ne shenja qe tregojne akumulim te likideve respektivisht me enjtje te kyceve te kembeve ose edeme pulmonare. Shkaku me i shpeshte i insufisances te ventrikulit te djathte eshte rritja ne presionin e arteries pulmonare per shkak te insufisances se ventrikulit te majte qe con ne nje perfuzioni te varfer te veshkes, mbajtjes se kripes dhe ujit, dhe akumulimit te lengjeve ne sistemin qarkullues. IK me debit te ulet dhe te larte i referohet oberservimit te nje numer gjendjesh te vecanta qe japid nje tabllo klinike qe imiton shenjat dhe simptomat e IK. Shkaqe te shpeshta te gjendjeve me debit te larte qe imiton IK jane anemia, tirotoksikoza, septicemia, insuficiencia hepatike, shuntet arteriovenoze, semundja Paget dhe beri-beri. Ne keto gjendje, anomalia primare nuk eshte semundja e zemres dhe patologjite jane te rikthyeshme me mjekim. Gjendjet klinike jane te emertuara me mire si IK, si pasoje e gjendjeve me debit qarkullues te larte dhe jane te rendesishme pasi ato jane te mjekueshme dhe duhet te perjashtohen, kur diagnostikohet IK.

IK e lehte, e moderuar ose e rende eshte perdorur si nje pershkrim simptomatik klinik, ku e lehte eshte perdorur per paciente qe mund te levizin pa kufizime te rendesishme te dispnese ose lodhjes, e rende per paciente qe jane simptomatike te shprehur dhe kane nevoje per perkujdsje te shpeshte mjekesore, dhe e moderuar per grupin e pacienteve qe mbeten. Jane perdorur me shpesh dy klasifikime te rendeses se IK. (tabela 6). Njeri bazohet ne simptomat dhe aftesine ushtrimore [klasifikimi funksional i Shoqates se Kardiologjise te New York-ut (NYHA)^{21,22}]. Klasifikimi sipas NYHA eshte provuar qe eshte klinikisht i dobishem dhe perdoret ne menyre rutine ne shumicen e studimeve klinike te randmizuara. Tjetri e pershkruan IK ne stade te bazuara ne ndryshime strukturale dhe ne simptoma. Te gjithe patientet me IK te qarte i perkasin stadin C dhe D.⁷

Tabela 6 Klasifikimi i IK sipas anomalive strukturale (ACC/AHA) ose sipas simptomave te lidhuara me aftesine funksionale (NYHA)

Stadet e ACC/AHA te IK	Klasifikimi funksional i NYHA
Stadet e IK te bazuara ne strukturre dhe ne demtimin e muskulit te miokardit	Rendesa e bazuar ne simptoma dhe aktivitetin fizik
Stadi A Me risk te larte per te evoluar IK. Anomali strukturale e funksionale te paidentifikuara; pa	Klase I Pa kufizime te aktivitetit fizik. Aktivitet fizik i tepruar nuk shkakton lodhje te tepruar,

Stadi B	shenja ose simptoma Semundje kardiake strukturale qe lidhen fort me shfaqen e IK, por pa shenja ose simptoma	Klasa II	palpitacione ose dispne Kufizim i lehte i aktivitetit fizik. Pa ankesa ne qtesi, por aktiviteti fizik i zakonshem jep lodhje, palpitacione ose dispne
Stadi C	IK simptomatike e lidhur me semundjen strukturale kardiake baze	Klasa III	Kufizim i shprehur i aktivitetit fizik. Pa ankes ne qtesi, por me pak se zakonisht aktiviteti fizik jep lodhje, palpitacione ose dispne
Stadi D	Semundje kardiake strukturale e avancuar dhe simptoma te theksuara te IK ne qtesi pavaresisht terapise medikamentoza maksimale	Klasa IV	E pamundur per te vazhuar ndonje aktivitet fizik pa shqetesime. Simptoma ne qtesi. Nese ndermerret ndonje aktivitet fizik, diskomforti do rritet

ACC-Kolegji Amerikan i Kardiologjise; AHA-Shoqata Amerikane e Kardiologjise. Hunt et al. Circulation 2005;112: 1825-1852. Komiteti i Kritereve te NYHA, Shoqates Kardiologjike te New York. Nomenclatura dhe Kriteret per Diagnoze e Zemres dhe Eneve te Medha, Bot i 9te, Little Brown & Co; 1994. pp 253–256

Epidemiologja

Tani dihet shume per epidemiologjine e IK.²³⁻²⁷ SHEK (ESC) paraqet vendet me nje popullesi >900 milion dhe jane te pakten 15 milion paciente me IK ne keto 51 vende. Prevalencia e disfunkzionit asimptomatik i ventrikulit eshte e ngjashme, keshtu qe IK ose disfunktioni asimptomatik i ventrikulit eshte evidente ne ~4% te popullates. Prevalencia e IK eshte midis 2 dhe 3% dhe rritet shume shpejt rrith moshes 75 vjec, keshtu qe prevalencia ne njerezit e moshes 70-80 vjecare eshte midis 10 dhe 20%. Ne grupet ne moshe me te re, IK eshte me e shpeshte te meshkujt sepse shkaku me i shpeshte, semundje arterieve koronare, ndodh ne dekada me te hershme. Ne mosha me te medha, prealenca eshte e njeje midis sekseve.

Prevalanca e per gjithshme e IK eshte duke u rritur per shkak te plakjes se popullates, suksesit te zgjatjes se mbijeteses se pacienteve qe vuajne nga semundje koronare, dhe suksesit ne shtyerjen e ngjarjeve koronare nga parandalimi efikas ne ata me risk te larte ose ata qe i kane mbijetuar ngjarjes se pare (parandalimi sekondar).^{28, 29} Ne disa vende mortaliteti me pershtatje-moshe nga IK eshte ne renie te pakten pjeserisht ne saje te trajtimeve moderne.^{28,30-32} Mosha mesatare e pacienteve me IK ne komunitet ne vendet e zhvilluara eshte 75 vjec. HFPEF (IKEFR) eshte me e shpeshte te tek moshuarit, femrat dhe tek ato me hipertension ose diabet. IK eshte shkaku i 5% shtrimeve akute ne spital, eshte prezente ne 10% te pacienteve ne shtreter spitali dhe llogaritet per afersisht 2% ne shpenzimet kombetare per shendetin, me shume per shkak te kostos se shtrimeve ne spital. Raportime te pakta e te konsiderueshme jane ndoshta eshte per arsyte preferencave te klinicisteve per diagnozat etiologjike (p.sh. stenoza e aortes) ose diagnosa e nje ko-morbiditeti te madh (p.sh.diabeti)

Prespektiva ne per gjithesi eshte e erret, megjithese disa paciente mund te jetojne per shume vite.^{23,29,34,35} 50% e pacienteve jane te vdekur ne 4 vite. 40% e pacienteve te shtruar ne spita me IK jane te vdekur ose te rishtruar brenda 1 viti.

Studimet tregojne se saktasia e diagnozes se IK vetem nepermjet mjeteve klinike, shpesh eshte e pamjaftueshme, vecanerisht te femrat, te te moshuarit dhe te obezet.^{36,37} HFPEF (IKEFR) (EF >45-50%) eshte prezente ne gjysmen e pacienteve me IK. Prognoza, ne shumicen e studimeve te fundit eshte treguar qe eshte mjaft e ngjashme me ate te IK sistolike.^{38,39}

Etiologja e insufisencies kardiake

Ka nje numer te kufizuar formash/menyrash ne te cilat mund te ndikohet funksioni i zemres. Shkaqet me te shpeshta i demtimit te funksionit te zemres jane demtimi ose humbja e muskulit te zemres, ishemiaakute ose kronike, rezistenca te rritura vaskulare me hipertension, ose shfaqja e nje takiaritmie sich eshte fibrilacioni atrial (FA). Semundja koronare eshte shkaku me i shpeshte i semundjeve te miokardit, duke qene shkaku fillestar i pothuaj 70% te pacienteve me IK.^{28,40} Semundjet valvulare llogariten per rreth 10% dhe kardiomiopatite per 10% te tjera (tabela 7).

Nje kardiomiopati eshte nje crregullim i miokardit ne te cilen muskuli i zemres eshte abnormal ne strukture dhe ne funksion, [ne mungese te semundjeve koronare (SAK), hipertensionit, semundjve valvulare ose semundjeve kongjenitale te zemres] mjaftueshem per te shkaktuar anomaline e verejtur te miokardit.⁴¹

Nje klasifikim i kardiomiopative eshte publikuar se fundmi nga Grupi i Punes per Semundjet e Miokardit dhe te Perikardit nga SHEK (ESC).⁴¹ Shoqata Amerikane e Kardiologjise (AHA) ka nxjerre nje formulim shkencor.⁴² Te dyja marrin parasysh perparimet e medha te bera se fundmi per te kuptuar origjinat gjenetike dhe biologjine e kardiomiopative. Propozimi Evropian eshte drejtuar nga lidhja e klasifikimit te ri me praktiken klinike te perditshme dhe mban fenotipin morfo-funksional te perkufizuar me pare te cilet jane nenndare me tej ne forma gjenetike familjare dhe jogjenetike jo-familjare. Klasifikimi Evropian braktisi dallimin e vjeter midis kardiomiopatise “primare” dhe “sekondare” dhe nuk perfshin ne kardiomiopatite kanalopatite e joneve.

Tabela 7. Shkaqet me te shpeshta te IK per shkak te semundjeve te muskulit te zemres (semundjet e miokardit)

Semundjet koronare	Manifestime (shfaqje) te shumta
Hipertensioni	Shoqerohet shpesh me hipertrofi te VM dhe EF te ruajtur
Kardiomiopatite	Familjare/gjenetike ose jofamiljare.jogjenetike (duke perfshire dhe te fituara p.sh.miokarditi
Medikamente	B-bllokuesit, antagonistet e kalciumit, antiaritmiket, agjentet citotoksike
Toksinat	Alkool, mjekime, kokaina, elementet si markues (merkuri, kobalti, arseniku)
Endokrine	Diabeti Mellitus, hipo/hipertireodizmi, sindromi Cushing, insuficiencia adrenale, hormoni i rritjes i tepert, feokromacitoma
Ushqimore	Deficit ne tiamine, selenium, carnitine. Obesitet, kahekzi
Infiltrative	Sarkoidoza, amiloidoza, hemokromatoza, semundje te indit lidhor
Te tjera	Semundje Chaga's, infektion HIV, kardiomiopatia peripartum, insuficiencie renale ne stadin terminal

Diagnoza e insuficiences kardiane

Ne vitin 1933 Z.Thomas Lewis, shkruajti ne librin e tij per semundjet e zemres, qe “Thelbi i vertete i mjekesise cardiovaskulare eshte njohja e IK te hershme”.⁴³

Simptomat dhe shenjat e IK

Simptomat dhe shenjat e IK jane celesi i zbulimit te hershem, sepse kjo eshte ajo cfare i ben te semuret te kerkojne perkujdesje mjekesore. Te marresh nje anamneze te mire dhe te besh nje ekzaminim te kujdeshem fizik jane aftesi, te cilat jane te rendesishme per njohjen e patologjise. (Tabela 8). Veshtiresia ne frymemarrje dhe lodhja jane simptomat karakteristike, por nxjerra dhe vleresimi i ketyre simptomave ne vecanti ne moshat e medha kerkon eksperience dhe mjeshteri.⁴⁴⁻⁴⁶ Shenjat klinike te IK (Tabela 9) duhet te vleresohej ne nje ekzaminim fizik shume te kujdeshem, ku perfshihen observimi, palpimi dhe auskultimi.⁴⁷⁻⁵¹ Sikurse simptomat, shenjat e IK te hershme mund te jene te veshtira per t'u interpretuar, jo vetem tek te moshuarit por edhe tek obeset. Dyshimi klinik i IK duhet te konfirmohet nga me shume teste objektive, ne vecanti te sunohet vleresimi i funksionit kardiak.

Tabela 8 Karakteristika kyce te historise klinike te paciente me IK

Simptomat	Veshtire ne fryshtime Lodhje Angina, palpitacione, sinkop	(ortopne, dispne paroksismale nocturne) (lodhje, rraskapitje)
Ngjarje kardiovaskulare	Semundje koronare Infarkt miokardi Nderhyrje Kirurgji te tjera AVC ose semundje vaskulare periferike Semundje valvulare ose disfunkzion	Tromboliza PCI CABG
Profili i riskut	Histori familjare, duhani, hiperlipidemja, hipertensioni, diabeti.	
Pergjigje ndaj terapise te meparshme ose aktuale		

Tabela 9 Vecori kyce te ekzaminimit klinik te pacientet me IK

Pamja e jashtme	Gjalleria, gjendja ushqimore, pesha
Pulsi	Frekuencia, ritmi dhe lloji
Presioni i gjakut	Presioni sistolik, diastolik dhe i pulsit
Mbingarkese me likide	Presioni venoz jugular Edema periferike (kembet dhe sakrumi) Hepatomegali, ascit)
Mushkerite	Frekuencia respiratore Rale Likid pleural
Zemra	Zhvendosje e apeksit Ritem galopi, Toni i trete Zhurma qe sygjerojne disfunkzion valvular

Shkaqet e symptomave ne insuficiencen kardiak

Origjina e symptomave te IK nuk eshte kuptuar plotesisht.⁵²⁻⁵⁵ Presioni kapilar pulmonar i rritur eshte padyshim perjeqjes per edemen pulmonare dhe veshtiresine ne fryshtime ne kontekstin e IK akute dhe me shenja te dukshme te mbingarkeses me likide. Ne kontrast, studimet e kryera gjate eforave ne paciente me IK kronike treguan vetem nje lidhje te vogel midis presionit kapilar dhe performances ushtrimore. IK eshte nje semundje qe rezulton ne

patologjine e pothuaj te gjithave organeve te trupit. Lodhja eshte nje nga simptomat me te shpeshta te referuara, por jane jo-specifike per arsyet te shumta. Nje manifestim i vone eshte renia e fuqise dhe humbja e mases muskulare.^{55,56} Shenjat nga muskulit skeletik shpesh intrepretohen nga truri si veshtiresi ne frymemarje ose lodhje. Kjo mund te shpjegoje pse perqiijga nga terapise mund te jete e ngadalte te pacientet me IK, sepse cilesia e muskulit skeletik duhet te rekuperohet. Luhatje ne shkallen e regurgitimit mitral ose disritmitore tranzitore te shpeshta ne IK, do perkeqesojne veshtiresine ne frymemarrje.

Simptomat dhe rendesa e insuficiences kardiake

Ka nje lidhje te dobet midis simptomave dhe rendeses se disfunkzionit kardiak. Simptomat jane te lidhura me ngushte me prognozen nese ato persistojne pas terapise dhe mund te perdoren per te klasifikuar rendesen e IK dhe per te monitoruar ndikimin e terapise. Megjithate, vetem simptomat nuk duhet te drejtojne titrimin e inhibitoreve neurohormonal sic jane inhibitoret e enzimes se konvertimit se angiotenzines (ACE inhibitoret), blokuesit e receptoreve te angiotenzines (ARB), betablokuesit ose antagonistet e aldosteronit, sepse keto ilace ndikojne ne nje menyre qe nuk eshte e lidhur ngushte me simptomat. Pacient duhet te titrohen ne doza optimale te tolerueshme.

Rendesa e IK shpesh klasifikohet sipas klasifikimit funksional te NYHA. Nje klasifikim me i fundit bazohet ne te dyja, ne strukture e zemres dhe ne simptoma. Ne kontekstin e IM (infarktit te miokardit), perdoren dy klasifikime te tjera, Killip⁵⁷ dhe Forrester⁵⁸ (Tabela 10).

Tabela 10 Dy klasifikime te severitetit te IK ne kontekstin e infarktit akut te miokardit

Klassifikimi Killip		Klassifikimi Forrester
I krijuar per te arritur nje vleresim klinik i severitetit te crregullimit cirkulator ne trajtimin e IAM		I krijuar per te pershkruar gjendjen hemodinamike dhe klinike ne IAM
Stadi I	Pa insuficience kardiake Pa shenja klinike te dekompesimit kardiak	1. Perfuzion dhe PCWP normal (PCWP-vleresoheni nga presioni i atrimit te majte
Stadi II	Insuficience kardiake Kriteret diagnostikuese perfshijne ralet, galop me ton III dhe hypertension venoz pulmonar Kongestion pulmonar me rale te njoma ne gjysmen e poshtme te fushave pulmonare	2. Perfuzion i paket dhe PCWP i ulet (hipovolemik)
Stadi III	IK severe Edeme pulmonare e qarte me rale ne te gjitha fushat pulmonare	3. Pothuaj perfuzion normal dhe PCWP i larte (edeme pulmonare)
Stadi IV	Shok kardiogjen Shenja qe perfshijne hipotension (TAS <90mmHg) dhe te dhenaper vazakonstriksion periferik sic eshte oliguria, cianoza dhe djersitja	4. Perfuzion i paket dhe PCWP i larte (shok kardiogjen)

Killip T 3rd, Kimball JT. Trajtimi i infarktit te miokardit ne njesine koronare. Nje eksperience dy vjecare me 250 paciente. *AM J Cardiol* 1967;20:457-145.

Forrester JS, Diamond GA, Swan HJ. Klasifikimi korrelativ e funksionit klinik dhe hemodinamik pas infarktit akut te miokardit. *AM J Cardiol* 1977;39:137-145

Algoritmi i diagnozes se insuficencies kardiake

Ne figuren 1 tregohet nje algoritem per diagnozen e IK ose disfunktionsit te VM. Diagnoza e IK nuk eshte e mjaftueshme e vetme. Kerkime me te pershatshme kerkohet per te provuar shkakun e IK, sepse ndonese trajtimi i pergjithshem i IK eshte i zakonshme per shumicen e pacienteve, disa shkaqe kerkojne trajtime specifike qe mund te jene te saktë.

Ekzaminimi klinik, EKG, Radiografi
toraksi, Ekokardiografi




Figura 1. Grafiku per diagnozen e IK me peptidet natriuretike te pacientet e pamjekuar dhe me simptoma sugjestionuese per IK.

Teknikat diagnostikuese

Testet diagnostikuese ne insuficiencen kardiale

Shume teste diagnostikuese perdoren ne menyre rutine per te konfirmuar ose perjashtuar diagnozen e IK (Tabela 11). Testet diagnostikuese zakonisht jane me te ndjeshme per zbulimin e te semureve me IK dhe me EF te ulur. Rezultatet diagnostikuese jane me pak te sakta ne te semuret me IKEFR (HFPEF). Ekokardiografia eshte metoda më me vlore per vleresimin e disfunktionshit sistolik dhe diastolik.

Kerkimet e meposhtme jane konsideruar te pershatshme ne pacientet me IK. Megjithate, rekomandimet paraqesin kryesisht opinioni e konsensusit te eksperteve pa evidencia te mjaftueshme te dokumentuara. Niveli i evidences C aplikohet nese ne te kundert eshte konstatuar.

Tabela 11. Vleresime diagnostikuese qe mbeshtesin pranine e IK

Vleresimi	Diagnoza e insuficencës kardiakë		
	Mbeshtetet eshte e pranishem	nese eshte normale	Kundershtohet ose mungon
Simptoma te pajtueshme	++	++	
Shenja te pajtueshme	++	+	
Disfunkcion kardiak ne ekokardiografi	+++	+++	
Pergjigje e symptomave ose shenjave ndaj terapise	+++	++	
EKG			
Normal			++
Anormal	++	+	
Disritmitë	+++	+	
Laboratori			
BNP/NT-proBNP e rritur	+++	+	
BNP/NT-proBNP e ulet/normale	+	+++	
Hiponatremi	+	+	
Disfunkcion renal	+	+	
Rritje e lehte e troponinave	+	+	
Radiografia e kraharorit			
Kongjestion pulmonar	+++	+	
Kapacitet i ulet ne eforte	+++	++	
Teste anormale te funksionit pulmonar	+	+	
Hemodinamike anormale ne qetesë	+++	++	

+ = disi e rendesishme, ++ = rendesi e mesme, +++ = rendesi e madhe

Elektrokardiograma

Nje EKG duhet te kryhet te cdo paciente me IK te dyshuar.

Ndryshime ne EKG jane te zakonshme ne paciente qe dyshohen te kene IK (Tabela 12). Nje EKG anormale ka vlera te pakta parashikuese per prezencen e IK. Nese EKG eshte komplekt normale, veshtire se mund te thuhet (<10%) se ka IK, vecanerisht ne disfunkzionit sistolik.

Tabela 12 Anomali te zakonshme te EKG ne insuficiencen kardiake

Anomalite	Shkaqet	Implikime klinike
Takikardia sinusale	IK e dekompesuar, anemi, ethe, hipertiroidizem	Vleresim klinik Ekzaminime laboratorike
Bradikardi sinusale	β-bllokade, digoksin Antiaritmiket Hipotiroidizem Sindromi i sinusit te semure	Te vleresohet terapia medikamentoze Ekzaminime laboratorike
Takikardi/flater/fibrilacion atrial	Hipertiroidizem, infeksione, semundje te v mitrale IK e dekompesuar, infarkt	Percim i ngadalte AV, konversion medikamentoz, elektroversion, ablation me kateter, antikoagulim
Aritmite ventrikulare	Ishemia, infarkt, kardiomiopatite, miokarditi, hipokalemia, hipomagnezemia Mbidozim i digitalit	Ekzaminime laboratorike Prove eforti, studime perfuzioni, koronarografi, studim elektrofiziologjik, ICD
Ishemia/infarkt	Semundje koronare	Eko, troponina, koronarografi, revaskularizim
Vale Q	Infarkt, kardiomiopati hipertrofike, BDM, pre-eksitimi	Eko, koronarografi
Hipertrofi e VM	Hypertension, semundje te v aortes, kardiomiopatia hipertrofike	Eko/Doppler
Bllok AV	Infarkt, toksicitet medikamentoz, miokardit, sarkoidoze, Semundja Lyme	Te vleresohet terapia medikamentoze, pacemaker, semundje sistemike
Mikrovoltazh	Obesitet, emfizeme, likid perikardial, amiloidoze	Eko, radiografi toraksi
Gjatesia e QRS >120 ms e morfolojjise se BDM	Dissinkroni elektrike dhe mekanike	Eko, CRT-P, CRT-D

Radiologjia e kraharorit

Radiologjia e kraharorit eshte nje komponent i rendesishem i punes diagnostikuese ne IK. Ajo na lejon vleresimin e kongestionit pulmonar dhe mund te tregoje shkaqe te rendesishme pulmonare ose torakale te dispnese.

Radiologjia e kraharorit (ne dy plane) eshte e dobishme per te zbuluar kardiomegaline, kongestionin pulmonar dhe akumulimin e likid pleural dhe mund te tregoje pranine e infeksioneve ose semundjeve pulmonare qe shkaktojne ose kontribojne ne dispne (Tabela 13).

Pervec kongestionit, te dhenat e gjetura jane parashikuese per IK vete mne kontekstin e shenjave dhe simptomave tipike. Kardiomegalia mund te mos jete e pranishme jo vetem ne IK akute por edhe ne ate kronike.

Tabela 13 Anomalite te zakonshme te radiografise se toraksit ne IK

Anomalite	Shkaqet	Implikime klinike
Kardiomegali	VM, VD dhe atriume te dilatuara Likid perikardial	Eko/Doppler
Hipertrofi ventrikulare	Hipertension, stenoze aorte, kardiomiopati hipertrofike	Eko/Doppler
Parametra pulmonare normal	Veshtire te thuhet per kongestion pulmonar	Te rikonsiderohet diagnoza (nese eshte e pamjekuar) Veshtire te thuhet per semundje serioze te mushkerive
Kongestion pulmonar venoz	Presione mbushese te VM te rritura	Insuficience e majte e konfirmuar
Edeme intersticiale	Presione mbushese te VM te rritura	Insuficience e majte e konfirmuar
Likid pleural	Presione mbushese te rritura IK e mundshme, nese eshte bilaterale Infeksione pulmonare, kirurgji ose efuzione malinje	Te konsiderohet etiologja jo-kardiake nese eshte abundante Nese eshte abundante, te kohen ne konsiderate qendra diagnostikuese ose terapeutike
Linja Kerley B	Presione limfatike te rritura	Stenoze mitrale ose IK kronike
Fusha pulmonare te hipervaskularizuara	Emfizeme ose emboli pulmonare	CT spirale, spirometri, Eko
Infeksione pulmonare	Pneumonia mund te jetë si pasoje e kongestionit pulmonar	Te trajtohen te dyja, infeksioni dhe IK
Infiltrime pulmonare	Semundje sistemike	Puna diagnostikuese

Testet laboratorike

Nje vleresim rutin diagnostik i te semureve qe dyshohen per IK perfshin nje analize gjaku komplet (hemoglobinen, leukocitet dhe trombocitet), elektrolitet, kreatinin, shpejtesine e fitrimit glomerular (GFR), glukoze, analizat te funksionit hepatik dhe te urines. Analize shtese duhen bere ne varesi te tabllose klinike (Tabela 14). Anomali te dukshme hematologjike dhe te

elektroliteve jane te pazakonta ne IK te lehte ne te moderuar te pamjekuar, megjithese anemi e lehte, hiponatremi, hiperkalemi dhe funksion renal i rene jane te zakonshme, vecanerisht ne te semuret te trajtuar me terapi me diuretike dhe ACEI/ARB/antagoniste te aldosteronit. Monitorimi laboratorik i duhur eshte i rendesishem gjate fazave te fillimit, titrimit dhe ndjekjes te pacienteve qe marrin terapine medikamentoze per IK.

Tabela 14 Anomalite te zakonshme te testeve laboratorike ne IK

Anomalite	Shkaqet	Implikime klinike
Kreatinin ne serum e rritur ($> 150 \mu\text{mol/L}$)	Semundje renale ACEI/ARB, bllokade aldosteroni	Te llogaritet GFR Te konsiderohet pakesimi i dozes se ACEI/ARB ose bllokuesve te aldosteronit Te kontrollohet potasiumi ose BUN
Anemi ($< 13 \text{ g/dL}$ te meshkujt, $< 12 \text{ te femrat}$)	IK kronike, hemodilutim, humbje e hekurit ose perthithje e paket, insuficience renale, semundje kronike	Puna diagnostikuese Te kihet parasysh mjekimi
Hiponatremia ($< 135 \text{ mmol/L}$)	IK kronike, hemodilutim, clirim i AVP, diuretike	Te konsiderohet kufizimi i ujit, duke ulur dozen e diuretikeve Ultrafiltrimi, antagonistet vasopresine
Hipernatremia ($> 150 \text{ mmol/L}$)	Hiperglicemia Dehidrim	Te vleresoheret marja e ujit Puna diagnostikuese
Hipokalemi ($< 3.5 \text{ mmol/L}$)	Diuretike, hiperaldosteronizem sekondar	Risku i aritmive Te konsiderohen suplemente potassiumi, ACEI/ARB, bllokues te aldosteronit
Hiperkalemia ($> 5.5 \text{ mmol/L}$)	Insuficience renale, suplemente te potassiumit, bllokues te sistemit renin-angiosteron-aldosteron	Te ndalohet trajtimi me mbajtes te potassiumit (ACEI/ARB, bllokues te aldosteronit) Te vleresoheret funksioni renal dhe ph
Hiperglicemi (6.5 mmol/L)	Diabet, rezistence insuline	Risku i bradikardise Te vleresoheret hidratimi, te trajtohet intoleranca e glukozess
Hiperuricemia ($> 500 \mu\text{mol/L}$)	Trajtimi me diuretike, podagra, semundje malinje	Allopurinol Te pakesoheret doza e diuretikeve
BNP $> 400 \text{ pg/mL}$,	Stresi muror ventrikular i	Ik e mundshme

NT-proBNP >2000 pg/mL	rritur	Indikacione per eko Te konsiderohet trajtimi
BNP <100 pg/mL, NT-proBNP <400 pg/mL	Stresi muror normal	Te rivleresohet diagnoza Veshtire se mund te thuhet per IK nese eshte e pamjekuar
Albumine e larte (>45 g/L) Albunime e ulet (<30 g/L)	Dehidrim, mielome Ushqyerje e varfer, humbje renale	Rehidrim Puna diagnostikuese
Transaminaza te rritura	Disfunkcion i melcise Insuficience e djathte	Puna diagnostikuese Kongestion i heparit
Tropoina te rritura	Toksicitet medikamentoz Nekroze e miociteve Ishemi e zgjatur, IK severe, miokardit, sepsis, insuficience renale, emboli pulmonare	Te rikonsiderohet terapia Te vleresohet paterni i rritjes (rritje e lehte e zakonshme ne IK severe) Koronarografi Vleresim per revaskularizim
Teste anormale te tiroides	Hiper/hipotiroidizem Amiodaron	Te trajtohet anomalia e tiroides
Analiza e urines	Porteinuri, glukozuri, bakterie	Puna diagnostikuese
INR >2.5	Mbidozim i antikoagulanteve Kongestion i melcise	Te perjashtohet infektioni Te vleresohet doza e antikoagulanteve Te vleresohet funksioni hepatic Te percaktohet doza e antikoagulanteve
CRP >10 mg/L, leukocitoze neutrofilike	Infekzion, inflamacion	Puna diagnostikuese

Peptidet natriuretike

Perqendrimet plazmatike te peptideve natriuretike jane biomarkues te dobishem per diagnozen e IK dhe ne menaxhimin e te semureve me IK kronike. Faktet mbeshtesin perdonimin e tyre per diagnostikimin, percaktimin e statit, marrjen e vendimeve per hospitalizim ose nxjerrje nga spitali te te semureve, dhe ne identifikimin e pacienteve me risk per ngjarje klinike. Te dhenat per perdonimin e tyre ne monitorimin dhe rregullimin e terapise medikamentoze nuk eshte mjaft e qarte. Nje perqendrim normal ne te nje pacient te pamjekuar ka nje vlere prediktive negative te larte dhe e ben IK nje shkak jo te mundshem te simptomave. Kjo mund te luaje nje rol te rendesishem vecanerisht ne kujdesin shendetesor paresor. Nivele te larta te peptise natriuretike tregonje nje prognoze te keqe pavaresisht trajtimit optimal.

Matjet e peptidi natriuretik tip B (BNP) dhe peptidi natriuretik pro B terminali N (NT-proBNP) jane paraqitur si mjete diagnostikuese⁵⁹ dhe menaxhuese⁶⁰ per IK (Figura 1). Ato rriten si per gjigje e rritjes se stresit muror te miokardit. Nivele te uleta jane vene re zakonisht ne paciente me funksion sistolik te VM te ruajtur. Nuk ka asnje vlere limit te percaktuar te

njihet per ndonjerin nga dy peptidet natriuretike per te vleresuar diagnozen e IK ne departamentin e urgjencës. Per shkak te gjysme jetes relativisht te gjate te peptideve natriuretike, ndryshime te menjehershme te presioneve mbushes se VM mund te mos reflektohet nga ndryshime te menjehershme te peptideve. Situata te tjera pavec IK që shoqerohen me nivele te larta te peptitit natriuretik perfshihen: hipertrofia e VM, takikardia, mbingarkesa e ventrikulit te djathte, ishemia miokardiale, hipoksemia, disfunksioni renal, mosha e madhe, cirroza hepatike, sepsi dhe infeksioni. Peptide natriuretike mund te jene te dobishme per te vleresuar progozen perpara daljes nga spitali dhe per te monitoruar efikasitetin e terapise se IK.^{61,62}

Troponinat

Troponina I ose T duhen te merren ne IK te dyshuar kur tablloja klinike sugjeron një sindrom koronar akut (SAK). Nje rritje e troponina kardiake do te thote per nekroze te miociteve dhe nese kjovertetohet, duhet te shihet mundesa e revaskularizimit dhe te kryhet pune diagnostikuese e duhur. Nje rritje e troponinave ndodh gjithashtu edhe ne miokarditin akut. Rritje te lehta te troponina kardiake eshte pare ne IK te rende ose gjate episodeve te dekompesimit te IK ne paciente pa te dhena per ishemi miokardiale si pasoje e sindromit koronar akut dhe ne gjendje sic eshte sepsis. Nje rritje e troponina eshte një markues prognostik i forte ne IK, vecanerisht ne pranine e peptideve natriuretike te rritura.⁶³

Markuesit neurohormonal

IK shoqerohet me rritje te nje sere markuesish te tjere neurohormonal (norepinefrina, renina, aldosteroni, endotelina, vazopresin arginina). Megjithese jane te dobishme ne studime, vleresimi i aktivitetit neuroendokrin nuk kerkohet per qellime diagnostikuese ose prognostike per paciente ne vecanti.

Ekokardiografia

Termi ekokardiografi eshte perdonur per t'ju referuar te gjitha teknikave imazherike kardiake me ultratinguj, duke perfshire Dopplerin pulsues dhe te vazhdueshem, Dopplerin me ngjyra dhe imazhet e Dopplerin indor (TDI).

Konfirmimi me ekokardiografi i diagnozes se IK dhe/ose i disfunksionit kardiak eshte i detyrueshem dhe duhet kryer menjehere kur dyshohet diagnoza e IK. Ekokardiografia eshte kudo e disponueshme, e shpejte, jo-invazive dhe e sigurt dhe na jep informacion te gjere per anatominë e zemrës (volumet, gjeometrine, masen), levizjen e mureve dhe funksionin e valvulave. Studimi na jep informacion te rendesishem per etiologjinë e IK. Ne perjithesi diagnoza e IK duhet te perfshije një ekzaminim me ekokardiografi.

Matja me praktike per funksionin e ventrikulit, per te dalluar pacientet me disfunksion sistolik me ata me funksion sistolik te ruajtur eshte EF e VM (norma >45-50%). Vlera kufi eshte disi arbitrare. EF i VM nuk eshte sinonim me indekset e kontraktilitetit, duke qene se varet shume nga volumet, parangarkesa, pasngarkesa, frekueca kardiake dhe funksioni i valvulave. Volumi hedhes (SV) mund te ruhet nga dilatimi i zemrës dhe volumet e rritura. Tabelat 15 dhe 16 paraqesin anomalite me te shpeshta ekokardiografike dhe te Dopplerit ne IK.

Tabela 15 Anomali te zakonshme ekokardiografike ne insuficiencen kardiake

Matje	Anomalite	Implikime klinike
Fraksioni i ejekzionit te VM	I ulur (<45-50%)	Disfunkcion sistolik
Funksioni i VM, global dhe fokal (ose vatror)	Akinezi, hipokinezi, diskinezi	Infarkt/ishemi miokardi
Diametri telediastolik	I rritur (>55-60 mm)	Kardiomiopati, miokardit
Diametri telesistolik	I rritur (>45 mm)	Mbingarkese volumore
Fraksioni i shkurtimit	I ulur (<25%)	IK e mundshme
Permasat e AM	I rritur (>40 mm)	Mbingarkese volumore
Trashesi e VM	Hipertrofi (>11-12 mm)	IK e mundshme
Struktura dhe funksioni valvular	Stenoze ose regurgitim valvular (veçanerisht stenoze arte dhe insuficience mitrale)	Disfunkcion i v mitrale
Profili diastolik i fluksit mitral	Anomali te paternit diastolik mbushes te hershem e te vone	Fibrilacion atrial
Shpejtesia maksimale e regurgitimit trikuspidal	E rritur (>3 m/s)	Hipertension, stenoze aorte, kardiomiopati hipertrofike
Perikardi	Likid, hemoperikard, trashje	Mund te jetë shkaku primar i IK ose faktori komplikues
Integrali kohe-shpjetesi i fluksit aortik	I ulur (<15 cm)	Te vleresoohen gradientet dhe fraksioni regurgitues
Vena cava inferior	Fluksi retrograd i dilatuar	Te vleresoohen
		konsequencat
		hemodinamike
		Te konsiderohet kirurgjia
		Tregon disfunkcion diastolik dhe sugejron mekanizmin
		Presion i rritur sistolik i VD
		Te dyshohet hypertension pulmonar
		Te konsiderohet tamponada, uremia, semundje malinje, semundje sistemike, perikardit akut ose kronik, perikardit konstriktiv
		Debiti kardiak i ulet
		Presione te rriture te AD
		Disfunkcion i VD
		Kongestion hepatik

Tabela 16. Treguesit ekokardiografik-Doppler dhe mbushja ventrikulare

Treguesit Doppler	Paterni	Konseguencat
Raporti i valeve E/A	Restrikтив (>2, kohe e ulet e decelerimit <115 ne 150 ms)	Presione te larta mbushese Mbingarkese volumore
	Relaksim i ngadalte (<1)	Presione mbushes normale Kompliance e varfer
	Normal (>1)	Jokonkluduese pasi mund te jete pseudo-normale
E/Ea	I rritur (>15)	Presione te larta mbushese
	I ulur (<8)	Presione te ulura mbushese
	Te ndermjetme (8-15)	Jokonkluduese
Zgjatja (A mitral – A pulmonar)	>30 mm	Presione mbushese normale
	<30 mm	Presione te larta mbushese
Vala pulmonare S	>vala D	Presione te ulta mbushese
Vp	<45 cm/s	Relaksim i ngadalte
E/Vp	>2.5	Presione te larta mbushese
	<2	Presione te ulta mbushese
Manovra e Valsaves	Nryshim i paternit mbushes pseudonormal ne anormal	Zbulon presione te larta mbushese ne terren te disfunkzionit sistolik dhe diastolik

Vleresimi i diastolik te ventrikulit te majte

Vleresimi i funksionit diastolik duke perdonur paternit e mbushjes se ventrikulit eshte i rendesishem per te zbuluar anomalite e mbushjes ose te funksionit diastolik te pacientet me IK. Kjo mund te jete anomalia predominuese funksionale e zemres, duke plotesuar keshte komponentin e trete te nevojshem per diagnozen e IK. Kjo eshte vecanerisht e vertete te pacientet simptomatike me EF te VM te ruajtur. Nje flete konsensusi nga Shoqata e

Insificences kardiake, eshte fokusuar ne vleresimin e funksionit diastolik ne HFPEF (IKEFR-IK me EF te ruajtur).⁶⁴

Te pacientet me ritem sinusal njihen tre lloje te paterneve anormale te mbushjes se ventrikulit.

1. Paterni i “crregullimit” te relaksimit ventrikular, qe karakterizohet me ulje te shpejtesise maksimale E te fluksit transmitral (vala E), me rritje kompesatore te shpejtesise (A) te induktuar nga atriumet (vala A) dhe per rrjedhoje ne fazat e hershme te disfunkzionit diastolik mund te shihet nje ulje e raportit E/A; kjo shihet me shpesh ne hypertension dhe te subjekti normal i moshuar dhe zakonisht shoqerohet me presione normale ose te uleta te mbushjes se VM.
2. Ne pacientet me presione te rritura te atriumit te majte, (ulje e kompliances se VM, mbingarkese volumore, insufisience mitrale), mund te kemi nje patern te “mbushjes restriktive” me vale E te rritur, zvogelim te kohes E te decelerimit dhe rritje te theksuar te raportit E/A.
3. Te pacientet me patern te ndermjetem midis crregullimit te relaksimit ventrikular dhe paternit restriktiv te mbushjes, rapporti E/A dhe koha e decelerimit mund te jene normal, dhe mund te shihet ai qe quhet “paterni pseudonormal i mbushjes”. Ky patern mund te dallohet nga ai normal nepermjet analizes te variablate te tjera me Doppler sic eshte fluksit ne venen pulmonare ose Doppleri indor (TDI) i levizjes se planit mitral.

Ekokardiografia me Doppler lejon vleresimin e presionit sistolik ne arterien pulmonare. Kjo perftohet nga llogaritja e presionit sistolik te ventrikulit te djathte e vleresuar nga shpejtesia maksimale e regurgitimit trikuspidal qe eshte prezente ne shumicen e subjekteve. Kjo lejon gjithashtu vleresimin e volumit hedhes (SV) dhe te debitit kardiak duke matur integralin kohe shpejtesi (VTI) te fluksit te aortes.

Vleresimi i insufisiences kardiake me fraksioni ejekzioni te ruajtur (IKEFR-HFPEF)

Ekokardiografia luan nje rol madhor ne konfirmimin e diagnoses se IKEFR (HFPEF). Diagnoze e IKEFR kerkon tre kushte per t'u plotesuar:

1. Pranine e shenjave ose/dhe simptomave te IK kronike.
2. Prania e funksionit sistolik te VM normal ose lethesisht anormal ($EF \geq 45\%-50\%$)
3. Te dhena per disfunkzion diastolik (crregullim i relaksimit te VM ose ngurtesi diatolike)

Ekokardiografia transezofageale

Ekokardiografia transezofageale (TEE) rekomandohet te pacientet qe kane nje dritare transtorakale jo te mire (pacientet obeze, me hiperventilacion), ne paciente te komplikuara valvular (vecanerisht ne valvulat mekanike, aortale dhe mitrale), ne endokardit te dyshuar, ne semundje kongjenitale te zemres ose per te perjashtuar ndonje tromb ne aurikulen e majte te pacientet me fibrilacion atrial.

Ekokardiografia e stresit

Ekokardiografia e stresit (eko sforcimi ose dobutamine) perdoret per te zbuluar disfunkzionit ventrikular te shkaktuar nga ishemia dhe per te vleresuar viabilitetin miokardiale ne prani te akinezise ose hipokinezise te shprehur. Mund te jete me vlere per te identifikuar stuning te miokardit, hibernimin (letargjine) dhe per te lidhur simptomat e IK me anomali valvulare. Ne paciente me IK, stres eko mund te kete sensivitet dhe specifitet te ulet si pasoje e dilatacion te VM ose te pranise se bllokut te deges se majte (BDM).

Teste te tjera imazherike jo invazive

Te paciente, tek te cilet ekokardiografia ne qetesë nuk na ka dhene informacion te mjaftueshem dhe te paciente me semundje te arterieve koronare te dyshuar, imazheri te tjera jo invazive perfshijne rezonancen magnetike (CMR), tomografine e kompjuterizuar kardike (skaneri i zemrës) ose imazherine me radionukleide.

Rezonance magnetike e zemrës (CMR)

Rezonanca magnetike është një teknike imazherike jo invazive, e gjithanshme, e sakte per vleresimin e volumeve te ventrikulit te majte e te djathte, funksionit global, levizjen murore, trashesine e miokardit, masa dhe tumore miokardiale, valvula kardiak, defekte kongjenitale dhe semundje te perikardit.^{65,66} Rezonaca është konsideruar si një standard i arte i saktesise dhe prodhueshmerise per vleresimin e volumeve, mases dhe levizjes murore. Perdorimi i agjenteve paramagnetike te konstrastit sic janë gadolinium mund te na jepin te dhena per inflamacionin, infiltrimin dhe cikatricen ne paciente me infarkt, miokardit, perikardit, kardiomiopati, semundje depozituese dhe infitruese. Kufizimet perfshijne koston, disponueshmerine, paciente me disritmi ose me pajisje te implantuara dhe intolerancen e pacientit.

Skaneri (CT)

Te pacientet me IK, diagnoza jo invasive e anatomise koronare mund te jete me vlere dhe ndihmon ne vendime qe kane te bejne me angiografine koronare. Angiografia me skaner mund te merret ne konsiderate te paciente me probabilitet pre-testi te ulet ose te ndermjetem per semundje te arterieve koronare dhe ne stres-test ose imazherik te dyshimte.⁶⁶ Demostrimi i aterosklerozes ne një skaner koronar konfirmon semundjen e arterieve koronare, por nuk le te nenkuptohet ishemia.

Ventrikulografia radionuklide

Ventrikulografia radionuklide njihet si një metode relativisht e sakte per percaktimin e EF te VM dhe perdoret me shpesh ne kontekstin e scanimit te perfuzionit te miokardit duke perfshuar informacion mbi ishemine dhe pjesen e shendetshme te miokardit. Ka vlere te kufizuar ne vleresimin e volumeve ose te indekseve te tjera te funksionit sistolik dhe diastolik.

Testet e funksionit pulmonar

Matjet per funksionin pulmonar kane vlore te kufizuar ne diagnozen e IK. Megjithate keto teste jane te dobishme per te vertetur ose perjashtuar shkaqet respiratore te veshtiresise ne frymemarrje dhe per te vleresuar kontributin potencial te semundjeve te mushkerive per dispnene e pacienteve. Spirometria e kryer ne rruge rutine vlereson perhapjen e semundjes obstruktive. Niveli i gazeve ne gjak eshte ne norme ne nje IK kronike te kompesuar mire. Nje renie e saturimit arterial te oksigjenit duhet te na drejtoje ne kerkimin e diagnozave te tjera.

Testimi ne efort

Testimi ne efort, dmth testi ne nje sforcim, eshte i dobishem per vleresimin objektiv te aftesise se sforcimeve dhe simptomave ne efort, sic jane dispneja dhe lodhja. Test i ecjes per 6 minuta eshte nje mjet i thjeshte, frytdhenes dhe jo i veshtire qe zakonisht perdoret per te vleresuar kapacitetin funksional submaksimal dhe per gjigjen ndaj nderhyrjes. Nje test eforti maksimal normal ne nje pacient qe nuk merr mjekim e perjashton diagnozen e nje IK simptomatike. Me nje protokoll te modifikuar te IK, mund te perdoret si cikloergometria ose tapeti duke bere nje rritje te ngadalte te ngarkeses. Analiza e shkembimit te gazeve gjate efortit eshte e preferueshme pasi na jep nje matje frytdhenese te larte te kufizimit te efortit si dhe depertim ne diferencimin e dispnese me origjine kardiake nga ajo respiratore, vlereson eficiencen respiratore dhe jep informacion per prognozen. Shfrytezimi maksimal i oksigjenit (VO_2 i pikut) dhe pragu anarobik jane prediktore te dobishem te kapacitetit funksional te pacientit, dhe VO_2 i pikut e renie VE/VCO_2 (per gjigja ventilatore ndaj efortit) eshte nje variable prognastike madhore. Raporti i pikut i shkembimit respirator eshte nje indeks i nevojshem i shkalles se anaerobiozes se arritur. Ka nje koleracion te varfer midis kapacitetit te efortit, EF dhe shumices se matjeve hemodinamike ne qetes.

Monitorimi elektrokardiografik ambulator (Holter)

Monitorimi ambulator me EKG eshte me vlore ne vleresimin e pacienteve me simptoma qe sugjerojne ndonje aritmi (p.sh. palpitacione ose sinkop) dhe ne monitorimin e frekuences ventrikulare te pacientet me fibrilacion atrial. Mund te zbulojte dhe te percaktoje natyren dhe kohezgjatjen e aritmive atriale dhe ventrikulare dhe episode te heshtura te ishemise te cilat mund te shkaktojne ose te perkeqesojne simptomat e IK. Episode te takikardise ventrikulare te paqendrueshme simptomatike jane te te shpeshta ne IK dhe shoqerohen me nje prognoze te keqe.

Kateterizimi i zemres

Kateterizimi i zmeres nuk eshte i nevojshem per diagnozen rutine dhe menazhimin e pacienteve me IK. Ekzaminimi invasiz eshte me teper i indikuar per te sqaruar etiologjinë, per te perfshuar informacione prognostike te sigurta dhe nese mund te shihet mundesia e revakularizimit.

Angiografia koronare

Angiografia e eneve koronare duhet te merret ne konsiderate te te semuret me IK me histori angine eforti ose me disfunksion te VM te dyshuar per ishemi, qe shoqerohet me arrest kardiak dhe tek ata me risk te larte per semundje koronare te zemres, dhe mund te kerkohet urgjentisht ne paciente te zgjedhur me IK severe (shok kardiogjen ose edeme pulmonare akute) dhe ne paciente qe nuk i per gjigjen mjaftueshem mjekimit. Angiografia e eneve koronare dhe ventrikulagrafia e VM jane gjithashtu te indikuara ne paciente me IK refraktare me etiologji te panjohur dhe ne paciente me te dhena te regurgitimit mitral severe ose semundje te valvules se aortes mundesisht te korrigueshme me kirurgji.

Kateterizimi i anes se djathte te zemres

Kateterizimi i djathte i zemres na jep te dhena hemodinamike te vlefshme ne lidhje me presionet mbushese, rezistencat vaskulare dhe debitin kardiak. Roli i tij ne diagnozen e IK eshte i limituar ne praktiken klinike. Formon bazen e klasifikimit Forrester dhe eshte metoda me e sakte per te vleresuar hemodinamiken te paciente rezistente ndaj mjekimit, perpara transplantit kardiak ose ne hulumtimet klinike per te vleresuar nderhyrjet.

Monitorimi i variblave hemodinamike me ane te nje kateteri te arteries pulmonare (PAC) mund te kihet parasysh te pacientet e hopitalizuar me shok kardiogjen/jo-kardiogjen ose per te monitoruar trajimin te pacientet me IK severe qe nuk i per gjigjen mjekimit te duhur. Megjithate, perdonimi i nje PAC nuk ka teguar se i permison te dhenat.

Biopsia endomiokardiale

Crrgullim specifike te miokardit mund te diagnostikohen me ane te biopsise endomiokardiale (EMB). Vendimet klinike duhet te behen nga studime te disponueshme me raste te kontrolluara dhe nga formulime opinionesh eksperte. Nje formulim i fundit i publikuar nga AHA/ACC/ESC per indikacionet e EMB, sygjeroi qe procedura duhet te kihet ne konsiderate ne paciente me IK akute ose fulminate me etiologji te panjohur qe perkeqesohen shpejt me aritmi ventrikulare dhe/ose bllok atrioventrikular, ose ne paciente qe nuk per gjigjen ndaj terapise tradicionale te IK. EMB duhet te merret ne konsiderate edhe ne IK kronike qe dyshohet te jete nga procese infiltrative sic eshte amilidoza, sarkoidoza dhe hemokromatoza, si edhe ne miokarditin eozinofilik dhe ne kardiomiopatine restriktive me origjine te panjohur.

Prognoza

Percaktimi i prognozes se IK eshte komplekse. Etiologji te ndryshme, mosha, shpesh komorbiditete (bashke-semundshemria), variacionet ne te dhenat dhe progresioni individual (vdekja e papritur ose progresive nga IK), te gjitha keto duhet te kihen parasysh. Ndikimi ne progoze i trajtimeve te vecanta ne paciente me IK, shpesh eshte i veshtire te parashikohet. Variablat me shume te pajtueshme te cituara si prediktore te pavarur te te dhenave jane reportuar ne tabelen 17.

Tabela 17. Gjendje qe lidhem me nje prognoze te keqe te IK

Demografik	Klinik	Elektrofiziologjik	Funksional/sforcim	Laborator	Imazheri
Mosha e madhe	Hipotensioni Valet Q	Takikardia pakesuar, pik i ulet i VO ₂	Puna e pakesuar, pik i ulet i VO ₂	Ngritje e theksuar e BNP/NT pro BNP	EF i VM i ulur
Etiologi ishemike	Klasa NYHA	QRS e gjere		Hiponatremia	
Ringjallje nga vdekja e papritur	Hospitalizi-me te meparshme	Hipertrofi e VM Aritmi ventrikulare komplekse		Tropoinina te rritura Biomarkues te rritur, aktivizimi neurohumoral	
Kompliance e varfer	Takikardi	Frekuencia te uleta kardiake Fibrilacion atrial	Distance e vogel e 6 minuta ecje	Kreatinine dhe BUN e rritur	Volume te rritura te VM
Disfunkcion renal	Rale pulmonare	Vale T te ndryshueshme	Renie e rritur e VE/VCO ₂	Anemi, bilirubin e larte	Indeks i ulet kardiak
Diabet	Stenoze aorte		Frymemarrje me nderprerje	Acid urik i rritur	Presione mbushese te VM te rritura
Anemi	Indeksi i mases trupore (BMI) i ulet				Patern restriktiv i mbushjes, Hipertension pulmonar
CODP	Crregullime te frymemarrjes te lidhura me gjumin				Funksion i demtuar i VD
Depresioni					

Menaxhimi jo – farmakologjik

Vete – kujdesja

- Vete-kujdesja eshte nje pjese e trajtimit te sukseshem te IK dhe mund te ndikoje ne menyre domethenese ne simptomat, kapacitetin funksional, mbarevajtjen, gjendjen e semure dhe ne prognoze. Vetepkujdesja mund te perkufizohet si veprime me qellim per te mbajtur qendrueshmerine fizike, shmangien e sjelljeve qe mund te perkeqesojne gjendjen dhe konstatimi i simptomave te hershme te keqesimit.⁶⁸
- Sjellje te rendesishme te vete-kujdesjes ne IK jane paraqitur ne tabelen 18.

- Eshte e rendesishme qe profesionalistet e kujdesit shendetesor te kujdesen per edukim dhe keshillim te hollesishem te IK.

Tabela 18 Tema te rendesishme ne edukimin e pacienteve me aftesi dhe sjellje te duhura per vete-kujdesje

Tema edukuese	Aftesi (cilesi) dhe sjellje te vete-kujdesjes
Perkuizimi dhe etiologja e IK Simptomat dhe shenjat e IK	Te kuptohet shkaku i IK dhe pse ndodhin simptomat Monitorimi dhe njoftimi e shenjave e simptomave Matja ditore e peshes dhe konstatimi i shtimit te shpejte te peshes Te dihet kur dhe si te njoftohen punonjes e kujdesit shendetesor Te perdoret terapi fleksible e diuretikeve, nese eshte e duhura dhe e rekomandueshme
Trajtimi farmakologjik	Te kuptohen indikacionet, dozat dhe efektet e medikamenteve Te njihen efektet anesore me te zakonshme te cdo medikamenti
Modifikimi i faktoreve te riskut	Te kuptohet rendesia e nderprerjes se duhanit Te monitorohet presioni i gjakut nese subjekti eshte hipertonik Te mbahet kontroll i mire i glikozes nese subjekti eshte diabetik Te shmanget obesiteti
Rekomandimi i dietes	Kufizim i kripes nese pershkruhet Te evitohet marrja e tepert e lengjeve Marrje te vogla te alkoolit Te monitorohet dhe te parandolohet kequshqyerja
Rekomandime per ushtrime fizike	Te jene te sigurt e te qete per aktivitetin fizik Te kuptohen benefitet e ushtrimeve fizike Te kryhen ushtrime fizike rregullisht
Aktiviteti seksual	Te sigurohen per angazhimin gjate aktit dhe te diskutohen problemet me profesioniste te kujdesit shendetesor Te kuptohen probleme seksuale specifike dhe strategji te ndryshme te cifteve
Imunizimi	Te merret imunizimit kunder infeksioneve sic jane gripi dhe semundjet pneumokoksike
Crrregullimet e fryshtemarrjes dhe te gjumit	Te njihen sjellje parandaluese sic jane pakesimi i peshes te obeset, nderprerja e duhanit dhe abstinencia ndaj alkoolit
Aderencat (ndjekjet e zbatimet)	Te mesohet per mundesite e trajtimit nese duhet Te kuptohet rendesia e rekomandimeve te meposhtme te trajtimit dhe te mbahet motivimi per te

Aspekte psikosociale	ndjekur planin e trajtimit Te kuptohen qe simptomat depresive dhe disfunksioni konjigativ jane te zakonshme te pacientet me IK dhe te kuptohet rendesia e mbeshtetjes sociale
Prognoza	Te mesohet per mundesite e trajtimit nese duhet Te kuptohen faktoret prognostik te rendesishem dhe te behen vendime realiste <u>Kerkoni mbeshtetje psikosociale nese duhet</u>

Faqja e intenetit *heartfailurematters.org* perfaqeson nje mjet nepermjet internetit te siguruar nga Shoqata e IK e SHEK (ESC) qe i lejon pacientet, te afermit e tyre dhe perfaqesues te kujdesit shendetesor qe te marrin informacion praktik e te dobishem ne nje fromat perdonimi miqesor.

Opsionet e meposhtme te menaxhimit jane konsideruar te pershatshme te pacientet me IK simptomatike. Rekomandimet paraqesin kryesisht opinionin e ekseprteve pa te dhena te mjaftueshme te dokumentueshme.

Aderanca (ndjekje) te trajtimit

Te dhenat kyce

Aderanca te mira kane treguar te ulin mortalitetin dhe morbiditetin dhe te permisojne mireqenien.⁶⁹ Literatura sugjeron qe vetem 20-60% e pacienteve me IK aderohen ndaj trajtimit farmokologjik dhe jo-farmakologjik te pershkruar.^{70,71} Te dhena nga Survejanca Evropiane e IK tregojne qe nje propocin i madh i pacienteve ose e kane keqkuptuar, ose kane pasur probleme per te kujtuar qe ata kane marre rekomandime ne lidhje me vete-kujdesjen sic jane instruksione per mjekimet ose dieten.⁷²

- Nje marredhenie e forte midis profesionisteve te kujdesit shendetesor dhe pacienteve, si dhe mbeshtetje sociale e mjaftueshme nga nje rrjet social aktiv ka treguar qe ka permisuar ndjekjen (zbatimin) e trajtimit. Eshte e rekomandueshme qe pjesetaret e famijes te ftohen per te marre pjese ne programet edukuese dhe vendime qe lidhen me trajtimin dhe kujdesin.
- Pacientet duhet te kene njohuri te mjaftueshme per trajtimin e tyre mjekesor, vecanerisht ne lidhje me efektet anesore dhe se si mjekime duhet te merret dhe te titrohet. Kjo mund te jete ne kundershtim me pacientet me disfunksion konjigativ.⁷⁴
- Pacientet duhet te jete te informuar se efektet benefite te terapise mund te vijne me vonese dhe te mos kene te papritura jo-reale ne lidhje me per gjigjen fillestare te trajtimit. Duhet te shpjegojesh qe efektet anesore shpesha jane tranzitore dhe mund te nevojiten muaj per te mbittituar dhe vleresuar efektin e plote te preparatit.
- Rekomandohen nderhyrje per te permisuar zbatimin e mjekimit dhe duhen te drejtohen nga punojesit e kujdesit shendetesor.

Evidencia

Klasa e I rekomandimit, niveli C i evidences

Njohja e symptomave

Simptomat e perkeqesimit ne IK mund te variojne ne menyre te konsiderueshme.^{75,76}

Pacientet dhe/ose punonjesit e shendetit duhet te njohin simptomat e perkeqesimit dhe te marrin masat e duhura sic eshte rritja e dozes se dhene te diuretikeve dhe/ose te kontaktojne me grupin e kujdesit shendetesor.

- Duhet te rekomandohen doza fleksible te diuretikeve te bazuara ne simptoma dhe balancen e likideve, brenda kufijve te para-aktuar, pas edukimit dhe intruksioneve te detajuara.

Klasa e I rekomandimit, niveli C i evidences

Monitorimi i peshes

Shtimi i peshes trupore shpesh eshte i shoqeruar me perkeqesimin e IK dhe mbajtjen e likideve ne organizem.⁷⁶ Pacientet duhet te informohen qe mund te ndodhe perkeqesim i gjendjes edhe pa shtim te peshes.

- Pacientet duhet ta peshojne veten ne menyre te rregullt per te monitoruar ndryshimin e peshes, si pjese e rutines ditore. Ne rast te nje shtim peshe te papritur rreth 2 kg ne 3 dite, pacientet mund te rrisin dozen e diuretikeve dhe duhet lajmerojne grupin e kujdesit shendetesor. Duhen te shpjegohen risqet e zbrazjes volumore si pasoje e dozave te tepruara te diuretike.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

Dieta dhe ushqyerja

Marrja e kriperave

Kufizimi u kriperave eshte i rekomandueshem ne IK simptomatike per te parandaluar mbajtjen e likideve. Ndonese nuk ekzistojne udherrefyes te vecante, marrja e tepert e kripes duhet te evitohet. Paciente duhet te edukohen per permbajten e kripes ne ushqime.

Klasa e IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Marrja e lengjeve

Kufizimi i lengjeve ne rreth 1.5-2 l/dite mund te merret ne konsiderate te pacientet me simptoma severe te IK vecanerisht me hiponatremi. Kufizimi rutin i lengjeve ne te gjithe pacientet me simptoma te lehta ne te moderuara nuk duket te jape benefite klinike.⁷⁸

Klasa e IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

Alkooli

Alkoolo mund te kete nje efekt inotrop negativ dhe mund te shoqerohet me nje rritje te presionit te gjakut (TA) dhe te riskut te aritmive. Perdorimi i tepert mund te jetë i demshem.

- Marrja e alkoolit duhet te kufizohet ne 10-20 g/dite (1-2 gota vere/dite)

Klasa e IIa e rekmandimit, niveli C i evidences

- Pacientet qe dyshohen te kete kardiomiopati si pasoje e alkoolit duhet te shkeputen plotesisht nga alkooli.⁷⁹

Klasa e I e rekmandimit, niveli C i evidences

Pakesimi i peshes

Pakesimi i peshes te personat obese [indeksi i mases trupore (BMI) $> 30 \text{ kg/m}^2$] me IK duhet te merret ne konsiderate ne menyre qe te parandalohet avancimi i IK, te pakesohen simptomat dhe te permisohet mireqenia.

Klasa e IIa e rekmandimit, niveli C i evidences

Ne IK te moderuar ne severe, pakesimi i peshes trupore nuk duhet te rekmandoheret ne menyre rutine qe kur anoreksia dhe humbja e paqellimshme e peshes jane probleme te zakonshme.

Humbja e paqellimshme e peshes trupore

Kequshqyerja klinike dhe subklinike eshte e zakonshme te pacientet me IK severe. Fispatologja e kaheksise kardiake ne IK eshte komplekse dhe nuk eshte kuptuar plotesisht, por metabolizmi i alteruar, marrja e pamjaftueshem e ushqimit, marrje e ulet ushqimore, kongjestiuni intestinal (**gut**) dhe mekanizmat inflamatore mund te jene faktore te rendesishem. Kaheksia kardiake eshte nje prediktor i rendesishem i mbijeteses se ulur.⁸⁰

- Nese humbja e peshes gjate 6 muajve te fundit eshte $> 6\%$ se sa pesha e meparshme e qendrueshme pa te dhena per mbajtje likidesh, pacienti konsiderohet si kahektik.⁸¹ Gjendja ushqyese e pacientit duhet te vleresoheret me kujdes.

Klasa e I e rekmandimit, niveli C i evidences

Duhani

Duhani eshte nje faktor rishku i njohur per semundje kardiovaskulare. Asnje studim prospektiv (i mundshem) nuk ka vleresar efektet e nderprerjes se duhanit te pacientet me IK. Studime observuese mbeshtesin lidhjen midis nderprerjes se duhanit dhe morbiditetit dhe mortalitetit te ulur.^{82,83}

- Eshte e rekmandueshme qe pacientet te marrin keshilla dhe te perkrahen si dhe te motivohen per te nderprere duhanin.

Klasa e I e rekmandimit, niveli C i evidences

Imunizimi

- Vaksinimi pneumokoksik dhe vaksinimi i pervitshem i gripit duhet te kihet parasysh te pacientet me IK simptomatike pa kunderindikime te njohura.

Klasa e IIa e rekomandimve, niveli C i evidences

Aktiviteti dhe trajnimet e ushtrimeve fizike

Pasiviteti fizik eshte i zakonshem te pacientet me IK simptomatike dhe kontribon ne avancimin e tij.⁸⁵ Trajnimi fizik i rregullt, fillimisht i supervizuar ose rezistent permison kontrollon autonomik duke shtuar tonusin vagal dhe duke pakesuar aktivitetin simpatik, permison forcen muskulore, kapacitetin vazodilatator dhe disfunkcionin endotelial, dhe ul stresin oksidues. Disa permbledhje dhe meta-analiza sistematike te studimeve te vogla kane treguar qe gjendja fizike nga trajnimet ushtrimore ul mortalitetin dhe hospitalizimet kur krahasohen vetem me kujdesin e zakonshem, dhe permisojne tolerances ushtrimore dhe cilesine e jetes lidhur me shendetin.⁸⁶⁻⁹⁰ Programet e rehabilititetit kardiak qe pasohen me nje ngjarje kardiovaskulare ose episode te dekompesimit perfaqesojne nje mundesi trajtimi efikas per pacientet me IK.

- Aktivitet ditor i rregullt e i moderuar eshte i rekomanduar per te gjithe pacientet me IK.

Klasa e I rekomandimit, niveli B i evidences

- Trajnimi ushtrimeve fizike eshte i rekomandueshem, eshte mundet, ne te gjithe pacientet me IK kronike te qendrueshme. Nuk ka te dhena qe trajnimi fizik duhet te kufizohet ne ndonje nengrup te vecante pacientesh me IK (etiologji, klasa NYHA, EF i VM ose mjekim). Programet e trajnimeve ushtrimore duken te kene efekte te ngjashme si kur kryehen ne spital apo ne shtepi.

Klasa e I e rekomandimit, niveli A i evidences

Aktiviteti seksual

Problemet seksuale qe lidhen me semundjet kardiovaskulare, trajtimet mjekesore (β -blokuesit), ose faktore psikologji sic jane lodhja dhe depresioni jane te zakonshme te pacientet me IK. Ka te dhena te kufizuara lidhur me influencen e aktivitetit seksual ne gjendjen klinike te pacienteve me simptoma te lehta ose te moderuara. Eshte reportuar nje rritje e lehte e riskut te dekompesimit te sjelle nga aktiviteti seksual te pacientet me klasen NYHA III-IV. Simptomat kardiovaskulare sic jane dispneja, palpitacionet ose angina gjate aktit seksual rralle ndodhin te pacientet qe nuk perjetojne simptoma te ngjashme gjate niveleve te eforave qe perfaqesojne efort te moderuar.⁹¹

Pacientet mund te keshillohen te perdonin nitroglycerine sublinguale so prolilaksi kunder dispnese dhe dhimbjes se gjoksit gjate aktivitetit seksual.

- Inhibitoret e fosfodiesterazes 5 (PDES) (p.sh. sildenafil) ulin presionet pulmonare por aktualisht nuk rekomandohen per pacientet me IK te avancuar. Ato nuk duhen te perdoren asnjehere te kombinuar me preparate nitratesh.

Klasa e III e rekomandimit, niveli B i evidences

- Jane te rekomandueshme konsultime sensitive individuale per meshkujt dhe per femrat, si dhe per partneret e tyre.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

Shtazania dhe kontracepsioni

- Shtatzania mund te coje ne perkeqesim te IK per shkak te shtimit te volumit te gjakut dhe rritjes se debitit kardiak, si edhe ne rritjen e konsiderueshme te likid ekstraçelizor. Eshte e rendesishme te dihet, shume medikamente qe perdoren ne mjekimin e IK jane te kunderindikuar gjate shtatzanise.
- Risku i shtatzanise eshte konsideruar me i madh se sa risqet qe lidhen nga perdonimi i kontraceptiveve. Rekomandohet qe grate me IK te diskutojne kontraceptivet dhe shtatzanine e planifikuar me nje mjek ne vend qe te marrin nje vendim te bazuar ne vleresimin e risqeve potenciale.

Udhetimet

Lartesi te medha (> 1500 m) dhe udhetimet ne destinacione te lageshta dhe shume te nxehta nuk duhen inkurajuar per paciente simptomatike. Udhetime te planikuara duhen te diskutohen me grupin e IK. Si rregull, per udhetime te gjata perferohet udhetimi ajror ne krahasim me mjete te transportit.

Crregullimet e gjumit

Pacientet me IK simptomatike zakonisht kane crregullime te frysmares te lidhura me gjumin (apne gjumi centrale ose obstruktive). Keto gjendje mund te shoqerohen me rritje te morbiditetit dhe mortalitetit.⁹²

- Humbja e peshes ne individe me mbipeshe severe, nderprerja e duhanit dhe abstinencia ndaj alkoolit mund te ulin riskun dhe eshte e rekomandueshme.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Trajtimi me nje presion ajri pozitiv te vazhdueshem duhet te merret ne konsiderate ne apnene obstruktive te gjumit te dokumentuar nga polisomografi.⁹³

Klasa e IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Depresioni dhe crregullimet e humorit

Prevalanca e depresionit klinikisht sinjifikativ eshte gjetur te jete 20% ne paciente me IK dhe mund te jete me e larte ne paciente te monitoruar me instrumenta me sensitive ose ne pacientet me IK me te avancuar. Depresioni shoqerohet me morbiditet dhe mortalitet te rritur.⁹⁴

- Ka prova te kufizuara ne lidhje me mjetet monitoruese dhe vleresuese si edhe per efikasitetin e nderhyrjeve farmakologjike dhe psikologjike te pacientet me IK. Megjithate, monitorimi per depresionin dhe trajtimi fillestar i duhur duhet te kihen ne konsiderate te pacientet me simptoma sugjpressive.

Klasa e IIa e rekomandimit, niveli i evidences C

Prognoza

Ndonese kishte kundershime ne diskutime, eshte e rendesishme qe pacientet te kuptojne faktoret e rendesishem prognostik. Njohja e ndikimit te trajtimit ne progoze mund t'i motivoje pacientet te aderohen ne rekomandimet e trajtimit. Nje diskutim i hapur me familjen mund te ndihmoje ne marrjen e vendimeve informuese e realiste qe kane te te bejne me trajtimin dhe planet ne te ardhmen.

Terapia farmakologjike

Objektivat ne menazhimin e insuficiences kardiake

Qellimi per diagnostikimin dhe mjekimin e IK nuk eshte i ndryshem nga gjendje te tjera mjekesore, domethene qe te sjell nje ulje te mortalitetit dhe morbiditetit (tabela 19). Meqenese vdekshmeria vjetore e IK eshte kaq e larte, atehere ne studimet klinike i eshte theksim i vecante vene kesaj pike. Megjithate, per shume paciente, dhe vecanerisht per te moshuarit, aftesia per te pasur nje jete te pavarur, te lira nga simptoma teper ta pakendshme, dhe evitimet per t'u shtruar ne spital jane qellime te cilat me raste mund te jene ekuivalente me deshiren per te zgjatur ne maksimum jeten. Parandalimi i semundjeve te zemres ose avancimi i tyre mbeten nje pjese e rendesishme e menaxhimit. Shume nga studimet klinike te randomizuara te IK kane vleresuar paciente me disfunkcion sistolik te bazuar ne EF < 35-40%. Ky eshte nje nivel kufi relativisht arbitrar dhe ka te dhena te kufizuara ne popullata te medha me IK simptomatike dhe me EF midis 40 dhe 50%. Figura 2 na jep nje strategji mjekimi per perdonimin e medikamenteve dhe pajisjeve (aparateve) te pacientet me IK simptomatike dhe disfunkcion sistolik. Eshte e rendesishme te konstatohen dhe te gjykohet trajtimi i komorbiditetit cardiovaskulare dhe jo-kardiovaskulare me te zakonshme.

Tabela 19 Objektivat e mjekimit ne IK kronike

1. Prognoza	Te ulet mortaliteti
2. Morbiditeti	Te lethesohen simptomat dhe shenjat Te permisohet cilesia e jetes Te eleminohen edemat dhe mbajtja e likideve Te rititet kapaciteti sforcime fizike Te pakesohet dispneja dhe lodhja Te ulet nevoja per hospitalizim Te sigurohet per fund kujdesi i jetes
3. Parandalimi	Ngjarje e demtimit miokardial Avancim i demtimit te miokardit Remodelimi i demtimit te miokardit Rizhvillim i simptomave dhe akumulimi i likideve Hospitalizim




Figura 2. Nje algoritem per tratin e pacienteve me IK simptomatike dhe EF te ulur

Inhibitoret e enzimes se konvertimit te angiotenzines (ACEIs)

Ne rast te kunderindikimeve ose te mostolerimit, nje ACEI duhet te perdoret ne te gjithe te pacientet me IK simptomatike dhe me EF te VM \leq 40%. Mjekimi me nje ACEI permison funksionit e ventrikulit dhe mireqenien e pacientit, ul shtrimet ne spital per rendim te IK dhe rrit mbijetesen. Ne pacientet e hospitalizuar, mjekimi me nje ACEI duhet te fillohet perpara daljes nga spitali.

Klasa e I e rekomandimit, niveli A i evidences

Te dhena kyce

- Dy studime kyce te kontrolluara e te randomizuar (RCTS) (CONSENSUS dhe Trajtimi-SOLVD) regjistruan rreth 2800 paciente me IK simptomatike te lehte ne severe ndaj placebos ose enalaprilit.^{95,96} Shumica ishin trajtuar gjithashtu me diuretike dhe digoksine, por < 10% e pacienteve ne secilin studim ishin mjekuar me nje β -blokues. Ne CONSENSUS, ne te cilin u regjistruan paciente me IK severe, 53% e pacienteve ishin mjekuar me spironolakton.
- Secili prej ketyre du studimeve (RCT) tregoi se mjekimi me ACEI ul mortalitetin [ulja e riskut relativ (RRR) 27% ne CONSENSUS dhe 16% ne Trajtimin-SOLVD]. Ne Trajtimin-SOLVD ishte gjithashtu nje vlore RRR prej 26% ne shtrimet ne spital per rendim te IK. Keto benefite ishin shtesendaj atyre te perfutura me mjekimin konvensional.
- Ulja absolute e riskut (ARR) ne mortalitet ne pacientet me IK te lehte ne te moderuar (Trajtimi-SOLVD) ishte 4.5% e barabarte me nje numer te nevojshem per te trajtuar (NNT) 22 per te shtyre nje vdekje (mbi nje mesatare pre 41 muajsh). Shifrat ekuivalente per IK severe (CONSENSUS) ishin ARR = 14.6% dhe NNT = 7 respektivisht (mbi nje mesatare prej 6 muajsh)
- Keto konkluzione mbeshteten nga nje meta-analize e studimeve (RCT) me te vogla, per kohe te shkurter dhe me kontroll placebo, qe treguan nje ulje te qarte te vdekshmerise vetem brenda 3 muajve. Keto studime (RCT) treguan gjithashtu qe ACEI permisojne simptomat, tolerancen ushtrimore, cilesine e jetes dhe performancen fizike.⁹⁷
- Ne ATLAS, u randomizuan me doza te uleta ose te larta te lizinoprilit, 3164 paciente kryesisht me IK te moderuar ne severe. U vu re nje RRR rreth 15% ne riskun e vdekjes ose ne hospitalizimet e IK ne grupin me doza te larta te lizinoprilit krahasuar me grupin me doza te uleta te lizinoprilit.⁹⁸
- Mbështetje shtese per perdorimin e ACEI vjen nga nje RCT te pacienteve me EF te ulet te VM por pa simptoma te IK (disfunksion sistolik i VM asimptomatik) dhe nga tre (5966 paciente ne total) studime te medha te randomizuara me placebo-kontroll ne paciente me IK, me disfunksion sistolik te VM ose ne te dyja pas infarktit akut te miokardit.⁹⁹ Ne studimin Parandalimi-SOLVD (ku u randomizuan 4228 paciente me disfunksion sistolik te VM asimptomatik), kishte nje vlore RRR 20% ne vdekje ose ne hospitalizime nga IK. Ne studimet e infarktit te miokarditIM, qe perdoren captorpril (SAVE), ramipril (AIRE) dhe trandopril (TRACE), kishte nje vlore RRR 26% ne vdekje dhe RRR 27% ne vdekje ose hospitalizime

nga IK. ACEI kane treguar gjithashtu se ulin riskun per IM te pacientet me dhe pa IK pavaresisht EF te VM.

- ACEI here pas here shkaktojne demtim te funksionit renal, hiperkalemi, hipotension simptomatik, kolle dhe rralle angioedema. Nje ACEI duhet te perdoret vetem ne paciente me funksion renal te mire dhe me vlera normale te potassiumit ne serum.⁹⁹

Cilet paciente duhet te marrin nje ACEI?

Indikacionet, te bazuar mbi pacientet e regjistruar ne RCT:

EF i VM $\leq 40\%$, pavaresisht symptomave

Kunderindikacionet:

- Histori angioedeme
- Stenoze bilaterale te arterieve renale
- Perqendrimi ne serum i potassiumit $> 5.0 \text{ mmol/L}$
- Kreatinina ne serum $> 220 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 2.5 \text{ mg/dL}$)
- Stenoze aorte severe

Si te perdomim nje ACEI ne insuficiencen kardiake (Tabela 20)

Fillimi i nje ACEI

- Te kontrollohen funksioni renal dhe elektrolitet e serum
- Te rikontollohet funksioni renal dhe elektrolitet brenda 1-2 javave nga fillimi i mjekimit.

Mbi-titrimi i dozave

- Te kihet parasysh mbi-titrimi i dozave pas 2-4 javë. Te mos rritet doza nese verehet perkeqesim sinjifikativ i funksionit renal ose hiperkalemia. Te rikontollohet funksioni renal dhe elektrolitet ne serum 1 dhe 4 javë pas rritjes se dozes. Mbi-titrim me i shpejte i dozes mund te kryhet te pacientet ne spital ose nen nje mbikeqyerje shume te afert, me tolerabilitet te lejueshem.
- Ne mungese te problemeve te mesiperme, synohet per evidencen baze te dozes target ose per dozes maksimale te toleruar (Tabela 20)
- Te rikontollohet funksioni renal dhe elektrolitet ne serum 1, 3 dhe 6 muaj pas arritjes se dozes mbajtese dhe cdo 6 muaj ne vazhdim.

Tabela 20 Dozimi i preparateve qe perdoren zakonisht ne IK

	Doza e fillimit (mg)		Doza target (mg)	
ACEI				
Captopril	6.25	t.i.d.	50-100	t.i.d.
Enalapril	2.5	b.i.d.	10-20	b.i.d.
Lisinopril	2.5-5.0	o.d.	20-35	o.d.
Ramipril	2.5	o.d.	5	b.i.d.
Trandopril	0.5	o.d.	4	o.d.
ARB				
Candesartan	4 ose 8	o.d.	32	o.d.
Valsartan	40	b.i.d.	160	b.i.d.
Antagonistet e Aldosteronit				
Eplerenone	25	o.d.	50	o.d.
Spironolactone	25	o.d.	25-50	o.d.
β-Bllokuesit				
Bisoprolol	1.25	o.d.	10	o.d.
Carvedilol	3.125	b.i.d.	25-50	b.i.d.
Metoprolol succinate	12.5/25	o.d.	200	o.d.
Nebivolol	1.25	o.d.	10	o.d.

Efekte anesore potenciale

- **Demtim i funksionit renal** – rritje te urese (nitrogjeni i urese ne gjak) dhe kreatinemise pritet pas fillimit te nje ACEI dhe nuk konsiderohet klinikisht i rendesishem vetem nese eshte e shpejtë dhe e konsiderueshme. Duket te kontrollohet per medikamente nefrotoksiqe sic ajne antiinflamatoret jo steroide (NSAIDs). Nese eshte e nevosjme te pakesohet dosa e ACEI ose te nderpritet. Eshte e pranueshme nje rritje e kreatines mbi 50% nga vlera baze ose ne nje koncentrim absolut rrith 265 µmol/L (~ 3 mg/dL). Nese kreatinina rritet mbi 265 µmol/L (~ 3.0 mg/dL), por nen 310 µmol/L (~ 3.5 mg/dL), per gjysmoni dozen e ACEI dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut. Nese kreatinina rritet deri ne 310 µmol/L (~ 3.5 mg/dL) ose me lart, nderprisni ACEi menjehere dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut.
- **Hiperkalemia** – kontrolloni per perdorimin e agjenteve te tjere qe shkaktojne hiperkalemi p.sh. suplemente te kaliumit dhe diuretike qe mbajne kalumin p.sh. amiloride dhe nderpritini ato. Nese kalumi rritet mbi 5.5 mmol/L, per gjysmoni dozen e ACEI dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut. Nese kalumi rritet mbi 6.0 mmol/L, nderprisni ACEI menjehere dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut.
- **Hipotensioni simptomatik** (p.sh. marrje mendsh) eshte i shpeshte – zakonisht permisohet me kohe, dhe pacientet duhet te qetesohen. Te kihet parasysh qe te ulet doza e diuretikeve ose e agjenteve te tjere hipotensive (per vec ARB/β-bllokuesve/antagonisteve te aldosteronit). Hipotensioni asimptomatik nuk kerkon ndonje nderhyrje.

- **Kolla** – nese nje ACEI shkakton kolle te mundimshme, nderrojeni me nje ARB.

β-bllokuesit

Ne rast se jane te kunderindikuar ose nuk tolerohen, nje β-bllokues duhet te persoret te te gjithe te semuret me IK simptomatike dhe EF te VM $\leq 40\%$. β-bllokada permison funksionit ventrikular dhe mireqenien e pacienteve, ul shtrimet ne spital si pasoje e perkeqesimit te IK dhe rrit mbijetesen. Nese eshte e mundur te pacientet e shtruar, mjekimi me β-bllokues duhet te fillohet me kujdes perpara nxjerrjes nga spitali.

Klasa e I e rekomandimit, niveli A i evidences

Te dhena kyce

- Me shume RCT jane kryer me β-bllokues se sa me ACEI te pacientet me IK.¹⁰⁰⁻¹⁰⁴
- Tre studime kyce (CIBIS II, COPERNICUS dhe MERIT-IK) ranomizuan afersisht 900 paciente me IK simptomatike te lehte ne severe, me placebo ose me nje β-bllokues (bisoprolol, carvedilol pse metoprolol succinate CR). Me shume se 90% e pacienteve ishin me mjekim me ACEI ose ARB. Shumica ishin trajtuar me nje diuretik dhe me shume se gjysma me digoksine.
- Secili nga te tre keto studime tregoi qe mjekimi me β-bllokues ul mortalitetin (RRR ~ 34% ne secilin studim) dhe hospitalizimet nga perkeqesimi i IK (RRR 28-36%) afersisht brenda nje viti nga fillimi i mjekimit. Gjithashtu pati nje permisim ne veteraportimin e mireqenies se pacientit ne COPERNICUS dhe MERIT-IK. Keto benefite ishin shtese e atyre te perftuara nga trajtimi konvencional, ku perfshihej nje ACEI.
- ARR ne mortalitetin (pas nje viti nga trajtimi) e pacienteve me IK te lehte ne te moderuar (te kombinuar CIBIS 2 dhe MERIT-IK) ishte 4.3% e barazvlefshme me nje NNT rreth 23 (per 1 vit te shtyhet 1 vdekje). Shifrat ekuivalente per IK severe (COPERNICUS) ishin respektivisht ARR = 7.1% dhe NNT = 14.
- Keto perfundime mbeshteten nga nje RCT tjeter placebo-kontroll (SENIORS) ne 2128 paciente te moshuar (≥ 70 vjec), 36% e te cileve kane EF te VM $> 35\%$. Trajtimi me nebivolol rezultoi ne nje RRR rreth 14% ne pike mberritjen primare te perbere te vdekjes ose ne hospitalizime per nje arsy kardiovaskulare.¹⁰⁵
- Perfundimet e ketyre studimeve u mbeshteten nga nje program studimesh i meparshem me carvedilol (studimet amerikane te carvedilolit), meta-analize e studimeve te tjera te vogla per β-bllokuesit dhe nje RCT placebo-kontroll ne 1959 paciente me EF te VM ≤ 0.40 pas infarktit akut te miokardit, ne te cilin RRR ne vdekshmerine me carvedilolin ishte 23% gjate nje periudhe ndjekjeje prej 1.3 vitesh.¹⁰³
- Nje RCT i madh me bucindolol, nje β-bllokues me veti agoniste te pjesshme, nuk tregoi nje ulje sinjifikative ne mortalitet, ndonose konkluzionet e tij ishin ne per gjithesi konsistente me studimet e mesiperme.¹⁰⁶
- Nje RCT tjeter, COMET, tregoi qe carvediloli rrit mbijetesen krahasuar me metoprolol tartrat me veprim te shkurter (i ndryshem nga perberja me succinat me veprim te gjate i perdonur ne MERIT-IK)¹⁰⁷

- β -bllokuesit zakonisht duhet te fillohen ne paciente te qendrueshem dhe ne pacientet te dekompesuar kohet e fundit duhet te fillohet me kujdes (dhe ne keta paciente te fillohet ne spital). Pacientet e dekompesuar kohet e fundit, megjithate, ishin me te sigurt ne fillimin e mjekimit me β -bllokues ne COPERNICUS.
- Ne pacientet e shtruar ne spital per shkak te perkeqesimit te IK, mund te jete e nevojshme nje ulje e dozes se β -bllokuesve. Ne situata te renda, mund te merret ne konsiderate nje nderprerje e perkohshme e tyre. Terapia me doza te ulta duhet rifillohet dhe te mbititrohet pasa te na e lejoje gjendja klinike e te semurit, kryesisht perpara nxjerrjes nga spitali.

Cilet paciente duhet te marrin nje β -bllokues?

Indikacionet, te bazuara mbi pacientet te regjistruar ne RCTs:

- EF i VM $\leq 40\%$
- Paciente me simptoma nga te lehte ne severe (klasa NYHA II-IV) me disfunkcion sistolik te VM asimptomatik pas IM kane gjithashtu indikacion per nje β -bllokues.
- Nivel optimal i dozave te nje ACEI ose/dhe ARB (ne te antagonistit te aldosteronit nese eshte e indikuar)
- Pacientet duhet te jene klinikisht te qendrueshem (p.sh. pa ndryshime te dozave te diuretikeve kohet e fundit). Kujdesi, nxjerra para kohe, fillimi jane te mundshme ne nje pacient te dekompeuar kohet e fundit, ku eshte arritur nje permisim i pacientit me mjekime te tjera, nuk eshte i varuar nga agjentet inotrop intravenoz dhe mund te observohet ne spital per te pakten 24 ore pas fillimi te mjekimit me β -bllokues.

Kunderindikacionet

- Astma [semundje pulmonare obstruktive kronike (SPOK) nuk eshte nje kunderindikim]
- Bllok i grades se dyte ose te trete, sindromi i sinusit te semure) ne mungese te nje pacemaker permanent), bradikardi sinusale (< 50 r/min).

Si te perdorim nje β -bllokues ne insuficience kardiake (Tabela 20)

Fillimi i nje β -bllokuesi

- Doza e fillimit: bisoprolol 1.25 mg o.d, carvedilol 3.125 -6.25 mg b.i.d, metoprolol CR/XL 12.5 – 25 mg o.d. ose nebivolol 1.25 mg o.d – nen supervizim te pacientet jo te shtruar.
- β -bllokuesit mund te fillohet me kujdes te pacient te dekompesuar se fundmi, perpara daljes nga spitali.

Titrimi i dozave

- Vizitonи cdo 2-4 javе per te titruar dozen e β -bllokuesit (ne disa paciente mund te nevojitet titrimi i ngadalte i dozes). Mos i rrisni dozat nese vereni ne cdo vizite shenjat e perkeqesimit te IK, hipotension simptomatik (psh marrje mendsh) ose bradikardi te theksuar (frekuencë e pulsit < 50 /min).
- Ne mungese te problemeve te mesiperme, dyfishoni dozen e β -bllokuesit ne cdo vizite derisa te arrihet doza target bazuar ne evidenc – bisoprolol 10 mg o.d., carvedilol 25 mg b.i.d., metoprolol CR/XL 200 mg o.d. ose nebivolol 10 mg o.d. – ose dozen maksimale te toleruar.

Efekte anesore potenciale

- **Hipotensioni simptomatik** – shpesh permisohet me kohe; te kihet parasysh te ulen agjente te tjere hipotensive) pervec ACEI/ARB) p.sh. diuretiket, nitritet. Hipotensioni asimptomatik nuk kerkon nderhyrje.
- **IK e renduar** – rrisni dozen e diuretikeve (vetem kur kerkeva eshte e perkoshme) dhe vazhdoni β -bllokuesin (shpesh ne doze me te ulet) ne eshte e mundur.
- Bradikardi e theksuar – regjistroni nje EKG (ose kryeni nje monitorim ambulator kur nevojitet) per te prejashtuar bllokun kardiak. Kini parasysh te nderprisni glukozidet digitalik ne rast te perdonimit te tyre. Doza e β -bllokuesit mund te nevojitet te ulet ose mjekimi te mos vazhdohet.

Antagonistet e aldosteronit

Ne rast se jane te kunderindikuar ose nuk tolerohen, shtimi i nje antagonistit te aldosteronit me doza te vogla duhet te kihet parasysh ne te gjithe pacientet me EF te VM $\leq 35\%$ dhe me IK simptomatike severe, p.sh. klasa NYHA III-IV, ne mungese te hiperkalemise dhe disfunkzionit renal te rendesishem. Antagonistet e aldosteronit ulin shtrimet ne spital ne rastet e perkeqesimit te IK dhe rrisin mbijetesen kur shtohen ne terapine ekzistuese, qe perfshin ACEI. Ne pacientet e hospitalizuara per te plotesuar keto kriteret, trajtimi me nje antagonist te aldosteronit duhet te fillohet para nxjerrjes nga spitalit.

Klasa e I e rekomandimit, niveli B i evidences

Te dhena kyce

- Nje RCT i vetem i madh (RALES) eshte ndermarre me antagonistin e aldosteronit, spironolaktonin te pacientet me IK severe.¹⁰⁸
- Ne RALES 1663 paciente me EF te VM $\leq 35\%$ dhe klasen NYHA III (qe kane qene ne klasen NYHA IV ne 6 muajt e fundit) u randomisuan ne placebo ose spironolakton 25-50 mg o.d. qe ju shtua terapise konvencionale, ku perfshin diuretike, ACEI (95%) dhe digoksin (74%). Ne kohen kur ky studim u krye, β -bllokuesit nuk perdoreshin gjeresisht per te mjekuar IK dhe vetem 11% u trajtuan me β -bllokues.
- Trajtimi me spironolakton coi ne nje RRR te vdekjes ne 30% dhe RRR te shtrimit ne spital nga perkeqesimi i IK ne 35% ne nje mesatare rreth 2 vjet nga fillimi i mjekimit. Spironolaktoni permisoi gjithashtu klasan NYHA. Keto benefite ishin shtese ndaj atyre te perftuara nga terapia konvencionale, qe perfshinte ACEI.
- ARR ne vdekshmerine (pas nje mesatare rreth 2 vjet mjekim) e pacienteve me IK severe ishte 11.4% e barazylefshme me nje NNT (2 vjet per te shtyre 1 vdekje) rreth 9.
- Keto rezultate mbeshteten nga nje tjeter RCT (EPHESUS) ku u regjistruan 6632 paciente 3-14 dite pas IAM me EF te VM $\leq 40\%$ dhe IK ose diabetike.¹⁰⁹ Pacientet u randomizuan me spironolakton ose eplerenone 25-50 g o.d. qe ju shtuan terapise konvencionale ku perfshihet ACEI/ARB (87%) dhe nje β -bllokues (75%). Mjekimi me eplerenone coi ne nje RRR te vdekjes ne 15%.
- Spironolaktoni dhe eplerenoni mund te shkaktojne hiperkalemi dhe te perkeqesojne funksionin renal, te cilat nuk ishin te zakonshme ne RCTs, por mund te ndodhin me shpesh ne

praktiken klinike, vecanerisht ne te moshuarit. Te dyja duhet te perdoren vetem ne paciente me funksion renal te kenaqshem dhe me perqendrime normale te potassium ne serum; nese perdoret, eshte e detyrueshme te monitorohen ne vazhdim funksioni renal dhe elektrolitet ne serum.¹¹⁰

- Spironolaktoni mund te shkaktoje gjithshtu diskomfort ne gji dhe zmadhim te tyre te meshkujt (10% krahasuar me placebo, ne RALES); ky efekt anesor eshte i rralle me eplerenoni. Jashte indikacionit post-infarkt, indikacioni kryesor per eplerenonin eshte te meshkujt me diskomfort ne gji dhe/ose zmadhim te tyre te shkaktuar nga spironolaktoni.

Pacientet te cilet duhet te marrin nje antagonist te aldosteronit

Indikacione te bazuara mbi RCT:

- EF i VM $\leq 35\%$
- Simptoma te moderuara ne severe (klasa NYHA III-IV)
- Dosa optimale te nje β -blokuesi dhe nje ACEI ose nje ARB (por jo dhe ACEI dhe ARB)

Kunderindikacionet

- Perqendrim i poatassiumit ne serum $> 5.0 \text{ mmol/L}$
- Kreatinina ne serum $> 220 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 2.5 \text{ mg/dL}$)
- Diuretike mbajtes te potassiumit ose suplemente te potassiumit, konkomitante.
- Kombinimi i nje ACEI dhe ARB

Si te perdom spironolaktonin (ose eplerenonin) ne IK (Tabela 20)

Fillimi i spironolaktonit (ose eplerenonit)

- Kontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum
- Doza e fillimit: spironolakton 25 mg o.d. (ose eplerenon 25 mg o.d.)
- Rikontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum 1 dhe 4 javë pas fillimit te mjekimit.

Titrimi i dozes

- Konsideroni titrim te dozes pas 4-8 javesh. Mos e rrisni dozen nese funksioni renal perkeqesohet ose konstatohet hiperkalemi. Rikontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum 1 dhe 4 javë pas fillimit te mjekimit.
- Ne mungese te problemeve te mesiperme, qellimi i dozes target sipas evidences base – spironolakton 25 mh o.d. ose eplerenon 50 mg o.d. – ose doza maksimale e toleruar.
- Rikontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum 1, 2, 3 dhe 6 muaj pas arritjes se dozes mbajtese dhe 6 muaj me pas.

Efekte anesore potenciale

- Hiperkalemia – nese potassiumi rritet ne $> 5.5 \text{ mmol/l}$, perqysoni dozen e spironolaktonit (ose eplerenoni), p.sh. ne 25 mg ne dite te alternuara dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut. Nese potassiumi rritet ne 6.0 mmol/L ndeprisni spironolaktonin (ose

eplerenonin) menjehere dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut; mund te nevojitet mjekim i vecante per hiperkalemie.

- Funksioni renal i perkeqesuar – nese kreatinina rritet deri $> 220 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 2.5 \text{ mg/dL}$), perqyshmoni dozen e spironolaktonit (ose e eplerenonit), p.sh. ne 25 mg ne dite te alternuara dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut. Nese kreatinina rritet deri $> 310 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 3.5 \text{ mg/dL}$) nderprisni spironolaktonin (ose eplerenonin) menjehere dhe monitoroni nga afer bilancin biokimik te gjakut; mund te nevojitet mjekim i vecante per disfunkzionin renal.
- Diskomfort dhe/ose zmadhim i gjirit – nderroni spironolaktonin me eplerenonin.

Blllokuesit i receptoreve te angiotenzines (ARBt)

Ne rast se nuk jane te kunderindikuar ose nuk tolerohen, një ARB eshte i rekomandueshem ne pacientet me IK dhe me EF te VM $\leq 40\%$, te cilet vazhdojne te jene simptomatike pavaresisht mjekimit optimal me një ACEI dhe β -blllokues, kur jane duke marre ne te njejtën kohe dhe një antagonist te aldosteronit. Mjekimi me një ARB permison funksionin ventrikular dhe mireqenien e pacienteve dhe ul shtrimin ne spital nga perkeqesimi i IK.

Klasa e I e rekondimt, niveli A i evidences

Mjekimi ul riskun per vdekje nga shkaqe kardiovaskulare.

Klasa e IIa e rekondimt, niveli B i evidences

- Nje ARB eshte i rekomadueshem si një altenative ne pacientet jotoleante ndaj një ACEI. Ne keta paciente, një ARB ul riskun per vdekje nga një shkak kardiovaskular ose ul shtrimin ne spital nga perkeqesimi i IK. Ne pacientet e hospitalizuar, mjekimi me një ARB duhet te fillohet para nxjerrjes nga spitali.

Klasa e I e rekondimt, niveli B i evidences

Te dhena kyce

- Dy RCT kyce placebo-kontroll (Val-HEFT dhe CHARM-Added) randomizuan ~7600 paciente me IK simptomatike te lehte ne severe ndaj placebos ose një ARB (valsartan dhe candesartan), te shtuar ndaj një ACEI (ne 93% te pacienteve ne Val-HEFT dhe ne te gjithe ne CHARM-Added).^{111,112} Vec kesaj, 35% e pacienteve ne Val-HEFT dhe 55% ne CHARM-Added ishin trajtuar me β -blllokues. 5% e pacienteve ne Val-HEFT dhe 17% ne CHARM-Added ishin trajtuar me spironolakton.
- Secili nga keto dy studime tragoi qe mjekimi me ARB uli riskun per shtrime ne spital nga perkeqesimi i IK (RRR 24% ne Val-HEFT dhe 17% ne CHARM-Added), por jo shtrimet ne spital nga shume shkaqe. Ishte nje RRR 16% ne riskun per vdekje nga një shkak kardiovaskular me candesartan ne CHARM-Added. Keto benefite ishte shtese nfa atyre te perftuara me terapine konvencionale, qe perfshin një diuretik, digoksin, një ACEI dhe një β -blllokues.
- ARR ne pikemberritjen (endpoint) primare mortaliteti- morbiditet te perbere te pacientet me IK te lehte ne te moderuar ishte 4.4%, e barazvlefshme me një vlere te NNT (per një mesatare

prej 41 muajsh perte shtyre nje ngjarje) ne 23 ne CHARM-Added. Shifrat ekuivalente per Val-HEFT ishin ARR = 3.3% dhe NNT =30 (per nje mesatare mbi 23 muaj), respektivisht.

- Studimet CHARM-Added dhe Val-HEFT treguan gjithashtu qe ARBt permisojne simptomat dhe cilesine e jetes. Studime te tjera treguan qe keta agjente permisojne kapacitetin ne eforje fizike.
- CHARM-Alternative ishte nje RCT placebo-kontroll me candesartan ne 2028 paciente me EF te VM \leq 40% intolerante ndaj nje ACEI.¹¹³ Mjekimi me candesartan rezoltoi ne nje RRR te vdekjes nga nje shkak kardiovaskular ose shtrime ne spital nga perkeqesimi i IK ne 23% (ARR = 7%, NNT – 14, mbi 34 muaj ndjekje).
- Mbeshetje shtese per perdorimin e ARB-ve, vjen nga VALIANT,¹¹⁴ nje RCT ne te cilin u regjistruan nen mjekim me kaptopril, valsartan ose te kombinuara, 14703 pacientet me IK, disfunkcion i VM ose te dyja pas IAM. U gjet qe valsartani ishte jo-inferior nga captoril. Nje studim i ngjashem, me losartan (OPTIMAAL), nuk tregoi mos-inferioritet i krahasuar me kaptoprilin.

Pacientet qe duhet te marrin mjekim me ARB

Indikacione, te bazuara ne paciente te regjistruar ne RCT:

- EF i VM \leq 40% dhe me shume
- si nje alternative te pacientet me simptoma te lehte ne severe (klasa NYHA II-IV), te cilet jane intolerante ndaj nje ACEI
- ose te paciente me simptoma persistente (klasa NYHA II-IV) pavaresisht mjekimit me nje ACEI dhe β -bllokues
- ARB mund te shkaktojne perkeqesim te funksionit renal, hiperkalemi dhe hipotension simptomatik me nje incidence te ngjashme me nje ACEI. Ata nuk jepin kolle.

Kunderindikacionet

- Si ACEI, me perjashtimin e angioedemes
- Paciente te mjekuar me nje ACEI dhe nje antagonist te aldosteronit
- Nje ARB duhet te perdoret vetem te pacientet me funksion renal te kenaqshem dhe nje perqendrim normal te potassiumit ne serum; jane te detyrueshme monitorime ne seri te elektroliteve ne serum dhe te funksionit renal, vecanerisht nese nje ARB eshte perdorur i nderthurur me nje ACEI.

Si te perdorim nje ARB ne IK (Tabela 20)

Fillimi i nje ARB

- Kontrolloni funksionit renal dhe elektrolitet ne serum
- Doza e fillimi: ose candesartan 4-8 mg o.d. ose valsartan 40 mg b.i.d.
- Rikontrolloni funksionit renal dhe elektrolitet ne serum brenda 1 javë nga fillimi i mjekimit.

Titrimi i dozes

- Te merret ne konsiderate titrimi i dozes pas 2-4 javesh. Mos rrisni dozen nese ndodh perkeqesim i funksionit renal ose hiperkalemia. Rikontrolloni funksionin renal ose elektrolitet ne serum 1 dhe 4 javë pas arritjes se dozes.
- Ne mungese te problemeve te mesiperme, qellimi per dozes targe sipas evidences baze – candesartan 32 mg o.d. ose valsartan 160 mg b.i.d. – ose doza maksimale e toleruar.
- Rikontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum 1, 3, dhe 6 muaj pas arritjes se dozes mbajtese dhe 6 muaj me pas.

Efekte anesore potenciale

- Si ACEI me perjashtim te kolles.

Hidralazina dhe isosorbid dinitrat (H-ISDN)

Ne paciente simptomatike me nje EF te VM kombinimi i H-ISDN mund te perdoret si alternative nese ka intolerance ndaj te dyjave, nje ACEI dhe nje ARB. Shtimi i kombinimit te H-ISDN duhet te merret ne konsiderate te pacientet me simptoma persistente, pavaresisht mjekimit me nje ACEI, β -bllokues dhe nje ARB ose antagonist te aldosteronit. Trajtimi me H-ISDN te keta paciente mund te ule riskun te vdekjes.

Klasa e IIa e rekondimit, niveli B i evidences

Ul shtrimet ne spital nga perkeqesimi i IK.

Klasa e IIa e rekondimit, niveli B i evidences

Permison funksionin ventrikular dhe kapacitetin ne eforte fizike.

Klasa e IIa e rekondimit, niveli A i evidences

Te dhena kyce

- Jane dy RCT placebo-kontroll (V-HeFT-I dhe A-HeFT) dhe nje RCT avtive-kontroll (V-HeFT-I) me H-ISDN.¹¹⁷⁻¹¹⁹
- Ne V-HeFT-I, 1642 meshkuj u randomizuan ndaj placebos, prazosines ose H-ISDN qe ju shtuan nje diuretiku dhe digoksines. Asnje pacient nuk u trajtua me β -bllokues ose ACEI. Nuk pati ndryshime ne mortalitet midis grupit te placebos dhe atij te prazosines. Me H-ISDN, pati nje tendece per ulje ne mortalitetin gjithe-shkakor gjate gjithe periudhes se ndjekjes (mesatarisht 2.3 vjet): RRR 22%; ARR 5.3%; NNT = 19. H-ISDN rriti kapacitetin ne eforte fizike dhe EF e VM krahasuar me placebo.
- Ne A-HeFT, 1050 meshkuj e femra afro-amerikane me klasen NYHA III ose IV, u randomizuan me placebo ose H-ISDN, qe ju shtua nje diuretiku (ne 90%), digoksine (60%), nje ACEI (70%), nje ARB (17%), nje β -bllokuesi (74%) dhe spironolaktoni (39%). Studimi u nderpre me heret, pas nje nje ndjekje mesatarisht prej 10 muajsh, per shkak te nje uljeje sinjifikante ne mortalitet (RRR 43%; ARR 4.0%; NNT = 25). H-ISDN ul gjithashtu dhe riskun per hospitalizimin nga IK (RRR 33%) dhe permison cilesine e jetes.

- Ne V-HeFT-II, u randomizuan 804 meshkuj, kryesisht ne klasen NYHA II dhe II, ndaj enalaprilit ose H-ISDN, qe ju shtuan nje diuretiku dhe digoksine. Asnje pacient nuk u trajtua me β -bllokues. U vu re nje tendece ne grupin e H-ISDN per nje rritje te mortalitetit gjithe-shkakor gjate gjithe periudhes se ndjekjes (mesatarisht 2.5 vjet): rritje relative e riskut 28%.
- Efekti anesor me i shpeshte me H-ISDN ne keto studime ishin dhimbje koke, marrje mendsh/hipotension dhe nauze. Artralgja qe coi ne nderprerje ose ulje te dozes se H-ISDN, ndodhi ne rreth 5-10% te pacienteve ne V-HeFT I dhe II dhe ne nje rritje te zgjatur te antitrupave antinukleare (ANA) ne 2-3% te pacienteve (por sindroma e ngjashme me lupusin ishte e ralle).

Pacientet qe duhet te marrin hidralazine dhe izosorbit dinitrate

Indikacionet, te bazuar ne pacientet e regjistruar ne RCT:

- Nje alternative ndaj nje ACEI/ARB kur te dy ose i fundit nuk tolerohen.
- Si nje shtese ne terapi me nje ACEI, nese nje ARB ose nje antagonist i aldosteronit nuk tolerohet
- Te dhenat jane me te forta ne paciente me origjine afro-amerikane.

Kunderindikacionet

- Hipotensioni simptomatik
- Sindromi i lupusit
- Insuficience renale severe (mund te nevojitet reduktimi i dozes)

Si te perdoret hidralazine dhe izosorbit dinitrati ne IK

Fillimi

- Doza e fillimit: hidralazine 37.5 mg dhe ISDN 20 mg t.i.d.

Titrimi i dozes

- Te kihet ne konsiderate titrimi i dozes pas 2 - 4 javë. Mos rrisni dozen kur kemi hipotension simptomatik.
- Nese tolerohet, qellimi per dozen target te evidences-baze – hidralazine 75 mg dhe ISDN 40 mg t.i.d. – ose doza maksimale e toleruar.

Efekte anesore potenciale

- Hipotensioni simptomatik (p.sh. marrje mendsh) – shpesh permisohet me kohe; te konsiderohet ulja e dozes se agjenteve te tjere hipotensive (pervec ACEI/ARB/ β -bllokues/antagonistet e aldosteronit). Hipotensioni asimptomatik nuk kerkon nderhyrje.
- Artralgja/dhimbje te muskujve, enjtje ose dhimbje te kyceve, perikarditi/pleuriti, temperature ose urtikarie – te konsiderohet sindroma e ngjashme me lupusin e induktuar nga medikamentet; te kontrollohen ANA, te nderpritet H-ISDN.

Digoksina

Te pacientet me IK simptomatike dhe FA (fibrilacion atrial), digoksina mund te per perdoret per te ulur frekuencen ventrikulare te larte. Te pacientet me FA dhe EF te VM $\leq 40\%$ duhet te perdoret per te kontrolluar frekuencen kardiak e vec, ose para nje β -bllokuesi.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

Te pacientet ne ritem sinusal me IK simptomatike dhe EF te VM $\leq 40\%$, trajtimi me digoksine (vec nje ACEI) per mison funksionin ventrikular dhe mireqenien e pacientit, pakeson shtrime me spital nga perkeqesimi i IK, por nuk ka asnje efekt ne mbijetese.

Klasa e IIa rekomandimit, niveli B i evidences

Te dhena kyce

Digoksina ne paciente me IK dhe fibrilacion atrial

- Digoksina eshte e nevojshme per kontrollin fillestar te frekuencies ventrikulare te nje pacient me FA me fc te shpejte dhe mund te konsiderohet te pacientet me IK te dekompesuar perpara fillimit te nje β -bllokuesit.
- Per periudha afatgjate, nje β -bllokues, vetem ose i kombinuar me digoksine, eshte mjekimi i preferuar per kontrollin e frekuencies (dhe per benefite te tjera klinike) te pacientet me EF te VM $\leq 40\%$.
- Ndersa digoksina vetem mund te kontrolloje frekuencen ventrikulare ne qetesni (target < 80 rr/min), zakonisht nuk na siguron kontroll te mjaftueshem te frekuencies gjate sforcimeve fizike (target $\leq 110 - 120$ rr/min).
- Te pacientet me EF te VM $> 40\%$, mund te perdoret vetem verapamili ose diltiazemi ose i kombinuar me digoksine per te kontrolluar frekuencen ventrikulare.

Digoksina te pacientet me IK, EF te VM $\leq 40\%$ dhe ritem sinusal

- Nje RCT i vetem i madh prospektiv eshte ndermanre me digoksinen te pacientet me IK simptomatike dhe EF te VM te ulet.
- Ne studimin DIG, 6800 paciente me EF te VM $\leq 45\%$ dhe ne klasen NYHA II-IV u randomizuan me placebo ose digoksine (0.25 mg o.d.), qe iu shtua nje diuretiku ose ACEI. Ky studim u krye para se β -bllokuesit te perdoreshin gjeresisht per IK.¹²⁰
- Trajtimi me digoksine nuk ndryshoi vdekshmerine shume-shkakore por coi ne nje RRR per hospitalizime nga perkeqesimi i IK ne 28% brenda nje mesatare 3 vjetesh nga fillimi mjekimit. ARR absolute ishte 7.9%, e barazylefshme me nje NNT (per 3 vjet per te shtyre nje shtrim te pacientit) ne 13.
- Keto rezultate mbeshteten nga nje meta-analize,¹²¹ por nuk mbeshteten plotesisht nga studimi DIG ku nuk u permisua cilesia e jetes¹²² dhe nuk pati avantazhe te pacientet me IKEFR (HFPEF).
- Digoksina mund te shkaktoje aritmi atriale dhe ventrikulare, vecanerisht ne konteksin e hipokalemise dhe eshte e detyrueshme monitorimi serial i elektroliteve ne serum dhe i funksionit renal.

Pacientet me insuficience kardiake qe duhet te marrin digoksin

Indikacione, te bazuara ne paciente te regjistruar ne RCT:

Fibrilacioni atrial

- Me frekuence ventrikulare ne qetesit > 80 rr/min, ne sforcime fizike $> 110-120$ rr/min.

Ritem sinusal

- Disfunktional i VM (EF i VM $\leq 40\%$)
- Simptoma te lehta ne severe (klasa NYHA II-IV)
- Doza optimale te ACEI ose/dhe nje ARB, β -blokuesi dhe antagonisti te aldosteronit, nese indikohet.

Kunderindikacionet

- Blok i grades se dyte ose te trete (pa pace-maker permanent); kujdes nese dyshohet sindrom i sinusit te semure
- Sindromat e pre-eksitimit
- Te dhena te meparshme per intolerance ndaj digoksines

Si te perdorim digoksinen ne insuficience kardiake

Fillimi i digoksines

- *Doza e nisjes:* doza e ngopjes te digoksines ne perqithesi nuk kerkohen ne pacientet e qendrueshem me ritem sinusal. Nje doze e vetme mbajtese ditore prej 0.25 mg perdoret zakonisht te te rritur me funksion rnal normal. Te te moshuarit dhe te ata me demtim renal duhet te perdoret nje doze e pakesuar prej 0.125 ose 0.0625 mg o.d.
- Perqendrimet e digoksines duhet te kotollohen heret gjate terapise kronike te ata me funksion renal normal. Te ata me demtim renal, gjendja e qendrueshem mund te kerkoje kohe me te gjate per t'u arritur.
- Nuk ka te dhena qe matje te rregullta te perqendrimit te digoksines te paraqesin te rezultate me te mira. Perqendrimi terapeutik ne serum duhet te jete midis 0.6 dhe 1.2 ng/mL, me te uleta se ato te rekomanduara me pare.
- Disa medikamente mund te rrisin nivelet e digoksines ne plazme (amiodaroni, diltiazem, verapamil, disa antibitioke, kinidina).

Efekte anesore potenciale

- Bloku sinoatrial dhe atrioventrikular
- Aritmi atriale dhe ventrikulare, vecanerisht ne prani te hipokalemise (fragmente antitrapash Fab specifike digoksin duhet te kihen parasysh per aritmite ventrikulare te shkaktuara nga toksiciteti).
- Shenja te toksicitetit perfshijne: konfuzion, nauzea, anoreksia dhe cregullime te shikimit te ngjyrave.

Diuretiket (Tabela 21)

Diuretiket rekomandohen te pacientet me IK dhe shenja klinike ose simptoma te kongestionit.

Klasa e I e rekomandimit, niveli B i evidences

Te dhena kyce

- Diuretike janë lehtesim nga simptomat dhe shenjet e kongestionit pulmonar dhe kongjektori sistemik venoz te pacientet me IK.¹²³
- Diuretiket shkaktojnë aktivizim te sistemit renin-angiotenzin-aldosteron te pacientet me simptoma te lehte te IK dhe zakonisht duhet te perdoren te kombinuar me një ACEI/ARB.
- Sasia e dozes duhet te pershtatet sipas nevojat personale te pacientit dhe kerkon monitorim te kujdeshem klinik.
- Ne per gjithesi, një diuretik i anses nevojitet ne IK te moderuar ose severe.
- Një thiazid mund te perdoret i kombinuar me diuretike te anses per edema rezistente, por me kujdes per te eviruar dehidrimin, hipovolemin, hiponatremine ose hipokalemie.
- Eshte e rendesishme te monitorohen nivelet e potassiumit (te kaliumit), sodiumit (kripes) dhe kreatinines gjate terapise me diuretike.

Diuretiket dhe ACEI/ARB/antagonistet e aldosteronit

- Zbrasja e volumit dhe hiponatremia nga diureza e tepert mund te rrise riskun per hipotension dhe disfunksion renal me terapine me ACEI/ARB.
- Nese një ACEI/ARB/antagonist i aldosteronit perdoret me një diuretik, zakonisht mund te mos kerkohet zevendesimi i potassiumit.
- Mund te ndodhe hiperkalemi serioze nese diuretike mbajtes te kaliumit, duke perfshire antagonistet e aldosteronit perdoren te kombinuar me ACEI/ARB. Diuretike mbajtes te kaliumit antagoniste jo-aldosteronik duhet te evitojen. Kombinimi i një antagonistit te aldosteronit dhe një ACEI/ARB duhet te perdoret nen një mbikëqyrje te kujdeshme.

Tabela 21 Konsiderata praktike ne trajtimin e IK me diuretiket e anses

Probleme	Veprime te sygjeruara
Hipokalemi/hipomagnezemi	<ul style="list-style-type: none">• Rrit dozen e ACEI/ARB• Shtoni antagoniste te aldosteronit• Shtoni potassium• Shton magnez• Kufizoni likidet
Hiponatremia	<ul style="list-style-type: none">• Nderprisni diuretiket thiazidike ose ndryshojeni me diuretike te anses, nese eshte e mundur• Pakesoni dozen/nderprisni diuretiket e anses nese eshte e mundur• Konsideroni antagonistet AVP, p.sh.tolvaptan nese eshte e disponueshme• Ndihmese inotropoke i.v.

Hiperuricemia/podagra	<ul style="list-style-type: none"> ● Kini parasysh ultrafiltrimin ● Kini parasysh allopurinolin ● Per podager simptomatik perdorni kolkicine per qetesimin e dhimbjeve ● Evitonit NSAIDs
Hipovolemia/dehidrimi	<ul style="list-style-type: none"> ● Vleresoni gjendjen e volumit ● Kini parasysh pakesimin e dozes se diuretikeve
Pergjigje jo e mjaftueshem ose rezistence ndaj diuretikeve	<ul style="list-style-type: none"> ● Kontrolloni kompliancen ose marrjen e likideve ● Rrissni dozen e diuretikeve ● Kini parasysh te nderroni furosemidin ne bumetanide ose torasemide ● Shtoni antagonistet e aldosteronit ● Kombinoni diuretike te anses me thiazidike/metolazone ● Perdorni diuretiket e anses dy here ne dite ose ne nje stomak bosh ● Kini parasysh te perdorni infuzion i.v te diuretikeve te anses per nje kohe te shkurter
Insuficiencia renale (rritje e tepert ne ure/BUN dhe ose kreatinine)	<ul style="list-style-type: none"> ● Kontrolloni per hipovolemi/dehidrim ● Perjashtonit perdorimin e agjenteve te tjere nefrotoksiqe p.sh. NSAID, trimethoprim ● Ndaloni antagonistet e aldosteronit ● Nese perdorni diuretike te anses dhe thiazidike, nderprisni diuretiket thiazidike ● Te ulet doza e ACEI/ARB ● Kini parasysh ultrafiltrimi

Si te perdomir diuretiket ne IK

Fillimi i terapise me diuretike

- Kontrolloni funksionin renal dhe elektrolitet ne serum
- Shumica e pacienteve marrin diuretike te anses sesa thiazidike per shkak te efikasitetit te larte ne induktimin e diurezes dhe natriurezes.

Dozat e diuretikeve (Tabela 22)

- Filloni me nje doze te ulet dhe rriteni deri ne permisimin klinik te simptomave dhe shenjave te kongestionit.

- Dozat duhet te rregullohen, vecanerisht pas rekuperimit te peshes trupore te thate, per te evituat riskun e disfunkzionit renal dhe dehidrimit. Qellimi eshte te mbahet “peshe e thate” me doza te uleta.
- Vete-rregullimi i dozes se diuretikeve bazohet matjet ditore te peshes dhe shenja te tjera klinike te mbajtjes se likideve dhe duhet inkurajohet ne kujdesin ambulator te pacienteve me IK. Kerkohet edukimi i pacienteve.
- Menaxhimi i rezistence se diuretikeve eshte paraqitur ne Tabelen 21.

Tabela 22 Dozat e diuretikeve te patientet me IK

Diuretiket	Doza e fillimit (mg)	Doza ditore e zakonshme (mg)		
Diuretiket e anses*				
• Furosemide	20-40	40-240		
• Bumetanide	0.5-1.0	1-5		
• Torasemide	5-10	10-20		
Thiazidiket**				
• Bendroflume hiazide	2.5	2.5-10		
• Hydrochlorthiazide	25	12.5-100		
• Metolazone	2.5	2.5-10		
• Indapamide†	2.5	2.5-5		
Diuretiket mbajtes te K⁺***				
	+ACEI/ARB	-ACEI/ARB	+ACEI/ARB	-ACEI/ARB
• Spironolacton/eplerenone	12.5-25	50	50	100-200
• Amiloride	2.5	5	20	4
• Triamterene	25	50	100	200

*Doza mund te nevojitet te rregullohet sipas gjendjes se volumit/peshes; doza te teperta mund te shkaktojne demtim renal ose ototoksicitet.

**Mos perdorni thiazidet nese eGRF<30 mL/min, vetem kur përshtakuhet sinergistikisht me diuretiket e anses.

***Antagonistet e aldosteronit gjithmone duhet te preferohen ndaj diuretikeve te tjere mbajtes te potassiumit.

†Indapamide nuk eshte nje sulfonamid jo-tiazidik.

Medikamente te tjera te perdorura per te trajtuar ko-morbiditetin kardiovaskular te patientet me IK

Antikoagulante (antagonistet e vitamines K)

Warfarina (ose nje antikoagulant oral tjeter) eshte e rekomandueshme te pacienteve me IK dhe me fibrilacion atrial permanent, persistent ose paroksismal pa kunderindikimi ndaj

antikoagulimit. Rregullimi i dozes se antikoagulimit ul rrezikun e komplikacioneve tromboembolike perfshire dhe aksidentet cerebrale.

Klasa e I rekomandimit, niveli A i evidences

Antikoagulimi rekomandohet gjithashtu te pacientet me trombe intrakardiake te zbuluara me imazheri ose me te dhena te embolizmit sistemik.

Klasa e I rekomandimit, niveli C i evidences

Te dhena kyce

- Te dhenat qe antikoagulantet jane efikas ne uljen e tromboembolizmit te pacientet me fibrilacion atrial jane permbledhur ne bashkimin e udherrefyesve te ACC/AHA/ESC.¹²⁴
- Ne nje seri studimesh te randomizuara te pacientet me fibrilacion atrial, qe perfshinte paciente me IK, warfarina uli riskun e aksidenteve cerebrale ne rreth 60-70%.
- Warfarina ishte me efikase ne uljen e riskut te aksidenteve cerebrale sesa terapia me antitrombocitare dhe preferohet nga terapia me antitrombocitare te pacientet me risk te larte te aksidenteve cerebrale, sic ishin ata me IK.¹²⁵
- Nuk ka asnje efekt te provuar per antikoagulim ne paciente te tjere me IK, pavec atyre me proteze valvulare.

Agjentet antitrombocitare

Te dhena kyce

- Agjente antitrombocitare nuk jane aq efikase sa warfarina ne uljen e riskut te tromboembolise te pacientet me fibrilacion atrial.
- Ne nje analize te dy studimeve te vogla qe krahasoje warfarinen me aspirinen te pacientet me IK, riku i hospitalizmit nga IK ishte shume me i madh ne ata te trajtuar me aspirin kahasuar me pacientet e trajtuar me warfarin.¹²⁶
- Nuk ka asnje te dhene qe agjentet antitrombocitare ulin riskun aterosklerotik te pacientet me IK.

Inhibitoret e HMG CoA reduktazes (“statinat”)

Te pacientet e moshuar me IK kronike simptomatike dhe disfunktioni sistolik te shkaktuar nga SAK (semundja e arterieve koronare), trajtimi me statina mund te merret ne konsiderate per te ulur hospitalizimin kardiovaskular.

Klasa e IIb rekomandimit, niveli B i evidences

Te dhena kyce

- Shuma e studimeve me statina i perjashtojne pacientet me IK. Vetem nje studim, CORONA, studoi ne vecanti nje statine te pacientet me IK, etiologji ishemike dhe EF te ulur. Rosuvastatina nuk uli pike-mberritjen primare (vdekje kardiovaskulare, IM ose aksident

ecerebrale) ose mortalitetin gjitheshkakesor. Numri i hospitalizimeve per shkaqe kardiovaskulare u ul ne menyre domethenese.¹²⁷

- Vlera e statinave te pacientet me IK me etiologji jo-ishemike eshte i panjohur.

Menaximi i pacienteve me insuficience kardiake dhe fraksion ejekzioni te ventrikulit te majte te ruajtur (HFPEF – IKEFR)

- Nuk eshte treguar akoma asnje trajtim, per te pakesuar morbiditetin dhe mortalitetin te pacientet e HFPEF. Diuretiket perdoren per te kontrolluar mbajtjen e ujit dhe te sodiumit (kripes) dhe per te lethesuar marrjen e frysme dhe edemat. Mjekim adekuat i hipertensionit dhe ishemise miokardiale eshte konsideruar gjithashtu i rendesishem, sic eshte kontrolli i frekuences ventrikulare te pacietet me fibrilacion atrial. Dy studime shume te vogla (<30 paciente secili) kane treguar se bllokuesi i kanaleve te kalciumit e frekuences kardiake, verapamili mund te permisoje kapacitteten e eforje fizike dhe simptomat ne keta paciente.^{128,129}
- 3023 pacient e Candarsartan ne Insuficencen kardiake: Vleresimi i uljes ne Mortalitet e Morbiditet (CHARM) – studim i Ruajtur nuk tregoi nje ulje sinjifikante ne riskun e pike-mberritjen se kompozitit primar (vdekje e shkaktuar nga shkaqe kardiovaskulare ose shtrime me IK) por tregoi nje ulje sinjifikative ne riskun e shtrimeve investiguese-raportuese per IK.¹³⁰ 850 pacientet e studimit Perindopril per Popullaten e Moshuar me IK Kronike (PEP-CHF) deshtuan per te treguar nje ulje ne kete pike-mberritje primare te kompozitit, gjate kohezgjatjes totale te studimit, por tregoi nje ulje sinjifikative ne vdekjen kardiovaskulare dhe ne hospitalizimin per IK per nje vit.¹³¹

Teknikat Invazive dhe Kirurgjia

Procedurat revaskularizuese, kirurgjia valvulare dhe ventrikulare

- Nese simptomat e insuficences kardiake jane te pranishme, gjendje te korrigueshme ne menyre kirurgjikale duhen zbuluar dhe korigjuar.
- SAK eshte shkaku me i shpeshte i IK dhe eshte prezent ne 60-70% te pacienteve me IK dhe demtim te funzionit sistolik te VM. Etiologja iskemike lidhet me rrisk me te larte vdekshmerie dhe semundshmerie.

Revaskularizimi ne paciente me insuficience kardiake

By-pasi aorto-koronar (CABG -coronary artery bypass grafting) dhe nderhyrja koronare percutane (PCI percutaneous coronary intervention) duhen konsideruar ne paciente te perzgjedhur me insuficience kardiake dhe SAK. Vendimet persa i perket zgjedhjes se metodes se revaskularizimit duhet te vleresojen ne baze te nje vlersimi te kujdeshem te semundjeve shoqeruese, rriskut procedural, anatomise koronare dhe provave te sasise se miokardit viabel ne zonen qe do te revaskularizohet, funksionin e ventrikulit te majte (VM) dhe pranine e semundjes valvulare sinjifikante nga pikepamja hemodinamike.

Provat shkencore

Nuk ka te dhena nga studime multicentrike qe vleresojne procedurat revaskularizuese per lehtesimin e simptomave te IK. Megjithate, studime vezhguese single-centre mbi IK me etiologji iskemike sugjerojne se revaskularizimi mund te coje ne permirsim klinik dhe potencialisht ne permiresim te funksionit kardiak.

Vleresimi per semundje te arterieve koronare ne paciente me IK me shtrat koronar te paeksploruar

Koronarografia ne rutine nuk rekomandohet.

Ne paciente me rrisk te ulet per SAK: rezultatet e testeve jo-invazive duhet te percaktojne indikacionin per koronarografi (prova ushtrimore, EKO stres, imazheria me radionukleide).

Koronarografia

- Rekomandohet ne paciente me rrisk te larte per SAK pa kunderindikacione per te vertetuar diagnozen dhe planifikuar menyren e trajtimit.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Rekomandohet ne paciente me IK dhe semundje valvulare te rendesishme.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Duhet konsideruar ne paciente me IK te cilet perjetojne simptoma anginoze pavarsisht terapise medikamentoze optimale.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

Zbulimi i miokardit viabel

Meqenese miokardi viabel mund te jete objekt i revaskularizimit, zbulimi i tij duhet te konsiderohet ne kerkimin diagnostik ne paciente me IK dhe SAK. Disa lloj egzaminimesh imazherike me siguri diagnostike te krahasueshme mund te perdoren per te detektuar miokardin disfunkcionant por viabel (EKO – dobutamine, imazheria me radionukleide me SPECT dhe/ose PET, RM me dobutamine dhe / ose lende kontrasti, TC me kontrast).

Kirurgjia valvulare

- Semundja valvulare mund te jete shkaku etiologjik i IK ose nje faktor rendues i cili kerkon menazhim specifik.
- Udherrefyesit e ESC ne menazhimin e semundjes valvulare aplikohen ne shumicen e pacienteve me IK. Megjithese alterimi i fraksionit te ejekzionit te VM (LVEF) eshte faktor i rendesishem mortalitet peri dhe pas-operator, kirurgjia mund te konsiderohet ne paciente simptomatike me funksion te keq te VM.

- Menazhimi medikamentoz optimal i IK dhe semundjeve shoqeruese eshte i detyrueshem para kirurgjise nderkohe qe kirurgjia e urgjences duhet te shmanget nese eshte e mundur.
- Jane te veshtira rekomandimet specifike per intervent ne te semure me semundje valvulare dhe IK. Vendimet duhet te meren duke u bazuar ne te dhenat klinike dhe vleresimit ekokardigrafik dhe njekohesish duke vleresuar me kujdes semundjet shoqeruese kardiovaskukare dhe jo-kardiovaskulare. Vendimet per intervent kirurgjikal per stenozen e aortes, regurgitimin e aortes dhe regurgitimin mitral hemodinamikisht sinjifikative, kerkon vleresim te kujdeshem te motivimit te pacientit, moshes biologjike dhe profilit te faktoreve te rriskut.

Kirurgjia e valvules se aortes

Stenoza e aortes

Trajtimi medikamentoz dueht te optimizohet sa me mire por jo te vonojne vendimin ne lidhje me nderhyrjen. Vazodilatatoret (ACEI, ARB dhe nitratet) mund te shkaktojne hipotension te thelle dhe duhet te perdoren me mjaft kujdes.

Kirurgjia

- Rekomandohet ne paciente me simptoma te IK dhe stenoze te theksuar aorte.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Rekomandohet ne paciente asimptomatike dhe stenoze te theksuar te aortes me FE < 50%.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Mund te konsiderohet ne paciente me stenoze te theksuar te aortes dhe disfunkzion te VM.

Klasa e IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

Regurgitimi i aortes

Kirurgjia

- Rekomandohet ne paciente te pershatshem dhe regurgitim sever te aortes te cilet kane simptoma te IK.

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Rekomandohet ne paciente asimptomatike me RA sever dhe ulje te moderuar te funksionit sistolik te VM (FE<50%)

Klasa e IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

Evidencia kryesore

Funksioni i VM zakonisht permiresohet pas nderhyrjes kirurgjikale, dhe nje studim jo i randomizuar tregoi permiresim te mbijeteses ne krahasim me rastet e kontrollit.¹³⁷ Nga ana tjeter rrisku i kirurgjise eshte me i larte ne paciente me disfunkcion te avancuar te VM.¹³⁶

Kirurgjia e valvules mitrale

Regurgitimi mitral

Kirurgjia

- Ne paciente me IK dhe regurgitim sever mitral, raportohet permiresim klinik ne paciente te perzgjedhur. Kirurgjia duhet te konsiderohet ne paciente me RM sever sa here qe revaskularizimi koronare eshte e planifikuar. Riparimi kirurgjikal i valvules mitrale mund te jete nje opson atraktiv ne paciente te perzgjedhur.¹³⁶

Regurgitimi mitral organik

- Ne paciente me RM sever si rrjedhoje e nje crregullimi struktural apo demtimi te valvules mitrale shfaqja e simptomave te IK eshte indikacion i forte per intervent.

Kirurgjia

- Rekomandohet ne paciente me FE > 30% (reparim valvular nese eshte e mundur).

Klasa e I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Mund te konsiderohet ne paciente me RM sever dhe LVEF < 30% ; terapia medikamentoze duhet te jete zgjedhja e pare. Vetem nese patientet mbeten refraktare ndaj terapise farmakologjike dhe kane rrisk te ulet, mund te konsiderohet kirurgjia.

Klasa e IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

Regurgitimi mitral funksional

Kirurgjia

- Mund te konsiderohet ne paciente me RM funksional sever dhe disfunkcion te rende te VM te cilet mbesinsimptomatike pavaresisht terapise medikamentoze maksimale.

Klasa e IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

- Terapia resinkronizuese kardiake (CRT) duhet te konsiderohet ne paciente te pershtatshem pasi mund te permiresoje gjeometrine e VM, dissinkronine e muskujeve papilare dhe mund te reduktoje RM.

Klasa e IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

Regurgitimi mitral iskemik

Kirurgjia

- Rekomandohet ne paciente me RM sever dhe LVEF > 30 % ne te cilet eshte planifikuar CABG.

Klasa I rekomandimit, niveli C i evidences

- Duhet konsideruar ne paciente me RM te moderuar te cilet i nenshtrohen CABG nese riparimi eshte i mundshem.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Regurgitimi trikuspidal (RT)

- RT funksional eshte mjaft i zakonshem ne paciente me IK dhe dilatacion biventrikular, disfunkcion sistolik dhe hipertension pulmonar. Simptomat e IK te djathte me congestiuni sistemik perqigjen pak ndaj terapise agresive me diuretike te cilet mund te rendojne simptoma te tilla si lodhja, dobesia e perqjithshme dhe toleranca e ulet ushtrimore. Kirurgjia per RT funksional te izoluar nuk eshte e rekomanduar.

Klasa III e rekomandimit, niveli C i evidences

Aneurizmektomia e ventrikulit te majte

- Aneurizmektomia e VM mund te konsiderohet ne paciente asimptomatike me aneurizem te madhe dhe diskrete te VM.

Klasa IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

Cardiomioplastika

- Cardiomioplastika dhe ventrikuloektomia parciiale (Operacioni Batista) nuk rekomandohet per trajtimin e IK dhe as si alternative e transplantit kardiak.

Klasa III e rekomandimit, niveli C i evidences

Pejsmejkerat (pace-maker)

- Indikacionet konvencionale per pacientet me funksion normal te VM aplikohen gjithashtu per paciente me IK. Ne paciente me IK dhe ritem sinusal mbajtja e perqigjes kronotropike normale dhe koordinimi i kontraksionit atrial me ate ventrikular me pejsmeker DDD mund te jete mjaft i rendesishem.
- Ne paciente me IK dhe indikacion per pejsim permanent, me simptoma II – IV te klasses NYHA, LVEF < 35 %, ose dilatacion te VM, duhet te konsiderohet CRT me funksion peismeker (CRT – P). Ne keto paciente aplikimi i pejsimit ne ventrikulin e djathte mund te jete i demshem dhe mund te shkaktoje rritje te dissinkronise.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Terapia e resinkronizimit (*Tabela 23*)

- CRT-P rekomandohet per te reduktuar morbiditetin dhe mortalitetin ne paciente te klasses III – IV NYHA te cilet jane simptomatike pavaresisht terapise medikamentoze maksimale, dhe te cilet kane EF te reduktuar (LVEF < 35 %) dhe zgjerim te kompleksit QRS (QRS > 120 ms).

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

Tabela 23 Klasa I e rekomandimit per divajsat ne paciente me disfunkzion sistolik te VM.

ICD

Arrest kardiak i meparshem	Klasa I Nivel A
Etiologji iskemike dhe > 40 dite nga IM	Klasa I Nivel A
Etiologji jo-iskemike	Klasa I Nivel B

CRT

Klasa NYHA III/IV dhe QRS > 120 ms	Klasa I Nivel A
Per te permiresuar simptomat/reduktuar hospitalizimet	Klasa I Nivel A
Per te reduktuar mortalitetin	Klasa I Nivel A

- CRT me funksion defibrilatori (CRT-D) rekomandohet per te reduktuar mortalitetin dhe semundshmerine ne paciente te klasses NYHA III - IV te cilet jane simptomatike pavaresisht terapise maksimale medikamentoze dhe te cilet kane EF (LVEF < 35 %) dhe zgjatje te QRS (QRS > 120 ms).

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

Evidenca te rendesishme

- CRT perdoret per te sinkronizuar kontraksionin interventrikular dhe interventrikular ne paciente me IK ne te cilet ka prova disinkronise elektrike (QRS > 120 ms). Disa studime observacionale single – centre kane sugjeruar se nje ose ose disa matje te disinkronise mekanike mund te parashikojne perfitime me CRT ne paciente te perzgjedhur. Megjithese divajsat e CRT jane implantuar ne paciente pa shenja te disinkronise ne EKG (QRS < 120 ms), bazuar ne shenja ekokardiografike te disinkronise, nuk ka ndonje studim qe ta mbeshtese kete lloj praktike. 139 Studimi i publikuar se fundmi PROSPECT nuk e mbeshtet perdonimin e indekseve mekanike te disinkronise qe perftohen me ane te ekokardiografise dhe Dopplerit indor ne selektimin e pacienteve. 140
- Studimet e para qe kane investiguar vleren e CRT ne menaxhimin e pacienteve te klasses NYHA III dhe IV, reduktim te LVEF dhe QRS te zgjeruar kane demonstruar se CRT permireson shkallen funksionale, kohezgjatjen e aftesise ushtrimore dhe kualitetin e jetes. 141 – 145.
- Dy studime te medha investiguan efektin e CRT ne mortalitetin gjitheshkaksor ne paciente me IK te klsases NYHA III dhe IV dhe disinkroni. Ne COMPANION, CRT-P dhe CRT-D lidheshin qe te dyja me reduktim 20 % te end-pointit te kombinuar primar te mortalitetit gjitheshkaksor dhe hospitalizimit gjitheshkaksor ($P < 0,01$). CRT-D lidhej me nje reduktim te mortalitetit total ($P = 0,003$), ndersa reduktimi i mortalitetit lidhur me CRT-P nuk ishte statistikisht i rendesishem ($P = 0,059$). Eshte e rendesishme te theksohet se studimi nuk dizenjuar apo me fuqi statistikore te vleresoje efektet ne mortalitetin total dhe as te krahasonin CRT-P me CRT-D dhe se nuk ka te dhena perfundimtare qe krahasoje efektet e tyre.

Defibrilatori implantuar kardiak (ICD) (Tabela 23)

- Terapia me ICD per parandalim sekondar rekomandohet per te mbijetuarit nga fibrilacioni ventrikular (FV) dhe gjithashtu per paciente me TV hemodinamikisht te paqendrueshme dhe/ose TV me sinkope, LVEF < 40%, nen terapi medikamentoze optimale dhe nje pritshmeri te mbijeteses me nje gjendje funksionale te mire per > vit.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Terapia me ICD per parandalim primar rekomandohet per te reduktuar mortalitetin ne paciente me disfunkcion te VM si pasoje e IM te kaluar qe jane te pakten 40 dite pas kalimit te tij, kane LVEF < 35%, ne shkallen NYHA II ose III, nen terapi medikamentoze optimale dhe te cilet kane nje pritshmeri te mbijeteses ne gjendje te mire funksionale per > 1 vit.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Terapia me ICD per parandalim primar rekomandohet per te reduktuar mortalitetin ne paciente me kardiomiopati jo-iskemike me LVEF < 35%, ne klasen funksionale NYHA II ose III, te cilet jane nen terapi medikamentoze optimale dhe qe kane nje pritshmeri te arsyeshme te mbijeteses me nje gjendje te mire funksionale per > 1 vit.

Klasa I e rekomandimit, niveli B i evidences

Evidencia te rendesishme

- Afersisht gjysma e vdekjeve te vezhguara ne paciente me IK Jane te lidhura me vdekjen e papritur (SCD). Reduktimi i proporcioneve qe vdesin nga nje shkak aritmik eshte nje pjese e rendesishme e perpjekjes per te reduktuar mortalitetin total ne kete popullate.

- **Parandalimi sekondar i arrestit kardiak**

Studime klinike ne paciente post – IM te cilet i kane mbijetuar nje arresti kardiak kane demonstruar se perdonimi i ICD eshte me efektiv sesa trajtimi me medikamente antiaritmike per parandalimin e SCD. 146 – 148

Meta-analiza te studimeve mbi parandalimit primar kane treguar se perfitimi ne mbijetese me perdonimin e ICD – ve eshte shume me i larte ne paciente me funksion sistolik te ulur (LVEF < 35%). 149 Nuk ka studime qe ti adresohen popullates me etiologji jo-iskemike te cilet i kane mbijetuar arrestit kardiak.

- **Parandalimi primar i arrestit kardiak**

Rezultatet e studimeve me medikamente antiaritmike te klases se I dhe III te kryera ne vitet 80’ 150 dhe 90’ 151 – 156 nuk kane treguar efikasitet. Studimi SCD – HeFT 157 demonstroj mungese te perfitimit ne mbijetese ne paciente me klase funksionale NYHA II dhe III dhe me LVEF < 35% te trajtuar me amiodaron pavaresisht etiologjise te IK.

Shumica e studimeve me ICD per parandalim primar te SCD Jane fokusuar ne paciente me IK me etiologji iskemike, 158 – 162 dhe kane perfshire paciente me EF te reduktuar. Fatkeqesisht studime te ndryshme kane perdonur cut – off-e te EF (<30%, 35%, <40%). Evidencat me te forta egzistojne ne paciente me shkalle funksionale NYHA II dhe III.

Te dhena per rolin e ICD-ve ne paciente me kardiomiopati te dilatuar jo-iskemike (KMPD) Jane me te pakta. 164 – 166 Studimi SCD – HeFT perfshi paciente me te dyja diagnozat KMPD dhe disfunkcion sistolik iskemik te VM dhe tregoi 23% reduktim te mortalitetit. Nje algoritem praktik per selektimin e pacienteve te cilet kane indikacion per terapi me pajisje (CRT, ICD) jepet ne *Figuren 2*.

Transplanti i zemres, pajisjet e asistences ventrikulare, dhe zemra artificiale

Transplanti i zemres

Transplanti i zemres eshte pranuar si trajtim per IK ne stadet e fundit (end – stage HF). Megjithese studime te kontrolluara nuk jane kryer, ka nje konsensus se transplanti rrit ne menyre sinjfikante mbijetesen, kapacitetin ushtrimor, rikthimin ne pune dhe kualitetin e jetes krahasuar me terapine konvencionale.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

Pajisjet e asistences se ventrikulit te majte (LVAD) dhe zemra artificiale

LVAD dhe zemra artificiale mund te perdoren si ure per te kaluar te transplanti dhe ne menaxhimin e te semureve me miokardit acut te rende.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Ultrafiltrimi

Ultrafiltrimi duhet konsideruar per te reduktuar mbingarkesen ne lengje (edema pulmonare dhe/ose periferike) ne paciente te perzgjedhur dhe per te korriguar hyponatremine ne paciente simptomatike te cilet jane refraktare ndaj terapise me diuretike.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

Aritmite ne insuficiencen kardiake

Udherrefyesit e ACC/AHA/ESC per menaxhimin e pacienteve me aritmi 124 jane te aplikueshme ne paciente me IK. Ky seksion thekson aspektet e menaxhimit te cilat jane te lidhura ne menyre te vecante me IK.

Fibrilacioni atrial (*Tabela 24*)

AF eshte aritmia me e zakonshme ne IK. Fillimi i saj mund te coje ne perkeqesim te siptomave, dhe nje rritje te rriskut per komplikacione tromboembolike dhe rezultate te keqia afat-gjate.

Tabela 24 Menaxhimi i pacienteve me insuficience kardiake dhe fibrilacioni atrial

Rekomandime te pergithshme

- Duhet te identifikohen shkaqet precipituese dhe semundjet shoqeruese
- Duhet te optimizohet mire terapia e IK

Kontrolli i ritmit

- Kardioversioni elektrik imediat rekomandohet ne paciente me shfaqje per here te pare FA dhe iskemi te miokardit, hipotension simptomatik ose simptoma te kongestionit pulmonar ose per gjigje ventrikulare e shpejte jo e kontrolluar nga terapia medikamentoze

Kontrolli i frekuencies

- Digoksina e vetme ose ne kombinim me β – bllokues eshte e rekomanduar

Parandalimi i tromboembolise

- Terapia antitrombotike eshte e rekomanduar nese nuk ka kunderindikacione
Nje perqasje optimale dueht bazuar ne stratifikimin e rriskut:
ne paciente me rrisk te larte per insult cerebral [insult i meparshem, atak iskemik tranzitor (TIA) ose emboli sistemike] rekomandohet terapia me antikoagulante antagoniste te vitamines K

Rekomandimet e me poshtme jane te rendesishme per patientet me IK.

Kontrolli farmakologjik i frekuencies kardiake gjate fibrilacionit atrial (shiko sektionin e terapise farmakologjike)

- β – bllokuesi ose digoksina rekomandohen per te kontrolluar frekuencen kardiake ne qetesë ne paciente me IK dhe disfunkzion te VM.

Klasa I e rekomandimit, niveli B i evidences

- Kombinimi i digoksines dhe ß – blokuesit mund te konsiderohet per te kontrolluar frekuencen kardiake te qetesise dhe ne efort.
- Ne disfunkzionin sistolik te VM digoksina rekomandohet si trajtim fillestar ne paciente hemodinamikisht te paqendrueshem.
- Administrimi intravenoz i digoksines ose amiodaronit rekomandohet per te kontrolluar frekuencen kardiake ne paciente me FA dhe IK, te cilet nuk kane rruge aksesore.

Klasa I e rekomandimit, niveli B i evidences

- Ne paciente me IK dhe LVEF te ruajtur nje medikament i klases se calcibllokuesve jo-dihidropiridinave (te vetem ose ne kombinim me digoksinen) duhet te konsiderohet per te kontrolluar frekuencen kardiake ne qtesi dhe ne efort.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Parandalimi i tromboembolise (shih seksionin e terapise farmakologjike)

- Terapia antitrombotike per parandalimin e tromboembolise rekomandohet per te gjithe pacientet me FA kur nuk ka indikacion.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Ne paciente me FA dhe rrisk te larte per insult si tromboemboli e meparshme, insult, atak iskemik tranzitor, ose simboli sistemike, rekomandohet terapia antikoagulante orale me antivitaminike K duke mbajtur vlerat terapeutike te INR 2.0 – 3.0 nese nuk ka kunderindikacion.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Antikoagulimi rekomandohet per paciente me > 1 faktor rrisku te moderuar. Keta faktore perfshijnë: mosha > 75 vjec, hipertensioni, IK, demtim te funksionit sistolik te VM (LVEF < 35%) dhe diabeti melitus.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Ne paciente me IK dhe FA te cilet nuk kane faktore rreziku shtese terapia me aspirine (81 – 325 mg/dite) ose antivitaminiket K jane te arsyeshem per parandalimin primar te tromboembolise.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli A i evidences

Kontrolli i ritmit

Nuk ka evidencia te qarta se konvetimi dhe mbajtja ne ritem sinusal eshte superiore ne krasim me kontrollin e frekuencies ne reduktimin e semundshmerise dhe vdekshmerise ne paciente me FA persistent dhe IK. 172

- Konvertimi elektrik rekomandohet kur frekuencia e larte ventrikulare nuk per gjigjet shpejt ndaj terapise farmakologjike dhe vecanerisht ne paciente me FA qe shkakton iskemi te miokardit, hipotension simptomatik, ose simptoma te kongestionit pulmonar. Faktoret precipitues duhet te zbulohen dhe trajtohen. TEE mund te perdoret per te perjashtuar trombin atrial.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Ne paciente te cilet kerkojne cardioversion imediat per shkak te instabilitetit hemodinamik rekomandohet algoritmi i meposhtem:

Nese FA zgjat > 48 h ose eshte me moshe te panjohur, duhet administruar heparine i.v bolus e ndjekur nga infuzioni vazhduar. Heparinat me peshe te vogel molekulare te perdorura ne rruge subkutane jane nje alternative e pranueshme. TEE mund te kerkohet ne keto raste.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Ne paciente me FA dhe IK dhe/ose ulje te funksionit sistolik te VM perdorimi antiaritmikeve per te mbajtur ritmin sinusal duhet kufizuar tek amiodaroni.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Ne paciente me IK simptomatike dhe FA persistent (i cili nuk perfundon ne menyre te vjetvethime), kardioversioni elektrik duhet konsideruar suksesi mund te varet nga kohezgjatja e aritmise dhe madhesia e atriumit te majte.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

- Asministrimi i.v . i amiodaronit eshte nje opsjon i arsyeshem per kardioversionin farmakologjik te FA vecanerisht kur nuk kerkohet konvertimi ne menyre te shpejte. Pacientet duhet te antikoagulohen.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli A i evidences

- Procedurat invazive te ablacionit (izolimi i venave pulmonare) duhet konsideruar ne paciente refraktare por nuk jane vleresuar ne studime klinuke.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Aritmite ventrikulare (AV)

- Eshte thelbesore te detektohen dhe nese eshte e mundur te korrigohen te gjithe faktoret precipitues te AV. Rekomandohet blokada neurohumorale me doza optimale te β – blokuesve, ACE inhibitoreve, ARB – ve, dhe/ose antagonisteve te receptoreve te aldosteronit.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Ne te semuret me IK AV mund te shkaktohen nga iskemia miokardiale dhe terapia agrasive eshte thelbesore. Vleresimi per SAK dhe mundesa per revaskularizim rekomandohet ne pacientet me rrisk te larte.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Perdorimi profilaktik rutine i medikamenteve antiaritmike ne paciente me AV te paqendrueshme asimptomatike nuk rekomandohet.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

Pacientet me IK dhe AV simptomatike (shih sektionin e Paisjet dhe Kirurgjia)

- Ne paciente te cilet i kane mbijetuar FV ose kane patur nje histori te TV te paqendrueshme ose TV me sinkope me LVEF te reduktuar (< 40%), te cilet marrin terapi farmakologjike optimale dhe me nje mbijetese te pritshme > 1 vit rekomandohet implantimi i ICD.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Amiodaroni rekomandohet ne paciente me defibrilator te implantuar te cilet vazhdojnë ke kene AV simptomatike pavaresisht trajtimit farmakologjik optimal.

Klasa I e rekomandimit, niveli C i evidences

- Amiodaroni mund te konsiderohet si nje alterantive ndaj ICD per te supresuar TV simptomatike ne paciente me terapi optimale farmakologjike ne te cilet ICD nuk disponohet.

Klasa IIb e rekomandimit, niveli C i evidences

Semundjet shoqeruese dhe populatat e vecanta

Hipertensioni, SAK, dhe disfunkzioni valvular Jane faktore rrisku te shpeshte te IK ose mund te bashke-egzistojne me nje patologji tjeter primare.

Tabela 25 Menaxhimi i hipertensionit arterial ne paciente me insuficience kardiake

Ne paciente hypertensive dhe evidenca te disfunkzionit te VM

- Presioni arterial sistolik dhe diastolik duhet te kontrollohen ne menyre te kujdeshme me nje target terapeutik $< 140/90$ mmHg dhe $130/80$ mmHg ne paciente diabetike dhe me rrisk te larte.
- Preferohen regjimet antihipertensive te bazuara ne medikamentet antagoniste te sistemit renine – angiotenzine (ACEI, ARB).

Ne paciente hypertensive me IK dhe FE te ruajtur

- Rekomandohet trajtim agresiv (shpesh me medikamente te klasave te ndryshme me mekanizma veprimi komplementare)
- ACEI dhe/ose ARB duhen konsideruar si agjente te linjes se pare te trajtimit

Hipertensioni arterial (Tabela 25)

- Trajtimi i hipertensionit redukton ne menyre te rendesishme rriskun per te zhvilluar IK. Vlerat optimale nuk jante precizuara por sipas Udherrfyesave te koheve te fundit te ESH/ESC objekivat PA jane: (i) duhet te reduktohet te pakten poshte $140/90$ mmHg (sistolik/diastolik), dhe ne vlera me te uleta nese tolerohet ne te gjithe pacientet; dhe (ii) duhet te jetë $< 130/80$ mmHg ne diabetiket dhe ne grupet e tjera te pacienteve me rrezik te larte si ata me shenja te demtimit te organeve (insult, IM, disfunkcion renal, proteinuri).

Klasi I e rekomandimit, niveli A i evidences

Diabeti melitus (DM)

- DM eshte nje faktor rrisku per te zhvilluar semundje kardiovaskulare dhe IK.^{176, 177}
- ACEI dhe ARB-te mund te jene te perdorshem ne paceinte me DM per te ulur rriskun e demtimeve organore dhe komplikacioneve kardiovaskulare dhe si rrjedhoje rriskun per IK.

Klasi IIa e rekomandimit, niveli A i evidences per ACEI dhe C per ARB

Menaxhimi i DM ne paciente me IK.

Rekomandimet e udherrefyesve te ESC/EASD per menaxhimin e DM aplikohen per shumicen e pacienteve me IK. 181 Ne IK ceshtjet e meposhtme specifike jane me interes te vecante:

- Te gjithe pacientet duhet zbatojne rekomandimet per stilin e jeteses.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

- Vlerat e rritura te glukozes ne gjak duhet te trajtohen me kontroll te rrepte.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli A i evidences

- Metformina duhet te konsiderohet si linje e pare trajtimi ne paciente ne mbipeshe me DM tip II pa disfunksion renal sinjifikant ($GFR > 30 \text{ ml/min}$).

Klasa IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

- Thiazolidinedionet shkaktojne rritje te incidences se edemes periferike dhe IK. Keshtu qe ata jane te kundraindikuar ne paciente me IK te shkalles NYHA III – IV, por mund te konsiderohet ne paciente me shkalle funksionale I – II nen nje monitorim te kujdeshem te retensionit te likideve.

Klasa IIb e rekomandimit, niveli B i evidences

- Fillimi i hershem i terapise me insuline mund te konsiderohet nese targeti i glicemise nuk mund te arrihet.

Klasa I e rekomandimit, niveli A i evidences

Disfunksioni renal

Terapia ne pacient me IK me disfunksion renal nuk eshte evedence-based pasi keto paciente nuk jane perfshire ne studime te kontrolluara e te randomizuara. Ceshtjet specifike te meposhteme jane me interes.

- Terapia me ACEI ose ARB shoqerohet zakonisht me nje perkeqesim te lehte te funksionit renal. Keto ndryshime jane per gjithesht te perkoqshme dhe te rikthyeshme.
- Nuk ka ndonje nivel absolut te kreatinines qe te parandaloje perdorimin e ACEI/ARB-ve. Megjithate nese kreatinina serike eshte $> 250 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 2.5 \text{ mg/dL}$), rekomandohet survejim i specializuar. Ne paciente me kreatinine serike $> 500 \mu\text{mol/L}$ ($\sim 5 \text{ mg/dL}$), hemofiltrimi ose dializa mund te nevojiten per te kontrolluar retensionin e likideve dhe trajtuar uremine.
- Antagonistet e aldosteronit duhet te perdoren me kujdes ne paciente me disfunksion renal sepse ata mund te shkaktojne hiperkalemi.
- Pacientet me IK dhe disfunksion renal shpesh kane retension te tepruar te likideve dhe kripes te cilat kerkojne terapi me intensive me diuretike. Ne paciente me klirens

kratinine < 30 mL/min, diuretiket tiazidike jane te paefektshem dhe diuretiket e anses jane te preferuar.

- Disfunkzioni renal shoqerohet me renie te klirensit te shume medikamenteve (psh digoksina). Per te shmangur toksicitetin duhet reduktuar doza mbajtese e ketyre medikamenteve dhe nivelet plazmatike duhen monitoruar.

Semundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK)

- Diagnoza e IK ne prezence te SPOK eshte e veshtire ne praktiken klinike. Ka nje mbivendosje te simptomave dhe shenjave me ulje te sensitivitetit te testeve diagnostike si RÖ-grafia pulmonare, EKG, EKO-KG, dhe spirometria.¹⁸⁴
- Vleresimi i niveleve te peptideve natriuretike (BNP ose NT-proBNP) mund te ndihmoje ne diagnoze por qe shepesh rezultatet jane te ndermjetme.
- Shumica e pacienteve me IK dhe SPOK mund te tolerojne terapine me β – bllokues. Rekomandohet fillimi i terapise me doze te vogel dhe titrimi gradual i saj. Perkeqesimi i lehte i funksionit pulmonar dhe simptomave nuk duhet te coje ne nderprerjen e menjeershme te terapise. Nese simptomat perkeqesohen edhe me shume mund te jetet e nevojshme nje reduktim i dozes ose nderprerje e saj. β – bllokada selektive eshte nje opsjon i preferuar.^{188 - 190}
- Nje histori astme duhet konsideruar si kunderindikacion per perdorimin e cdo lloj β – bllokuesi.

Anemia

- Anemia ne IK eshte nje faktor rrisku per hospitalizim dhe mortalitet. Shkaqet me te rendesishme perfshijne hemodiluimin, disfunkzionin renal, kequdhqyerjen, inflamacionin kronik, alterimin e funksionit te palces se kockave, deficitit i hekurit dhe terapia medikamentoze.^{192 – 196}
- Korigimi i anemise nuk eshte vendosur si terapi rutine. Transfuzioni i gjakut nuk rekomandohet per trajtimin e anemise te IK. Ndermjet terapive potenciale perdorimi i eritropoetines ose agjenteve stimulues te saj zakonisht se bashku me hekur, per te rritur prodhimin e eritrociteve eshte nje opsjon i paprovuar ende.^{197 – 200}

Guta (podagra)

- Pcientet me gute mund te zhvillojne hiperuricemi si rezultat i terapise me diuretike dhe disfunkzionit renal. Ne guten akute mund te kondiderohet nje trajtim i shkurter me kolkicine per te frenuar dhimbjen dhe inflamacionin. NSAID duhet te shmangen nese eshte e mundur ne paciente simptomatike. Terapia profilaktike me frenues te ksantine oksidazes (allopurinol) rekomandohet per te parandaluar rekurrencat.

Insuficiencia kardiake akute

Perkufizim

Insuficiencia kardiake akute (IKA) perkufizohet si një fillim i menjehershëm ose ndryshim i simptomave dhe shenjave të IK, që rezulton në nevoje për terapi urgjente. IKA mund të jetë për here të pare ose të shfaqet si një perkeqesim i një IK kronike pre-egzistuese. Pacientët mund të prezantohen si një emergjencë mjeksore si p.sh edema pulmonar akut.

Disfunkcioni kardiak mund të shkaktohet nga iskemi, rrregullime të ritmit kardiak, disfunkcioni valvular, semundje te perikardit, rritje te presioneve ose rezistencë sistemike te rritura. Këta shkaktare etiologjike shpesh mund të jene të kombinuar. Tabela 26 prezanton shkaqet e zakonshme dhe faktoret precipitues të insuficiencës kardiake akute. Eshte e rendesishme që këta faktore të identifikohen dhe të perfshihen në strategjite e trajtimit.

IKA zakonisht karakterizohet nga kongjistioni pulmonar, megjithëse në disa paciente mund të diminoje kliniken debiti i ulet kardiak shoqeruar me hipoperfuzion indor. Semundje të shumta kardiake dhe jo-kardiake mund të precipitojnë IK.4 Disa shembuj perfshijne (i) rritja e pasngarkesës si pasoje e hipertensionit sistemik apo tij pulmonar; (ii) rritja e parangarkesës si pasoje e mbingarkesës volumore dhe retensionit te likideve; ose (iii) insuficiencia cirkulatorë si ne gjendjet me debit te larte, p.sh infeksioni, anemija, ose tirotoksikoza.


Gjendje te tjera te cilat mund te precipitojnë IKA perfshijne aderençen e ulet te pacienteve me terapinë ose keshillat mjeksore, perdorimi i medikamenteve të tillë si NSAID, frenuesit e ciklo-oksigenazës (COX), dhe tiazolidinedionet. IKA severe mund te coje në insuficiencë multiorganore (Tabela 26).

Tabela 26 Shkaqet dhe faktoret precipitues te insuficiences kardiake akute

Semundja iskemike e zemres	Insuficiencia cirkulatore
<ul style="list-style-type: none">• Sindromi koronar akut• Komplikacionet mekanike te IAM• Infarkti i ventrikulit te djathte	<ul style="list-style-type: none">• Septicemia• Tirotoksikoza• Anemia• Shuntet• Tamponada• Embolia pulmonare
Valvulare	Dekompensimi i IK kronike pre – egsistuese
<ul style="list-style-type: none">• Stenozat valvulare• Regurgitimet valvulare• Endokarditi• Disekimi i aortes	<ul style="list-style-type: none">• Mungesa e aderences• Mbingarkesa volumore• Infeksionet, vecanerisht pneumonia• Insulti cerebrovaskular• Kirurgjia• Disfunkzioni renal• Astma, SPOK• Abuzimi me medikamentet• Abuzimi me alkolin
Miopatite	
<ul style="list-style-type: none">• Kardiomiopatia postpartum• Miokarditi akut	
Hipertensioni/Aritmite	
<ul style="list-style-type: none">• Hipretensioni• Aritmite akute	

Klasifikimi klinik

Prezantimi klinik i IKA reflekton nje spekter te gjere dhe secili klasifikim ka limitime. Pacienti me IK zakonisht prezantohet me nje nga 6 kategorite e meposhteme. Edema pulmonare mund se jo te komplikoje prezantimin klinik. Figura 3 demonstron mbivendosjen potenciale ndermjet ketyre gjendjeve.²⁰⁵




- **IK kronike e dekompensuar** (edema periferike/kongestion): zakonisht IK kronike nen trajtim, ne dekursin e saj eshte progresive me perkeqesime te herepashershme me shenja te kongestionit sistemik dhe pulmonar. Presioni arterial i ulet ne pranim lidhet me nje prognoze te keqe.
- **Edema pulmonare:** pacientet prezantohen me distres respirator te rende, takipne, dhe ortopne me rale ne fushat pulmonare. Saturimi arterial me O₂ (SAT O₂) eshte zakonisht < 90% ne ajer dhoma perpara trajtimit me O₂.
- **IK hipertensive:** shenja dhe simptoma te IK shoqeruar me presion te larte arterial dhe zakonisht funksion sistolik te ruajtur te VM. Ka prova per nje rritje te tonusit te sistemit nervor simpatik me takikardi dhe vazokonstriksion. Keta paciente mund te jene euvolemike ose lehtesisht hipervolemike dhe shpesh prezantohen me shenja te kongestionit pulmonar pa shenja te kongestionit sistemik. Pergjigja ndaj terapise eshte e shpejte dhe mortaliteti spitalor eshte i ulet.
- **Shoku kardiogjen:** perkufizohet si vuajtje indore nga hopoperfuzioni i induktuar nga IK pas korrigimit te parangarkeses dhe aritmive madhore. Nuk ka parametra hemodinamike diagnostike. Megithate shoku kardiogjen tipik karakterizohet nga presion sistolik arterial i ulet (PAS < 90 mmHg ose nje ulje e presionit arterial mesatar > 30 mmHg) dhe mungese ose debit urinar te ulet (<0.5 mL/kg/h). Crrgullimet e

ritmit jane te zakonshme. Shenja te hipoperfuzionit organor dhe dhe kongjestioni pulmonar zhvillohen ne menyre te shpejte.

- **IK e djathte e izoluar:** karakterizohet nga shenja te debitit te ulet ne mungese te kongjestionit pulmonar me rritje te presionit venoz jugular, me ose pa hepatomegali, dhe presione te uleta mbushese te VM.
- **Sindromi koronar akut dhe IK:** Shume paciente me IKA parqiten me tabllone klinike dhe gjetje laboratorike te SKA. 206 Afersisht 15% e pacienteve me SKA kane shenja dhe simptoma te IK. Episode te IKA lidhen ose shpesh precipitohen nga nje aritmi (bradicardi, FA, TV).

Disa klasifikime te IKA jane perdorur ne njesite e terapive intensive. Klasifikimi i Killip 57 bazohet ne shenjet klinike gjate IAM. Klasifikimi Forrester 58 gjizhashtu bazohet ne shenja klinike dhe karakteristika hemodinamike gjate IAM. Figura 4 prezanton klasifikimin klinik te modifikuar nga klasifikimi Forrester.




Prognoza

Jane publikuar te dhena nga regjistra te ndryshem te koheve te fundit si EuroHeart Failure Survey II, 206 regjistri ADERE ne USA 207, 208 dhe analizat nationale nga Italia, 209 Franca, 210 dhe Finlanda 211. SKA eshte shkaku me i shpeshte i IKA qe shfaqet per here te pare. Mortaliteti intra-spitalor eshte vecanerisht i larte ne paciente me shok kardiogjen (nga 40 deri ne 60%). Ne kontrast pacientet me IKA hipertensive kane mortalitet intra-spitalor te ulet, dhe patientet zakonisht dalin gjalle nga spitali dhe shpesh asimptomatike.

Indikatoret e progozes se keqe jane te ngashem me ato te IK kronike (*Tabela 17*). 212

Diagnoza e insuficencës kardiake akute

Diagnoza e IKA bazohet ne prezantimin e simptomave dhe shenjave klinike (shih seksionin Perkufizimi dhe diagnoza). Konfirmimi i diagnozes behet ne saje te nje investigimi te mire si historia e semundjes, egzaminimi klinik, EKG, Rö-grafia e kraharorit, ekokardiografia, dhe kerkimet laboratorike perfshire gazanlizen dhe biomarkerat spesifike. Algoritmi diagnostik eshte i ngashem per IKA qe shfaqet *de novo* ose si nje episod deompensimi i IK kronike (shih seksionin e *Teknikat diagnostike* dhe *Figura 5*).



Vleresimi fillestar

Eshte mjaft i rendesidhem vleresimi klinik fokusuar ne historine e semundjes dhe egzaminimin klinik te hollesishem. Kane rendesi vleresimi i perfuzionit periferik, temperatura dhe presioni venoz. Duhet kryer auskultacioni kardiak per te vleresuar zhurmat sistolike apo diastolike gjithashtu edhe tonin e trete ose te katert. Insuficiencia mitrale eshte shume e shpeshte ne fazen akute. Kongjestioni pulmonar dedektohet nga auskultacioni i kraharorit me prezencen e raleve bilaterale bibazale. Presionet e rritura te mbushjes te zemres se djathte vleresohen duke egzaminuar presionin venoz jugular. Efuzionet pleurale jane te zakonshme ne paciente me IK kronike te dekompensuar.

Elektrokardiograma (EKG)

EKG siguron informacion esencial persa i perket frekuences kardiake, ritmit, percueshmerise dhe zakonisht edhe te etiologjise. EKG mund te demonstronte ndryshime iskemike te segmentit ST qe sugjeron infarkt akut miokardi me ngritje te seg ST (STEMI) ose non-STEMI. Valet Q tregojne infarkt transmural te kaluar. Gjithashtu mund te shikohen shenja te hipertrofise ventrikulare, bloqe te degeve, interval QT i zgjatur, aritmi te ndryshme dhe perimiokarditi.

Radiologjia e toraksit

RÖ e toraksit duhet kryer duhet kryer sa me shpejt te jete e mundur ne pranim per te gjithe pacientet me IKA per te vleresuar shkallen e kongestionit pulmonar dhe per te vleresuar per patologji te tjera pulmonare ose kardiakte (kardiomegali, efuzion pleural, apo infiltrate). Duhet te kihet parasysh limitimi ne interpretim i filmave radiologjike te kryer ne pozicionin shtrire.

Analiza e gazeve ne gjakun arterial

Analiza e gazeve ne gjakun arterial mundeson vleresimin e oksigjenimit (pO_2), funksionin respirator (pCO_2), ekuilibrin acido-bazik (pH), duhet te realizohet ne te gjithe pacientet me distres respirator te rende. Acidoza si pasoje e perfuzionit te ulet indor ose retensioni i CO_2 lidhet me nje prognoze te keqe. Matjet jo-invazive me oksimetri te pulsit shpesh mund te zevendesojne hemogazanalizen e gjakut arterial por nuk sigurojne informacion per gjendjen mbi pCO_2 dhe ekuilibrit acido-bazik dhe eshte e pabesueshme ne gjendjet me debit te ulet kardiak dhe ne gjendje shoku si pasoje e vazokonstriksionit ekstrem.

Peptidet natriuretike

Peptidet natriuretike te tipit B (BNP dhe NT-proBNP) te mara ne fazen akute kane nje vlere prediktive te rendesishme per perjashtimin e IK, megjithese evidencat nuk jane te rendesishme si ne IK kronike. Nuk ka nje konsensus persa i perket vlerave reference te BNP ose NT-proBNP ne IKA. Gjate edemes pulmonare fulminante ose RM akut, nivelet e peptideve natriuretike mund te jene normale ne pranim. Nivelet e larta ne pranim dhe ne dalje nga spitali mbartin informacion prognostik te rendesishem. 59, 214

Ekokardiografia

Ekokardiografia me dopler eshte nje element i rendesishem per vleresimin e ndryshimeve funksionale dhe strukturelle qe ndodhin ne IKA. Imazhet ekografike dhe te doplerit duhet perdonur per te vleresuar dhe monitoruar funksionin regional dhe global te ventrikulit te majte dhe te djathte, funksionin diastolik, funksionin dhe strukturen valvulare, patologjine perikardiale, komplikacionet mekanike ne fazen akute te IM dhe evidentimin e dissinkronise. Vleresimi semi-kuantitativ jo-invaziv i presioneve te mbushjes se ventrikulit te djathte e te majte, volumi godites dhe presioni ne arterien pulmonare mund te ndikojne strategjine e trajtimit.

Monitorimi i pacienteve me insuficience kardiake akute

Monitorimi i pacienteve me IKA duhet realizuar sa me shpejt te jete e mundur me paraqitjen e pacientit ne njesine e emergjencës njekohesisht me kerkimet diagnostike te fokusuar per te percaktuar etiologjine primare dhe pergigjen fillestare ndaj trajtimit.

Monitorimi jo-invaziv

Ne pacientet ne gjendje te rende eshte i detyruar monitorimi i parametrave bazale si temperatura, frekuencia respiratore, frekuencia kardiake, presioni arterial, oksigenimi arterial, debiti urinar, dhe elektrokardiograma. Puls oksimetri duhet perdonur ne menyre te vazhduar ne te gjithe pacientet ne gjendje te paqendrueshme te cilet jane nen trajtim me nje fraksion te inspiruar te oksigenit (FiO_2) i cili eshte me i larte se ai i ajrit.

Monitorimi invaziv

Linja arteriale

Indikacionet per vendosjes te nje kateteri arterial jane nevoja per nje analize te vazhdueshme te presionit arterial si pasoje e paqendrueshmerise hemodinamike, ose kerkesa per marrje te shpeshte per analize e mostrave te gjakut.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Linja venoze centrale

Linjat venoze centrale sigurojnë akses ne qarkullimin central dhe janë keshtu te perdonohen per admnistrimin e likideve dhe medikamenteve, monitorimin e presionit venoz central (PVC) dhe saturimin me oksigen te gjakut venoz (SVO_2), i cili siguron nje vleresim te raportit konsum/furnizim te organizmit me oksigen.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli C i evidences

Kateterizimi arterial pulmonar

Inserimi i nje kateteri ne arterien pulmonare (KAP) per diagnozen e IKA eshte zakonisht i panevojshem. KAP mund te perdoret per te dalluar ndermjet nje mekanizmi kardiogenik ose jo-kardiogenik ne paciente komplekse me semundje konkomitante kardiake dhe pulmonare, vecanerisht kur matjet me eko/Doppler jane te veshtira te meren. KAP mund te jete i

perdorshem ne paciente me gjendje hemodinamike te paqendrueshme te cilet nuk i perjigjen terapise trdicionale. Duhet te permendet qe shkalla e komplikacioneve qe shoqerojne inserimin e KAP shtohen me kohezgjatjen e perdomit. Eshte e rendesishme qe te kemi nje objektiv te qarte para se re marim vendimin e inserimit te kateterit ne arterien pulmonare.

Klasa IIb e rekomandimit, niveli B i evidences

Angiografia koronare

Ne rastet e IKA dhe prova te iskemise si angina e paqendrueshme apo sindromi koronar akut, koronarografia indikohet ne paciente pa kundraindikacione te rendesishme. Opcionet e revaskularizimit (PCI/CABG) duhet konsideruar nese eshte teknikisht e mundshme ne paciente te pershatshem me nje profil rrisku te pranuaeshem. Reperfuzioni i suksesshem ka treguar se con ne permiresim te prognozes.²¹⁵

Klasa I e rekomandimit, niveli B i evidences

Meqenese shumica e pacienteve qe prezantohen me IKA kane SAK, diagnostikimi i kesaj te fundit eshte i rendesishem per vendimmarrjen ne lidhje me terapine si antagonistet e glikoproteines IIb/IIIa, terapia antiagregante orale, statinat, dhe revaskularizimi potencial.

Organizimi i trajtimit te induficiencies kardiake akute

Qellimet imediate jane permiresimi i simptomave dhe stabilizimi i parametrave hemodinamike (sih *Tabelen 27 dhe Figuren 6*). Shume paciente mund te kerkojne trajtim afatgjate nese episodi akut con ne IK kronike.

Klasa I e rekomandimit, niveli B i evidences

Tabela 27 Synimet e trajtimit ne insuficiencen kardiake akute

- **Immediate (ED/ICU/CCU)**

Permiresimi i smptomave
Rivendsja e oksigjenimit
Permiresimi i perfuzionit organor dhe parametrave hemodinamike
Kufizimi i demtimeve kardiake/renale
Minimizimi i qendrimit ne ICU

- **Intermediare (intraspitalor)**

Stabilizimi i pacientit dhe optimizimi i strategjise se trajtimit
Fillimi i terapise farmakologjike te pershtatshme (jete-shpetuese)
Konsidero terapine me divajsa ne paciente te pershtatshem
Minimizimi i diteqendrimit spitalor

- **Menaxhimi para daljes nga spitali dhe ndjekja afat-gjate**

Planifikimi i strategjise se ndjekjes
Edukimi dhe fillimi i ndreqjes se stilit te jetesës
Sigurimi i profilaksise sekondare adekuate
Parandalimi i rishtimeve te shpejta
Permiresimi i kualitetit te jetesës dhe mbijetesës

Menaxhimi

Per menaxhimin e IKA perdoren medikamente te klasave te ndryshme por ka pak studime klinike dhe perdoren kryesisht ne menyre empirike. Ne studimet e publikuara per IKA shumica e agjenteve permiresojne hemodinamiken por asnje medikament nuk ka treguar te ule mortalitetin. Opcionet terapeutike te meposhteme konsiderohen te pershtatshme ne paciente me IKA. Sidoqoftë rekomandimet perbejne me teper opinion ekspertesh pa te dhena adekuate nga studime te randomizuara. Keshtu kemi te bejme me nivel evidence te klases C ne rekomandimet e meposhteme.

Oksigjeni

Rekomandohet administrimi i oksigjenit sa me shpejt te jete e mundur ne paciente hipoksemike per te arritur saturime arteriale $> 95\%$ ($> 90\%$ ne ata me SPO₂).

Klaza I e rekomandimit, niveli C i evidences

Ventilimi jo-invaziv

Indikacionet

Ventilimi jo-invaziv (VJI) i referohet te gjithe modaliteteteve te cilat asistojne ventilimin pa perdonimin e tubit endotrakeal por duke perdonur thjesht nje maske te mbyllur fytyre. VJI me presion pozitiv ne fund te ekspirimit (PEEP) duhet konsideruar sa me shpejt te jete e mundur ne cdo pacient me edeme pulmonare akute kardiogjene dhe IKA hipertensive sepse permireson parametrat klinike perfshire distresin respirator. NIV me PEEP permireson funksionin e VM duke reduktuar pasngarkesen e VM. NIV duhet te perdoret me kujdes ne shokun kardiogjen dhe insuficience kardiake te djathte.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli B i evidences




Figura 6 Algoritmi i trajtimit fillestare ne trajtimin e IKA

Si ta perdonim ventilimin jo-invaziv

Fillimi

- PEEP – i perdoret fillimisht me 5 – 7.5 cmH₂O dhe titrohet sipas pergjigjes klinike deri ne 10 cmH₂O; FiO₂ duhet te jetë >0.4

Zgjatja

- Zakonisht 30 min/h derisa dispnea dhe saturimi me oksigjen te qendrojne te permiresuar pa presion pozitiv te vazhduar (CPAP).

Efektet e mundshme te padeshiruara

- Perkeqesim i insuficiencies ventrikulare te djathte severe
- Tharja e membranave mukoze gjate perdonimit te zgjatur dhe te vazhdueshem
- Hiperkapnia
- Ankthi dhe klaustrofobia
- Pneumotoraksi
- Aspirimi

Morfina dhe analoget e saj ne insuficiencen kardiake akute

Morfina duhet te konsiderohet ne stadin e hershem te trajtimit te pacienteve te pranuar me IKA severe vecanerisht nese prezantohen me axhitim, dispne, ankth, ose dhimbje gjoksi. 220 – 222

Morfina lehtson dispnene dhe simptoma te tjera ne paciente me IKA dhe mund te permiresoje kooperimin per aplikimin e NIV.

- Boluset intravenoze te morfines 2,5 – 5 mg mund te admnistrohen apo te jete inseruar linja i.v. ne paciente me IKA.
- Duhet monitoruar respiracioni.
- Nauza eshte e zakonshme, dhe mund te nevojitet terapia antiemetike.
- Duhet patur kujdes ne paciente me hypotension, bradikardi, blok AV te avancuar, ose retension te CO₂.

Diuretiket e anses

Indikacionet

- Administrimi i.v. i diuretikeve rekomandohet ne paciente me IKA ne prezence te simptomave si pasoje e kongestionit dhe mbingarkeses volumore (shih *Tabelen 28*).

Klasa IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

Pika te rendesishme

- Permiresimi simptomatik dhe pranimi universal i trajtimit akut me diuretike ka penguar vleresimin formal te tyre ne studime te medha e te randomizuara klinike. 223 – 226
- Pacientet me hypotension (TA sistolik < 90 mmHg), hiponatremi te thelle, ose acidozë kane pak shance ti per gjigjen terapise me diuretike.
- Doza te larta te diuretikeve mund te cojne ne hipovolemi dhe hiponatremi, dhe rrisin mundesine e hypotensionit gjate fillimit te terapise me ACEI ose ARB.
- Opsione trajtimi alternative si vazodilatatoret IV mund te reduktojnë nevojen per doza te larta diuretikesh.

Tabela 28 Indikacionet dhe dozimi i diuretikeve ne insuficiencen kardiake akute

Retensioni i likideve	Diuretiku	Doza ditore (mg)	Komente
I moderuar	Furosemid ose Bumetanid ose Torasemid	20 – 40 0.5 – 1 10 – 20	Oral ose IV sipas simptomave klinike Titro dozen ne lidhje me perjigjen klinike Monitoro Na+, K+, kreatininen, TA
	Furosemid	40 – 100	i.v. rrit dozen
	Infuzion furosemid Bumetanid Torasemid	5 – 40 mg/h 1 – 4 20 – 100	Me mire sesa boluse me doza te larta Oral ose i.v. Oral
Sever	Shto hydroklortiazid	50 – 100	Kombinimi me i mire sesa dozat e larta te diur. te anses te vetem
	Ose metalazon	2.5 – 10	Me potent nese klr i kreatinines < 30 ml/min
	Ose spironolakton	25 – 50	Zgjidhja me e mire nese nuk ka IR ose K+ ↓
	Acetazolamid	500	i.v.
Refraktar ndaj diur. te anses	Shto dopamine (vazodil. renal) Ose dobutamine		Konsidero hemofiltrimin ose dializen nese ka insuficience renale kooegzistuese Hyponatremi
Me alkaloze	hydroklor		
Refraktar ndaj diur. te anses + hydroklor			

Si te perdonim diuretiket e anses ne insuficiencen kardiake akute

- Doza fillestare e rekomanduar eshte bolus i furosemidit 20 – 40 mg i.v. (0.5 – 1 mg bumetanid; 10 – 20 mg torasemid) ne pranim. Pacientet duhet te vleresohen shpesh ne fazën fillestare duke ndjekur debitin urinar. Vendosja e kateterit urinar eshte e deshirueshme per te monitoruar debitin urinar dhe vleresuar perjigjen ndaj trajtimit.
- Ne paciente me shenja te mningarkeses volumore, doza i.v. e furosemidit mund te rritet ne varesi te funksionit renal dhe historise te perdonimit te meparshem te terapise diuretike. Ne keta paciente duhet konsideruar gjithashtu infuzioni i vazhduar pas aplikimit te dozes fillestare. Doza totale e furosemidit duhet te qendroje < 100 mg ne 6 h e para dhe 240 mg gjate 24 oreve te para.

Kombinimi me diuretike te tjere

Kombinimi i diuretikeve tiazidike me ato te anses mund te jete i suksesshem ne rastet e rezistences diuretike. Ne rast te mbingarkeses volumore te IKA, tiazidiket (hydroklortiazid 25 mg p.o.) dhe antagonist e aldosteronit (spironolakton, eplerenon 25 – 50 mg p.o.) mund te perdoren ne kombinim me diuretiket e anses. Kombinimet me doza te vogla jane shpesh me te efektshme me dhe me efekte anesore me te pakta sesa perdonimi i dozave te larta te nje medikamenti te vetem.

Efektet e padeshiruara te mundshme te diuretikeve te anses

- Hypokalemi, hyponatremi, hiperuricemi
- Hypovolemi dhe dehidrim; debiti urinar duhet vleresuar shpesh
- Aktivizimi neurohumoral
- Mund te thelloje per gjigjen hypotensive gjate fillimit te terapise me ACEI/ARB

Antagonistet e vazopresines

Jane identifikuar disa tipe te receptoreve te vazopresines: receptoret V1a shkaktojne vazokonstriksion, ndersa stimulimi i V2 te lokalizuar ne veshka nxit re-absorbimin e ujit. Dy antagonistet me te studiuar te vazopresines ne IKA jane konivaptan (nje antagonist i dyfishte i V1a/V2) ne hiponatremi, dhe tolvaptan (nje antagonist elektiv oral i receptoreve V2). Ne EVEREST, tolvaptan lethesoi simptomat te lidhura me IKA dhe nxiti renie ne peshe ne fazen akute por nuk reduktoi vdekshmerine dhe semundshmerine per nje vit. 227

Vazodilatatoret

Vazodilatatoret rekandomohen ne nje stad te hershem, ne paciente me IKA pa hypotension ortostatik, TA <90 mmHg ose semundje valvulare obstruktive. Dozat e rekomanuara te vazodilatatoreve jepen ne Tabelen 29.

Tabela 29 Indikacionet dhe dozimi i.v. i vazodilatatoreve ne insufcienen krdiakre akute

Vazodilatoret	Indikacioni	Doza	Efektet anesore kryesore	Te tjetra
Nitroglycerina	Kongestion/edeme pulmonare TAS >90 mmHg	Fillo me 10-20 µg/min, rrit dozen deri ne 200 µg/min	Dhimbje koke, hypotension	Tolerance ne administrim te vazhduar
Isosorbit dinitrati	Kongestion/edeme pulmonare TAS >90 mmHg	Fillo me 1 mg/h, titro dozen deri ne 10 mg/h	Dhimbje koke, hypotension	Tolerance ne administrim te vazhduar
Nitroprusidi	Kongestion/edeme ne IK ipertensive TAS >90 mmHg	Fillo me 0.3 µg/kg/min dhe rrit dozen deri ne 5	Hypotension, toksicitet nga izocianatet	Ndjeshmeri ndaj drites
Nesiritidi *	Kongestion/edeme pulmonare TAS >90 mmHg	µg/kg/min Bolus 2 µg/kg + infuzion 0.015 – 0.03 µg/kg/min	Hypotension	

* I padisponueshem ne shume vende te Evropes anetare te ESC

Indikacionet

Nitratet intravenoze dhe nitroprusidi i natriumit rekomandohen ne IKA dhe TAS > 110 mmHg dhe mund te perdoret me kujdes ne paciente me TAS ndermjet 90 dhe 110 mmHg. Keta agjente ulin TAS, ulin presionet e mbushjes ne anen e majte dhe te djathte te zemres dhe rezistencat vaskulare sistemike, dhe lehtesojne dispnene. Fluksi koronar zakonisht eshte i ruajtur pavaresisht renies se presionit diastolik. 228, 229

Pika te rendesishme

- Vazodilatoret ne IKA lehtesojne kongestionin pulmonar zakonisht pa ulur volumin godites ose rritur kerkesen e miokardit per oksigjen, vecanerisht ne paciente me sindrom koronar akut.

- Antagonistet e kalciumit duhen shmangur ne paciente me IKA me TAS < 90 mmHg pasi mund te reduktoje perfuzionin e organeve qendrore.
- Duhet shmangur hypotensioni, vecanerisht ne paciente me disfunkcion renal.
- Paciente me stenoze te aortes mund te shfaqin hipotension te theksuar pas fillimit te trajtimit me vazodilatatore i.v.

Si ti perdonim vazodilatatoret ne IKA

Nitratet, nitroprusidi i sodiumit dhe nesiritidi perdoren me infuzion te vazhduar. Nitroglycerina intravenoze eshte medikamenti i perdonur me gjeresisht ne IKA, dhe predominojn efekti venodilatator. Nitroprusidi intravenoz eshte nje vazodilatator i balancuar mbi shtratin vazal dhe redukton parangarkesen dhe pasngarkesen. Nesiritidi intravenoz, nje forme rekombinante e tipit B te peptidit natriuretik human, eshte nje vazodilatator venoz dhe arterial me efekt modest te kombinuar diuretik dhe natriuretik.

- Rekomandohet administrimi i nitroglycerines ne fazen e hershme te IKA e ndjekur nga nje infuzion i vazhduar, nitroglycerine spray 400 µg (2 shkrepje) cdo 5 - 10 min, nitrate ne rruge bukale (isosorbit dinitrati 1 ose 3 mg), ose 0.25 - 0.5 mg nitroglycerine sublinguale.
- Rekomandimi i dozes fillestare te nitroglycerines i.v. eshte 10 - 20 µg/min duke e rritur dozen me 5 - 10 µg/min cdo 3 - 5 min sipas nevojes.
- Rekomandohet titrimi i ngadalshem i nitrateve i.v. dhe matje te shpeshta te TA per te shmangur uljet e rendesishme te TAS.
- Nitroprusidi i.v. duhet administruar me kujdes. Doza fillestare duhet te jetë 0.3 µg/kg/min duke te titruar deri ne 5 µg/min. Rekomandohet vendosja e nje linje arteriale per monitorimin e TA.

Efektet anesore te mundshme

Dhimbja e kokes raportohet shpesh nga perdonimi i nitrateve. Takifilaksia eshte e zakonshme pas 24 - 48 h, dhe kerkon rritjen e dozes per te marre te njejtin efekt. Nitroprusidi i.v. duhet perdonur me shume kujdes ne paciente me SKA, pasi hypotensioni nuk eshte i rralle.

Medikamentet inotropike (*Tabela 30*)

Agjentet inotropike duhen konsideruar ne paciente me debit te ulet kardiak, ne prani te shenjave te hypoperfuzionit ose kongestionit pavaresisht perdonimit te vazodilatatoreve dhe/ose diuretikeve per te permiresuar simptomat. Figura 7 paraqet nje algoritem trajtimi te bazuar ne nivelin e TAS, dhe figura 8 paraqet algoritmin e trajtimit bazuar ne vleresimin klinik te presioneve te mbushjes dhe perfuzionit.

Klasa IIa e rekomandimit, niveli B i evidences

Tabela 30 Dozimi i agjenteve inotropike pozitive ne insuficiencen kardiak akute

	Bolus	Shkalla e infuzionit
Dobutamine	Jo	2 - 20 µg/kg/min ($\beta+$)
